

Qershor 2019
Numri: 135
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



LA ILAHE IL-LALLAH MUHAMMEDUN RESULULLAH

NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT DHE MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUARI I TIJ



revistaetika



progresibotime

Pejgamberët, të cilët Allahu Teala ia ka dërguar njerëzimit si vepër e mëshirës së Tij, janë përballur me tri lloje qëndrimesh të njerëzve: mohim, hipokrizi dhe besim. Secili prej këtyre qëndrimeve sigurisht që në vetvete ka pasur gradat dhe llojet e shfaqjeve të veta. Ne, në këtë shkrim, veçanërisht do të përqipemi ta shtjellojmë në formë nenesh dhe brenda kornizës së mesazheve të Zotit (xh.xh.), qëndrimin që duhet të shfaqë besimtari kundrejt të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Besimi ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.)

Allahu thotë në Kuranin Fisnik: **“O ju që keni besuar! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë...”** (Nisa, 136.)

Pa pasur besim, nuk mund të krijohet një marrëdhënie ndërmjet nesh dhe të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Të besojmë do të thotë ta pranojmë me zemër se ai është zgjedhur e dërguar si Pejgamber nga Allahu Teala dhe ta shprehim këtë me gjuhë. Nëse e lexojmë ajetin me kujdes, do të vëmë re se ai u drejtohet besimtarëve. Kjo do të thotë se besimi nuk pranon dyshim, nuk mund të ndërtohet mbi pandehje dhe nuk mund të jetë i plotë vetëm duke u shprehur me gjuhë, në formën “besova”. Nisur nga këto që thamë, dyshimet duhet të shuhen, pikat e dobëta duhet të përforcohen dhe me të gjithë qenien tonë duhet ta pranojmë se ai është i Dërguari i Allahut.

Respekti dhe nderimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.)

“O njerëz! (Ne e kemi dërguar Pejgamberin), në mënyrë që ta besoni, ta ndihmoni dhe ta respektoni dhe që ta madhëroni Allahun në mëngjes e në mbrëmje.” (Fet’h, 9.)

Në esencën e fesë gjendet nderimi dhe respekti. nderimi dhe respekti më i madh është ai kundrejt Allahut (xh.xh.). Çdo gjë që i atribuohet Allahut, meriton të nderohet. Nisur nga ky kontekst, Bejtull-llah / Shtëpia e Allahut, Kitabull-llah / Libri i Allahut dhe Resulull-llah / i Dërguari i Allahut, etj. meritojnë të nderohen sipas gradave të tyre. Ndërsa atë që Allahu e përçmon dhe e ul, nuk mund ta nderojmë dhe respektojmë. nderimi që i bëhet të Dërguarit, në të vërtetë është nderim që i bëhet Atij që e ka dërguar.

Në Kuranin Fisnik ka shumë ajete që flasin për respektin ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Shumë rregulla edukate u janë mësuar besimtarëve nga vetë Zoti i botëve në lidhje me këtë çështje. Allahu Teala i ka mësuar besimtarët që “kur të flasin me Pejgamberin, të mos flasin si me njerëzit e tjerë, të mos e ngrenë zërin mbi zërin e tij, të mos kalojnë në asnjë mënyrë para tij dhe madje të japin ndonjë lëmoshë para se të flasin me të”.

Qershor 2019

VITI: XIII

NUMRI: 135

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.



Rinia dhe xhamia
Prof. dr. Mehmet Gërmez


17

Përmbajtja



Qëndrimi i besimtarit kundrejt të
Dërguarit të Allahut (a.s.)
Doç. dr. Adem Ergyl

10



Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34




18



28


Dy pika të përbashkëta të shkatërruesve
të fesë në lidhje me shoqërinë
Mustafa Asim Kycykashçe

- 5 Marrëdhënia jonë me Profetin (a.s.)
Ahmet Tashgetiren
- 8 Marria për shembull
e të Dërguarit të Allahut (a.s.)
Prof. dr. Sulejman Derin
- 13 Prehje shpirtërore
Salih Zeki Meriç
- 14 Dije e vërtetë, besim i vërtetë
Ali Riza Temel
- 18 Harith ibn Asim El-Esh'ariu
Mustafa Erish
- 20 Një udhëtim me Sheherazaden
Nuredin Nazarko
- 22 Virtytet që thurin myslimanizmin tonë
Xhafer Durmush
- 24 Namazi dhe koha
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz



42

- Kaos terminologjik: Islami politik dhe islamizmi** 26
Abdelrahman Rashdan
- Bëhu shërbëtor i atij Sulltani** 31
Ferudun Ozdemir
- Një Ajet-Një Hadith** 32
- El-Adhim** 40
Ilir Hoxha
- Të qenët i hapur ndaj ndikimit** 42
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- Plepi dhe kungulli** 47
Urtësi
- Panorama jonë** 54
Nurten Çevikollu
- Nga oqeani i haditheve** 56
Selime Akburç



44

Zhvillimi dhe rendi global
Një këndvështrim moral
Ibrahim Kallën



Vëllazëria dhuratë nga Zoti
Ferit Piku

48

Marrëdhënia jonë me Profetin (a.s.)

— Ahmet Tashgetiren —

Të gjithë i dimë vargjet e poetit Nabi. Kur karvani arriti në Medinetu'l-Munevvera, ai i shprehu kështu ndjesitë që i lindën në zemër:

“Ky është vendi ku prehet i Dërguari i Zotit, ky është vendi i Muhammed Mustafasë.”

Le ta themi edhe një varg tjetër të Nabit:

“Pastroje pasqyrën e perceptimit nga interesat e kësaj bote. A mund të vijë mysafiri në një shtëpi të papastër! Ki turp!”

Në çfarë gjendje janë marrëdhëniet tona me të Dërguarin e Allahut, (a.s.)? Çfarë lidhjeje kanë zemrat tona me të? Si e shohim ne atë? Sa i besojmë atij? Sa e duam? Vallë, zemrat tona janë të pastra dhe të dëlira, apo janë të plagosura, të copëtuara, të verbra dhe madje edhe të ndyra?

Debatet në lidhje me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), hadithet dhe Sunetin e tij, tashmë kanë marrë një natyrë që nxjerr në pah rrëshqitjet në botën shpirtërore. Debatet që nuk mund t'i bëjmë në audiencën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), po i bëjmë në mungesë të tij, madje po i bëjmë në një mënyrë krejt vulgare.

Ai është i Dërguari i Allahut. Allahu Teala e ka caktuar atë si “të Dërguar”. Atë e ka bërë udhërrëfyes për të marrë revelatën Hyjnore, për ta mbartur atë, për ta zbatuar edhe vetë, për t'u bërë shembull për të tjerët (madje, shembulli më i shkëlqyer), për t'i edukuar e pastruar njerëzit dhe mbi të gjitha për të formuar një ummet që do t'i zbatojë rregullat e Allahut (xh.xh.), deri në Kiamet. Ky nuk është mision i një njeriu çfarëdo. Ky është misioni i Pejgamberit të fundit të Allahut.

Ky është një mision i cilësuar si “mëshirë për botët” nga Fuqia që e ka dërguar. Cilat janë botët? Çfarë është mëshira? Ku gjendemi ne në këto botë? Çfarë është mëshira për ne?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), është cilësuar si “poseduesi i moralit më të lartë”, domethënë është një njeri i zgjedhur për t'u prirë të tjerëve në moral. Çfarë është njeriu? Çfarë është morali?

Nëse para nesh është vendosur një udhërrëfyes i moralit dhe nëse mund ta mbajmë të gjallë perceptimin njerëzor, atëherë, ajo që duhet

të bëjmë është që ta mësojmë shkronjë pas shkronjë “të Dërguarin” dhe t’i mbajmë aktive të gjitha aftësitë e vetëdijes sonë, në mënyrë që të mos i humbim qoftë edhe pjesët më të vogla të mesazheve që na drejtohen.

Sahabët e nderuar, të cilët ishin brezi i parë i Islamit, pikërisht këtë kanë bërë. Kur ata e dëgjonin të Dërguarin e Allahut, (a.s.), fokusoheshin te ai me një vëmendje aq të madhe sa që dukeshin sikur kishin ndonjë zog në kokë dhe kishin frikë se mos ikte po të lëviznin. Ata asnjëherë nuk thanë: “I Dërguari i Allahut le të marrë tre-pesë shkruar, le t’i urdhërojë për ta shkruar Shpalljen dhe pastaj t’ua shpërndajë njerëzve.” Jo, kjo nuk ishte marrëdhënia e Pejgamberit me besimtarët e parë apo marrëdhënia e besimtarëve të parë me Resulullahun, (a.s.).

Ata e deshën të Dërguarin e Allahut, (a.s.), madje e deshën shumë. Atë e deshën aq shumë sa që i thoshin: “Nëna dhe babai ynë të qofshin falë!” Ata e mësuuan Shpalljen Hyjnore, madje e mësuuan shkronjë për shkronjë dhe e zbatuan në jetë Islamin. Ata e reflektuan në jetën e tyre çdo gjë që panë te Pejgamberi (a.s.).

Ata nuk e ngrinin zërin në prezencën e Profetit të Zotit (xh.xh.). Po, atë e njohën si një “Pejgamber njeri”. Kjo ishte një gjendje e natyrshme për sa i përket aspektit të misionit për edukimin e njerëzimit, por atë asnjëherë nuk e ulën në gradën e një njeriu të zakonshëm, sepse Allahu Teala tha: “Ai është i Dërguari i Allahut.” Sahabët e kuptuan drejt këtë.

Ata e mësuuan Kuranin Fisnik nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Pejgamberin (a.s.), e pranuan si sjellës i sinqertë i lajmeve nga Zoti (xh.xh.). Ata nuk kishin asnjë dyshim nëse ishin apo jo prej Allahut Teala ato që sillte ai. Besnikëria ishte cilësia më dalluese e Hz. Pejgamberit.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), vendoste ndonjë dispozitë, ata i bënë pyetje. Nëse bëhej fjalë për ndonjë ndryshim nga dispozitat që njiheshin, përsëri i bënë pyetje, por kur Pejgamberi thoshte fjalën e fundit, ata asnjëherë nuk thoshin: “Pejgamberi thotë kështu, por mendja nuk ma pranon këtë.” Ata e dinin shumë mirë se një veprim i tillë përbënte një sëmundje shpirtërore.

Ata i kuptuan mesazhet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ndërsa ata që nuk gjendeshin në kuvendin e dijes së Pejgamberit (a.s.), pyesnin ata që e kishin frekuentuar. Nëse kishte ndonjë gjë që nuk e kuptonin, thoshin me plot besim: “Nëse e thotë ai, është e vërtetë.” Ata i besuan Shpalljes që erdhi nga Allahu Teala dhe e cila solli një disiplinë të vërtetë për jetën në të gjitha kohërat. Besimtarët nuk debatuan rreth të Dërguarit dhe Shpalljes, këtë e bënë vetëm politeistët. Ndërsa ata vetëm u përpoqën ta kuptonin të Dërguarin e Allahut, (a.s.), dhe i besuan atij.

Ky ishte boshti krejt i qartë i marrëdhënieve që kishte brezi i parë i Islamit me të Dërguarin e Allahut, alejhi’s-selam. Për ata Pejgamberi (a.s.), ishte ai që i shpëtonte njerëzit nga buza e greminës së zjarrit me ndihmën e Allahut Teala.

Me ardhjen e kohëve të mëvonshme, duke përfshirë këtu edhe kohën tonë, të Dërguarin e Allahut, (a.s.), e kemi shndërruar në një njeri që e ka sjellë Shpalljen dhe me kaq e ka mbaruar punën e tij. Ky para së gjithash është një veprim prej të cilit duhet të turpërohemi.

Misioni i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili është caktuar nga Allahu Teala në Kuranin Fisnik, vazhdon në të gjitha kohërat. Debati rreth kësaj çështjeje nuk është gjë tjetër veçse humbje, konsumim, falimentim dhe sëmundje e zemrës. Ne duhet t’i kërkojmë mbrojtje Allahut (xh.xh.), për këtë. Prijësia e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), nuk mund të debatohet pa i fshirë disa ajete të caktuara nga Kurani Fisnik. Ndërsa debati që bëhet krahas atyre ajeteve, është një iniciativë për t’i shfuqizuar ajetet, domethënë, është një tentativë për ta shfuqizuar Kuranin dhe për ta shkatërruar Islamin.

Në të vërtetë, edhe përpjekja e bërë në formën: “Vlera e të Dërguarit të Allahut

shpjegohet kështu në Kuran”, është një vepër boshe. Ata që u flasin njerëzve në këtë mënyrë, duhet t’i shikojnë edhe një herë zemrat e tyre.

Ndërsa një çështje që mund të diskutohet padyshim është kjo: Nëse të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i atribuohet ndonjë fjalë, sjellje apo veprim që nuk i përket, atëherë kjo qasje duhet konsideruar si e papranueshme. Kjo ka qenë e papranueshme edhe në kohën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), po ashtu është edhe në kohën tonë. Vetë Resulullahu, (a.s.), ka thënë: *“Ai që transmeton në emrin tim një fjalë që nuk më përkasin mua, le të përgatisë vendin e tij në Xhehenem.”* Nga ky hadith fisnik kuptojmë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), e sjell fenë dhe nuk lejon që të hyjë në të asnjë rregull “jashtë kontrollit Hyjnor”, edhe pse në emër të tij.

Edhe në brezat e mëvonshëm ka ekzistuar një ndjeshmëri e tillë. Pra, së pari është aplikuar Shpallja e ardhur nga Allahu Teala, pastaj janë aplikuar fjalët e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), veprimet e tij dhe veprat që ai i ka parë, por që nuk i ka ndaluar. Vërtetimi i Shpalljes së Kuranit Fisnik është bërë me dëshminë e brezit të Hz. Pejgamberit. Kështu është vërtetuar edhe përmbajtja e Sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

A ka ndonjë ndryshim në besueshmëri ndërmjet Kuranit Fisnik dhe Sunetit të Pejgamberit? Çdo gjë që na vjen në rrugë të saktë nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), është rregull për ne. Atëherë, bëhet fjalë për vendosjen e masës së saktësisë në hadithe. E gjithë shkenca e metodologjisë së hadithit dhe shkencat e tjera islame si Fikhu, Tefsiri dhe Kelami, që janë të lidhura me të, janë përpjekur për të nxjerrë kornizën e jetës islame, duke marrë parasysh rregullin e saktësisë së haditheve dhe duke marrë për bazë Kuranin Fisnik.

A nuk janë shpifur fjalë apo gjëra të tjera në emër të të Dërguarit të Allahut, (a.s.)? Sigurisht që janë shpifur. Por edhe përpjekjet për t’i nxjerrë tekstet e shpifura nga “Koleksionet e Hadithit”, janë jashtëzakonisht të mëdha.

Ndjesia e turpit kur flet për hadithet, përçmon vetëm atë që ndjehet në këtë formë. Kjo ndjesi nuk ia ul aspak vlerën personalitetit madhështor të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Mund të shprehemi edhe kështu: Pastrimi i transmetimeve që rregullat e përgjithshme nuk i pranojnë, siç janë hadithet mevzu dhe daif, duke mbartur edhe nijetin për parandalimin e shpifjeve ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është një veprim që gjithmonë kërkohet nga myslimanët.

Gjithashtu nëse në një debat, njëra palë e mbron çdo gjë që i përket të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe pala tjetër vazhdimisht gjendet në atmosferën e dyshimit, atëherë ky veprim dashje pa dashje e lëshon palën e dytë në pozitën e atij që e heton të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Myslimani asnjëherë nuk duhet të bëjë diçka të tillë.

Përveç të tjerash, temën tonë mund ta analizojmë me ndjenjat e myslimanëve ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), përgjatë të gjitha kohëve. Prandaj, ne duhet të jetojmë së bashku me Hz. Pejgamberin, ta kapim për dore, ta fusim në ninullat që ua këndojmë fëmijëve, etj., domethënë, duhet të ndjehemi sikur jetojmë bashkë me të, pra të mos e lëmë në përkohshmëri edhe pse e dimë që është i përkohshëm. Sunetin e tij duhet ta praktikojmë në fjalë, në shikim, në ëndërr dhe në çdo aspekt tjetër të jetës.

Ne vazhdimisht dëshmojmë se një ujëvarë dashurie po rrjedh pa reshtur, duke filluar që nga jeta e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), e deri në këtë kohë. Kjo ujëvarë dashurie e ka kapluar të gjithë ummetin duke filluar që nga njeriu më i zakonshëm e deri te ata më intelektualë.

Ku do t’i vendosim ndjenjat e Junusit i cili thotë: “O Muhamed! Për ty po mallëngjehem.”

Njeriu nuk duhet të grindet për gjërat që nuk do t’i mbrojnë dot nesër, kur të jetë pranë të Dërguarit të Allahut, (a.s.).





Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.)

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Marrja për shembull dhe pasimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është një çështje identiteti dhe personaliteti. Kjo është një e vërtetë krejt e qartë. Pranimi dhe pasimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në këtë mënyrë, nuk i ka ndaluar dot mendimet e ndryshme për sa i përket çështjes nëse duhet të vlerësohen ndryshe cilësitë e tij prej njeriu nga ato prej pejgamberi. Ndërkohë që pranohet në përgjithësi se duhen pasuar veprimet të cilat ai ka kryer si Profet, ndjekja e veprimeve dhe sjelljeve të përditshme që i ka bërë si njeri, thuhet se nuk është obligim. Më poshtë gjendet një koment që i përmbledh plotësisht të gjitha mendimet e dhëna për këtë çështje:

Komentuesi i Kuranit, Kurtubiu, i cili ka ndërruar jetë më 1273, thotë: “Ka pasur mendime të ndryshme në lidhje me çështjen nëse është vaxhib apo mustehab për t’u marrë shembull i Dërguari i Allahut, (a.s.)” Pastaj shprehet se përgjigjja e kësaj pyetjeje, në lidhje me dispozitën e marrjes për shembull të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ka dy alternativa:

Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është vaxhib derisa të gjendet ndonjë argument që e vërteton se është mustehab.

Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është mustehab derisa të gjendet ndonjë argument se është vaxhib.

Pastaj shprehet: “Këtë çështje mund ta komentojmë edhe kështu: Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në çështjet e fesë është vaxhib, ndërsa në çështjet e kësaj bote është mustehab.”¹

E vërteta që del në pah në këtë përmbledhje të të ndjerit Kurtubi, është fakti se marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ka

1. Shik. El-Xhami' li ahkami'l-Kuran, XIV, 156.

dy dispozita: Njëra vaxhib dhe tjetra mustehab. Këto dy dispozita, qoftë ajo në të cilën thuhet: “Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është vaxhib derisa të gjendet ndonjë argument që e vërteton se është mustehab. Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është mustehab derisa të gjendet ndonjë argument se është vaxhib.”, apo qoftë ajo tjetra për të cilën thuhet: “Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në çështjet e fesë është vaxhib, ndërsa në çështjet e kësaj bote është mustehab.”, nuk e kalojnë kufirin. Për këtë arsye, fakti se dispozita e “pasimit të të Dërguarit të Allahut, në punët dhe veprimet njerëzore të përditshme, nuk është “vaxhibu’l-ittiba”, nuk do të thotë se lejohet të mos e ndjekim, siç e kuptojnë disa. Kjo deklaratë e Zotit të Lartësuar, që na tregon se i Dërguari i Allahut, (a.s.), është “ modeli më i mirë për jetën”, gjithashtu na shpjegon se marrja për shembull e Hz. Pejgamberit është “salihu’l-ittiba”, pra, se ai meriton të pasohet. Një jetë ditore e zhveshur nga shembulli dhe mënyra e jetesës së të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është një jetë jashtëzakonisht e degraduar, e pakëndshme, e pahijshme dhe e privuar nga mirësia e privilegji i ndjekjes së gjurmëve të Resullullahut, (a.s.).

Siç dihet, ne duhet ta ndjekim të Dërguarin e Allahut, (a.s.), si shenjë e dashurisë sonë ndaj Allahut Teala. Në Kuranin Fisnik thuhet shumë qartë: **“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, në mënyrë që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”**² Edhe në ajetin vijues, thuhet: **“Thuaju: Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!” Në qoftë se kthejnë shpinën, (dijeni se) Allahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët.”**³

Në këto ajete fisnike kërkohet dhe urdhërohet pasimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), pa bërë ndonjë ndarje ndërmjet çështjeve të fesë dhe atyre të kësaj bote. Në një ajet tjetër shpjegohet fundi i dhimbshëm i mosmarrjes për shembull të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe i mosnjohjes së Sunetit të tij:

“Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: “Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin! Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!” Në

të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në castin e nevojës.”⁴

Këto ajete fisnike tregojnë se e gjithë çështja është kjo: Aq sa i japim vend në jetën tonë të Dërguarit të Allahut, (a.s.), si një rob dhe pejgamber i Zotit dhe aq sa e pasojmë atë, aq tregojmë se jemi individë të përkushtuar për ummetin.

Nëse do të arrinim ta kuptonim me të vërtetë këtë fakt, do ta prananim paralajmërimin që u është bërë sahabëve (dhe si rezultat edhe ummetit): **“Dhe ta dini se midis jush gjendet i Dërguari i Allahut! Sikur ai t’ju bindej juve në shumë gjëra, ju do ta kishit pësuar...”**⁵ Për këtë arsye, askush prej nesh nuk mund ta vendosë në role të supozuara të Dërguarin e Allahut, (a.s.), duke thënë: “I Dërguari i Allahut nuk e thotë diçka të tillë. Ai nuk e bën këtë.” Apo: “Po të ishte ai, do të bënte kështu e ashtu.” I Dërguari i Allahut, (a.s.), siç nuk ka pasuar sahabët në shumë çështje përgjatë jetës, po ashtu nuk mund të lihet në mëshirën e pandehjeve, dëshirave dhe pasioneve të askujt pasi ka ndërruar jetë. Tentativa për

“PROFECIA ËSHTË NJË DHURATË NGA ALLAHU. NDAJ, PEJGAMBERIT I TAKON TË BËJË PREDIKIMIN. NDËRSA NEVE NA TAKON TË NËNSHTROHEMI.” NË TË KUNDËRT, SHFAQIM VEPRIME JASHTË RREGULLAVE DHE EDUKATËS, TË TILLA SI TENTATIVA PËR TA BËRË TË DËRGUARIN E ALLAHUT, (A.S.), TË VEPROJË SIPAS HAMENDËSIMEVE TONA. KY VEPRIM, NË NJË ASPEKT, PËRBËN PATURPËSINË “PËR T’I TREGUAR SHSEMBULL HZ. PEJGAMBERIT”, NË VEND QË TA MARRIM PËR SHSEMBULL NE ATË.

të bërë diçka të tillë, atëherë ka vënë në vështirësi sahabët, ndërsa në ditët e sotme ummetin.

Padyshim se tentativa për t’i dhënë role të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-salam, është në kundërshtim me marrëdhënien bindje-pasim që duhet të kemi me Hz. Pejgamberin. Ai ka marrë Shpalljen Hyjnore, ndërsa ne jemi individë e ummetit dhe duhet ta pasojmë. Siç është shprehur me plot të drejtë edhe Imam Zuhri (v. 124): “Profecia është një dhuratë nga Allahu. Ndaj, Pejgamberit i takon të bëjë predikimin. Ndërsa neve na takon të nënshtrohemi.”⁶ Në të kundërt, shfaqim veprime jashtë rregullave dhe edukatës, të tilla si tentativa për ta bërë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), të veprojë sipas hamendësimeve tona. Ky veprim, në një aspekt, përbën paturpësinë “për t’i treguar shembull Hz. Pejgamberit”, në vend që ta marrim për shembull ne atë.

2. Al Imran, 31.

3. Al Imran, 32.

4. Furkan, 27-29.

5. Huxhurat, 7.

6. Shik. El-Begavi, Sherhu’s-Sunneh, I, 217.

QËNDRIMI I BESIMTARIT KUNDREJT TË DËRGUARIT TË ALLAHUT, (A.S.)

— Doç. dr. Adem Ergyl —

Pejgamberët, të cilët Allahu Teala ia ka dërguar njerëzimit si vepër e mëshirës së Tij, janë përballur me tri lloje qëndrimesh të njerëzve: mohim, hipokrizi dhe besim. Secili prej këtyre qëndrimeve sigurisht që në vetvete ka pasur gradat dhe llojet e shfaqjeve të veta. Ne, në këtë shkrim, veçanërisht do të përpiqemi ta shtjellojmë në formë nenesh dhe brenda kornizës së mesazheve të Zotit (xh.xh.), qëndrimin që duhet të shfaqë besimtari kundrejt të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Besimi ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.)

Allahu thotë në Kuranin Fisnik: **“O ju që keni besuar! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë...”** (Nisa, 136.)

Pa pasur besim, nuk mund të krijohet një marrëdhënie ndërmjet nesh dhe të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Të besojmë do të thotë ta pranojmë me zemër se ai është zgjedhur e dërguar si Pejgamber nga Allahu Teala dhe ta shprehim këtë me gjuhë. Nëse e lexojmë ajetin me kujdes, do të vëmë re se ai u drejtohet besimtarëve. Kjo do të thotë se besimi nuk pranon dyshim, nuk mund të ndërtohet mbi pandehje dhe nuk mund të jetë i plotë vetëm duke u shprehur me gjuhë, në formën “besova”. Nisur nga këto që thamë, dyshimet duhet të shuhen, pikat e dobëta duhet të përforcohen dhe me të gjithë qenien tonë duhet ta pranojmë se ai është i Dërguari i Allahut.

Respekti dhe nderimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.)



“O njerëz! (Ne e kemi dërguar Pejgamberin), në mënyrë që ta besoni, ta ndihmoni dhe ta respektoni dhe që ta madhëroni Allahun në mëngjes e në mbrëmje.” (Fet’h, 9.)

Në esencën e fesë gjendet nderimi dhe respekti. Nderimi dhe respekti më i madh është ai kundrejt Allahut (xh.xh.). Çdo gjë që i atribuohet Allahut, meriton të nderohet. Nisur nga ky kontekst, Bejtull-llah / Shtëpia e Allahut, Kitabull-llah / Libri i Allahut dhe Resulull-llah / i Dërguari i Allahut, etj. meritojnë të nderohen sipas gradave të tyre. Ndërsa atë që Allahu e përçmon dhe e ul, nuk mund ta nderojmë dhe respektojmë. Nderimi që i bëhet të Dërguarit, në të vërtetë është nderim që i bëhet Atij që e ka dërguar.

Në Kuranin Fisnik ka shumë ajete që flasin për respektin ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Shumë rregulla edukate u janë mësuar besimtarëve nga



vetë Zoti i botëve në lidhje me këtë çështje. Allahu Teala i ka mësuar besimtarët që “kur të flasin me Pejgamberin, të mos flasin si me njerëzit e tjerë, të mos e ngrenë zërin mbi zërin e tij, të mos kalojnë në asnjë mënyrë para tij¹ dhe madje të japin ndonjë lëmoshë para se të flasin me të”².

Shumica e popujve që janë shkatërruar, përbëheshin nga njerëz që nuk shfaqnin respekt ndaj pejgamberëve të tyre, që i lëndonin dhe u bënin shumë tortura atyre. Prej njerëzve që nuk kanë besim dhe respekt ndaj pejgamberëve, nuk mund të pritet që t’i dëgjojnë, kuptojnë dhe t’i zbatojnë në jetë mesazhet Hyjnore. Atëherë, lehtësisht mund të themi se takimi me mesazhin Hyjnor është një

1. Huxhurat, 1-2.

2. Muxhadele, 12. Dispozita e këtij ajeti është shfuqizuar më vonë. (Muxhadele, 13). Por disa sahabë kanë vazhduar të japin lëmoshë para se të flisnin me të Dërguarin e Allahut (a.s.).

proces që fillon me besimin dhe respektin ndaj të Dërguarit.

Dashuria me gjithë zemër e shpirt ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.)

Tri pikat e para të radhitjes së dashurisë që Allahu Teala dëshiron t’i shohë te besimtarët janë: 1-Dashuria ndaj Allahut (xh.xh.), 2-Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe 3-Dashuria për xhihadin në rrugën e Allahut. Në ajetin fisnik thuhet:

“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.” (Teube, 24.)

Edhe në një ajet tjetër thuhet: **“I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëritjetrin...”** (Ahzab, 6.) Përderisa dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), të mos jetë në këtë nivel, edhe besimi nuk konsiderohet i plotësuar.

Ndihma ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.)

Allahu i Madhëruar kërkon nga të gjithë besimtarët që të qëndrojnë pranë Hz. Pejgamberit, ta mbështesin atë në kauzën e tij dhe të sakrifikojnë pasurinë e jetën e tyre në këtë rrugë. Në ajetin fisnik thuhet:

“O ju që keni besuar! Bëhuni ndihmësit e Allahut, ashtu siç u tha dishepujve Isai, i biri i Merjemes: “Kush janë ndihmësit e mi përçështjen e Allahut?” Dishepujt u përgjigjën: “Ne jemi ndihmësit e Allahut!” Kështu, një pjesë nga bijtë e Izraelit e besoi, kurse pjesa tjetër e mohoi. Prandaj Ne i forcua besimtarët kundër armikut të tyre dhe ata dolën ngadhënjimtarë.” (Saf, 14.)

Allahu i Lartësuar, ndihmën ndaj pejgamberëve të Tij, e ka konsideruar ndihmë ndaj vetë Atij, sepse kauza e pejgamberëve nuk është një kauzë që u shërben dëshirave vetjake të tyre, por është kauza e Zotit (xh.xh.). Të gjithë besimtarët, deri kur të shpërthejë Kiameti, kudo që të jetojnë, janë të obliguar t’i zbatojnë në jetën e tyre mesazhet e pejgamberëve dhe t’i ndihmojnë ata.

Bindja ndaj të Dërguarit të Allahut

I Dërguari i Allahut, (a.s.), siç na ka njoftuar Allahu Teala, nuk flet sipas dëshirave të tij, por flet vetëm duke u bazuar në Shpalljen Hyjnore.³

3. Nexhm, 3-4.

Atëherë, bindja ndaj Pejgamberit është bindje ndaj Allahut (xh.xh.). Në ajetin fisnik thuhet:

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjane, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.” (Nisa, 80.)

Nisur nga ky këndvështrim, ne nuk kemi të drejtë zgjedhjeje në bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Prandaj, ajo që na takon neve është që të themi: “Dëgjuam dhe u bindëm.”

Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe pasimi i tij

I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, është shembulli më i bukur për ata që e besojnë Allahun dhe Ditën e Gjykimit, dhe që dëshirojnë ta përkujtojnë shumë Zotin (xh.xh.).⁴ Morali i tij është i lartë dhe dëshmohet edhe nga Allahu Teala.⁵ Ai, siç është vetë në rrugën e drejtë, edhe njerëzit e tjerë i fton në rrugën e drejtë. Mënyra e vetme për t’u bërë një mysliman të cilin e do Allahu dhe prej të cilit është i kënaqur, është pasimi i gjurmëve të Profetit. Në ajetin fisnik thuhet:

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, në mënyrë që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjyaset! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.” (AlImran, 31.)

Nënshttrimi me gjithë zemër ndaj gjykimeve që jep i Dërguari i Allahut, (a.s.)

Detyra me të cilën ngarkohet besimtari, kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), jep një gjykim në lidhje me ndonjë çështje, është që t’i nënshtrohet atij me gjithë zemër. Nëse besimtari nuk shfaq një nënshttrim të tillë, atëherë do të thotë se ka dyshime në shëndetin e besimit të tij, sepse ky ajet fisnik është jashtëzakonisht i qartë në lidhje me këtë çështje:

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.” (Nisa, 65.)

Marrja e edukimit dhe mësimi nga i Dërguari i Allahut, (a.s.)

Kur Zoti (xh.xh.), deklaroi detyrat e të Dashurit

të Tij dhe shprehet se Pejgamberi (a.s.), është një mirësi për njerëzimin, thotë se ai “ua mëson Librin e urtësinë besimtarëve dhe se i pastroi ata”.⁶ Po, ai është një mësues që na mëson mesazhet Hyjnore dhe urtësitë e të vërtetave në lidhje me jetën dhe ngjarjet. Ai na i lexon dhe na i shpjegon nga të gjitha aspektet ajetet e zbritura në Kuranin Fisnik dhe na mëson mënyrën se si duhet t’i lexojmë argumentet ontologjike që gjenden në gjithësi. Nisur nga kjo përjasje, marrja e dijes dhe urtësisë që vjen nga ai, duhet të jetë njëra prej dëshirave më të mëdha të çdo besimtari.

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është edukuesi dhe udhërrëfyesi që e pastroi njerëzimin nga çdo lloj papastërtie dhe e pajis me virtyte. Bazuar në këto që thamë, mund të shprehemi se në formimin e personalitetit Islam nuk mund të merret ndonjë rezultat nëse nuk ndiqet udhëzimi, tradita dhe metoda e Hz. Pejgamberit. Nisur nga ky aspekt, vatra për ta përsosur njeriun e papjekur është vatra e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Mbajtja e lidhjes me të Dërguarin e Allahut, (a.s.)

Zbatimi në jetë i mesazheve Hyjnore që ka sjellë i Dërguari i Allahut, (a.s.), përvetësimi i sunetit të tij dhe dërgimi i salavateve në mënyrë të vazhdueshme ndaj tij, është ajo që kërkon Zoti (xh.xh.), prej nesh dhe në të njëjtën kohë është detyra jonë si besimtarë.

Çfarë qëndrimi prej besimtari mund të jetë kufizimi i lidhjes me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), vetëm me besimin dhe predikimin e Kuranit, duke i neglizhuar të gjitha këto të drejta që Pejgamberi (a.s.), ka ndaj nesh, dhe duke e neglizhuar të qenit e tij mëshirë për ne? Sa është e mundur që të bëhemi besimtarë që i do Allahu dhe prej të cilëve është i kënaqur, madje, sa është e mundur që të mbetemi besimtarë me një përjasje të tillë? Çfarë myslimanizmi është nënvlerësimi dhe neglizhimi i sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ndërkohë që suneti i tij është komentimi, shpjegimi dhe zbatimi në jetë i Kuranit Fisnik? Si mund të qëndrojmë pranë të Dërguarit të Allahut, (a.s.) dhe me cilësinë “ummet i tij” në ditën e Kiametit, duke pasur një përjasje të tillë? Prandaj i kërkojmë mbrojtje Allahut nga rënia në një turp dhe privim të tillë!



4. Ahzab, 21.

5. Kalem, 4.

6. Al Imran, 164.



Prehja shpirtërore

— Salih Zeki Meriç —

Çfarë po kërkojmë? Çfarë na duhet? Cili është objektivi pas të cilit rendim me të gjitha fuqitë tona, për të cilin po shkatërrojmë botën shpirtërore dhe për të cilin kemi harruar edhe veten tonë? Çfarë po ndjekim? Çfarë është kjo pangopësi dhe ky tamah, edhe pse na është shpjeguar ajo që është e mjaftueshme për ne?

Ne e kemi humbur prehjen shpirtërore, edhe pse na janë dhënë ndjenja të pastra e të lehta si një pikë ujë dhe të brishta si një flutur. Ne e kemi humbur gjallërinë spirituale dhe prehjen që i është dhuruar shpirtit tonë. Në botën tonë të brendshme, e cila duhet të jetë modeste dhe e sigurt si një port i qetë, po tentojmë të shkaktojmë furtuna, uragane dhe kaos. Prehja shpirtërore ishte gjëja e parë që humbëm në rrugën për ta gjetur atë. Edhe pse themi se po kërkojmë prehjen shpirtërore dhe se qëllimi i jetës sonë është gjetja e saj, gjëja më e shtrenjtë që kemi humbur që në fillim të rrugës është vetë prehja shpirtërore. Ne e kemi humbur papritur prehjen shpirtërore. Atë e kemi humbur dalëngadalë dhe pjesë-pjesë. Ne e kemi humbur atë edhe në aspektet shpirtërore që na bëjnë njerëz. Prej nesh është humbur pjesë-pjesë prehja e mendjes, prehja e zemrës, prehja e gjuhës dhe prehja e trupit. Ndërsa shoqëria që është formuar nga bashkimi i këtyre individëve pa prehje shpirtërore, ka nxjerrë në pah masa njerëzish që janë bllokuar në mes të halleve dhe dhimbjeve. Shumë kohë kemi pritur që të na vijë

një dorë dhe të na shpëtojë, por ja që edhe atë dorë e kemi kërkuar në vende të gabuara.

Para së gjithash, prehjen e kemi humbur në zemër. Në vend që zemrat tona të kenë prehje dhe thellësi shpirtërore, ato i ka pushtuar ngurtësia, ashpërsia dhe ftohtësia. Ndërkohë që zemrat tona duhet të ishin burime mëshire, ato i ka kapluar myshku si ujëvarën e thatë. Ndjenjat negative e kanë pushtuar shpirtin tonë. Këto ndjenja si urrejtja, mllefi, egoizmi, smira dhe mendjemadhësia, e kanë shkatërruar pastërtinë tonë dhe i kanë djegur luginat pjellore e barishtet me erë pranvere të zemrave tona. Ndërkohë që një mijë e një lloje gjallesash jetonin në luginën e zemrave tona, tashmë në këtë atmosferë të thatë nuk ka mbetur frymë për të na mjaftuar as neve. Pasi e humbëm prehjen shpirtërore nga zemra, na ndryshuan edhe këndvështrimet ndaj njëri-tjetrit dhe jemi shndërruar në karaktere që nuk durojmë askënd. Për këtë arsye, të gjithë botën tonë të ndjenjave e kanë kapluar ferrat dhe shkurret, si tokën e shkretë. Ky vendi ynë i rrallë që duhej të ishte burim i mëshirës, ka degraduar në një gjendje shumë larg origjinalitetit të tij. Zemrat tona që duhej të ishin të ndjeshme, tashmë nuk kanë asnjë shenjë mbetjeje nga ndjeshmëria. Zemrat tona janë të brengosura dhe të pikëlluara për shkak të padrejtësive që u kemi bërë. Ne nuk e ruajtëm dot amanetin e zemrës. Të mos harrojmë se zemra është vendi i vetëm ku shikon

Zoti (xh.xh.). Zemra është kapiteni i trupit. Ajo është amaneti i bekuar që mundëson përhapjen e prehjes shpirtërore në çdo anë të trupit tonë.

Humbja e prehjes shpirtërore është reflektuar në fjalët e gjuhës sonë. Ne e kemi humbur edhe qetësinë në gjuhën e të folurit të përditshëm, edhe gjuhën ideale në marrëdhëniet sociale.

Ndërkohë që kemi ardhur për t'i rregulluar zemrat... Ndërkohë që duhej t'i jepnim një kuptim të veçantë ekzistencës sonë me gjuhën e Junusit dhe zemrën e Mevlanës...Ndërkohë që thyerja e një zemre ka qenë më e rëndë për ne se shkatërrimi i Qabesë... Ndërsa tashmë kemi veshë të mbyllur që nuk dëgjojnë, sy të verbër që nuk shikojnë dhe zemra të ngurta që nuk i ndejnë britmat e zemrave që kemi thyer. Edhe pse jemi njerëz të një civilizimi që e ka gjetur rrugën e drejtë nga zemra në zemër, tashmë nuk ia hapim dot rrugën e zemrës askujt, sepse i kemi mbyllur të gjitha portat e zemrave tona. Ato i kemi mbyllur me kyçe të mëdha dhe çelësat i kemi hedhur në det. Veten që do të na ngjallë zemrat, e kemi burgosur pas hekurave të ndryshkur.

Për shkak të të gjitha këtyre humbjeve, kemi humbur edhe prehjen shoqërore. Në pah ka dalë një tip njeriu që i rrjedh urrejtje nga sytë në vend të dashurisë, që kërkon gjithmonë të keqen në vend të së mirës dhe që është pesimist e i zymtë, në vend që të ketë ndjenja të pastra e të dëlira. Sa keq për këtë shoqëri!

Ne jemi bërë si ata të pashpresët që presin në krye të gërmadhës. Prandaj, si do të gjallërohem dhe do të ngrihem përsëri në këmbë ndërkohë që gjendemi në këtë gërmadhë mjaft shqetësuese? Nga do t'ia fillojmë? Cilin aspekt do të rregullojmë së pari?

Nisur nga këto që thamë, ne jemi të detyruar t'u japim ndjeshmëri zemrave tona, thellësi ndjenjave tona dhe rrjedhshmëri gjuhëve tona, duke u kthyer përsëri te cilësitë njerëzore që ua dimë emrat, burimin dhe recetën. Së pari si individë, çdo punë e jona duhet të kryhet në formën më të bukur. Njerëzit që kemi përreth gjithmonë duhet t'i trajtojmë me mirësjellje. Ne duhet të kemi hijeshinë që u jep prehje dhe qetësi zemrave. Të qenit një besimtar i pjekur, me karakter, i qëndrueshëm dhe i sjellshëm, që ngopet vetëm me ushqimin shpirtëror që u jep thellësi shikimeve tona, janë kushtet e para për ta arritur prehjen shpirtërore...



DIJE E VËRTETË BESIM I VËRTETË

— Ali Riza Temel —

Dije do të thotë aftësi që t'i perceptosh ngjarjet dhe ekzistencën me dimensionet e tyre të vërteta, t'i nxjerrësh në pah të fshehtat dhe t'i vlerësosh gjërat a ngjarjet në mënyrë objektive, pa u ndikuar nga ndjenjat si dashuria, urrejtja dhe epshi. Ndërsa besim do të thotë pranim i diçkaje me siguri të plotë dhe duke e aprovuar vërtetësinë e saj.

Baza e Islamit është dija e vërtetë dhe besimi i vërtetë. Vërtetësia e besimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me saktësinë e dijes. Për këtë arsye, dija vjen para besimit, sepse njeriu me anë të dijes merr vendim mbi çfarë dhe si do të besojë. Fakti që Islami ka filluar me urdhrin “Lexo!”, nxjerr në pah përparësinë e dijes.

Burimet për marrjen e dijes janë organet e pesë shqisave, mendja dhe Shpallja Hyjnore. Për të qenë dija e saktë, organet e shqisave duhet të jenë të shëndetshme, mendja duhet të jetë e qartë dhe lajmi në lidhje me Shpalljen duhet të jetë mutevatir, domethënë, absolutisht larg mashtrimit.

Marrja e dijes së saktë dhe pasimi i kësaj dijeje, është detyra më kryesore e myslimanit. Ndërsa besimi i hamendësimeve, imagjinatave, besëtyt-

nive, lajmeve të zakonshme dhe pohimeve në kundërshtim me sunetull-llahun/sistemin që ka vendosur Allahu, është mëkat. Allahu i Lartësuar na kërkon që të bëjmë kujdes kundrejt kësaj gjendjeje dhe shprehet:

“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.” (Isra, 36.)

“O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt padashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.” (Huxhurat, 6.)

Në lidhje me ata që e lënë Allahun (xh.xh.), dhe pasojnë idhujt pa pasur dije, thotë:

“... Vetëm Allahu udhëzon në rrugë të drejtë! E pra, pas cilit ia vlen të shkosh, pas atij që udhëzon në rrugë të drejtë apo pas atij i cili as vetë nuk është në rrugë të drejtë, veç nëse e shpie dikush? Çfarë keni? Si po gjykoni kështu?!” Shumica e tyre veprojnë vetëm sipas hamendjes. Në të vërtetë, hamendja nuk e zëvendëson aspak të vërtetën. Allahu, pa dyshim, e di mirë atë që punojnë ata.” (Junus, 35-36.)

Kjo shprehje, në lidhje me hamendjen, tregon një rregull shkencor universal. Bazuar në këto ajete, ata që e pranojnë për udhërrëfyes Kuranin Fisnik janë të obliguar t'i pastrojnë mendimet, dijen, jetën dhe besimin e tyre nga çdo lloj besëtytnie, bidati dhe përqasjeve të pabaza.

Kurani Fisnik u drejtohet atyre që janë të mençur dhe i qorton ata që ndjekin vetëm dëshirat dhe epshet e tyre: **“...Ja, kështu Ne ua shpjegojmë shenjat Tona njerëzve që mendojnë, por keqbërësit, nga padituria ndjekin qejfet e veta...”** (Rum, 28-29.) Dëshirat, epshet dhe ndjenjat që nuk gjenden nën kontrollin e mendjes dhe të Shpalljes Hyjnore, gjithmonë e çojnë njeriun në rrugë të gabuar. Të vërtetat më së shumti arrihen nëpërmjet fakteve, jo nëpërmjet ndjenjave. Dashuria e urrejtja e tepërt, dhe mbajtja e një ane, janë pengesë për një shikim dhe mendim të saktë. Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, e tregon kështu këtë të vërtetë: **“Dashuria kundrejt një gjëje të bën të verbër dhe të shurdhër.”** (EbuDavud, Edeb, 125.) Edhe i ndjeri Gazaliu është shprehur për temën, duke nxjerrë në pah këtë problem të njeriut: “Njeriu ka dy dobësi të mëdha. Ai nuk sheh mangësi kur

dashuron dhe aftësi kur urren.” Këto përqasje të ndjeshme janë pengesë për dijen e saktë dhe të vërtetë.

Edhe mania e imitimit dhe fanatizmi që kanë njerëzit, janë ndër pengesat më të mëdha për marrjen e dijes së vërtetë. Edhe ndjenja e përkatësisë, që shkon përtej dashurisë, urrejtjes dhe interesit, është pengesë për të parë të vërtetën. Në ajetin fisnik thuhet: **“Kur atyre u thuhet: “Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!” ata përgjigjen: “Jo! Ne do të ndjekim atë udhë në të cilën i kemi gjetur të parët tanë.” Po nëse të parët e tyre nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar?!”** (Bekare, 170.) Njerëzit e tillë, në ajetin vijues krahasohen me kopenë që dëgjon zërin e bariut, por që nuk kupton asgjë. Islami kurrë nuk pranon që shoqëria të jetë në gjendjen e një kopeje. Secili prej nesh është përgjegjës për fjalët dhe veprimet e veta. Askush nuk ngarkohet me gjynahut e ndokujt tjetër.

Pasimi i të tjerëve në mënyrë të verbër, ka një faturë të rëndë edhe në këtë botë, edhe në Botën e Përtejme. Ata që rendin pas të tjerëve pa u menduar, siç shkon i verbri pas shkopit të tij, në të ardhmen do të përjetojnë pendesë të thellë. Ajeti fisnik shprehet në lidhje me njerëzit e tillë:

“Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: “Ah, sikur t'i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit!” Dhe do të thonë: “O Zoti ynë, ne iu bindëm parisë sonë dhe eprorëve tanë, por ata na shmangën prej rrugës së drejtë. O Zoti ynë, atyre jepu dënim të dyfishtë dhe mallkim të madh!” (Ahzab, 66-68.) Ky pendim veçanërisht shprehet edhe kështu: **“... Sikur të kishim dëgjuar ose menduar, nuk do të ishim midis banorëve të Zjarrit Flakërues!”** (Mulk, 10.)

Të mësuarit dhe të shpjeguarit e fesë në mënyrë të saktë është çështje specializimi. Siç nuk mund të vizitohemi te çdo njeri që thotë se është mjek, edhe feja nuk mund të mësohet nga çdo njeri që thotë se është hoxhë. Siç keqpërdoren shumë gjëra nga shumë njerëz, edhe feja dhe vlerat e saj po keqpërdoren nga disa mashtrues dhe tinëzarë, që janë strehuar pas petkut të fesë e të hoxhës ndërkohë që adhurojnë famën, epshin dhe pasurinë. Ky rrezik ka ekzistuar dje, ekziston edhe sot dhe do të ekzistojë gjithmonë. Dëmi që u shkaktojnë nga brenda besimtarëve dhe fesë këta mashtrues

të kamufluar me gëzofin e qengjit, është shumë më i madh se dëmi që u shkaktojnë të pafetë nga jashtë, të cilët sulmojnë haptazi. Hipokrizia është arma më e rrezikshme, sepse ndarja e një të vërtetë nga ajo që është fallso, është jashtëzakonisht e vështirë. Ngjasimi i jashtëm është mashtrues. Floririn e vërtetë nga ai fallso mund ta dallojnë vetëm argjendarët. Ngaqë të gjithë nuk mund të jemi argjendarë, atëherë e kemi kusht që të kërkojmë dhe të gjejmë një argjendar besnik, në mënyrë që të mos mashtrohemi. Në ajetin fisnik thuhet:

“...Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhën), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët.” (Zumer, 17-18.)

Ata që e shesin veten me lajka të ndryshme, ata që thonë se takohen vazhdimisht me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ata që derdhin lot krokodili, ata që përpiqen të shfaqin letërsi dhe ata që përpiqen t'i fshehin budallallëqet e tyre prej Faraoni me perdet e modestisë, në vend që t'ua shpjegojnë fenë njerëzve me metodën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), nëpër katedra dhe minbere, janë banditë që ia presin rrugën fesë. Këta banditë të fesë, që kamuflohen me petkun e devotshmërisë, po na i shkatërrojnë vlerat tona shpirtërore dhe materiale. Tashmë kanë dalë në pah edhe persona që bashkëpunojnë me armiq-të. Allahu Teala e ruajt ummetin nga e keqja e njerëzve të tillë!

Të qenit mysliman dhe të shfaqurit si mysliman, sigurisht që nuk janë e njëjta gjë. Këtë ummet më së shumti e kanë mashtruar ata që janë shfaqur si myslimanë. Fetarizmi nuk është çështje reklame. Ai që nuk qan kur është vetëm, por kur është para xhematit, është mashtruesi më i madh. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë! Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin.”** (A'raf, 55.)

Përgjatë të gjitha periudhave kanë dalë shumë dallkawkë dhe sharlatanë që i kanë mashtruar njerëzit gjoja se komentojnë ëndrrat, marrin frymëzim Hyjnor dhe bëjnë mrekulli. Ne nuk i mohojmë ëndrrat, frymëzimet dhe mrekullitë, por këto nuk janë mjete dijeje që mund t'i posedojnë të gjithë. Ëndrra e pejgamberëve, të sinqertëve dhe të devotshmëve sigurisht që nuk janë e njëjtë

gjë me ëndrrën e të devijuarve dhe mëkatarëve. Atëherë, si mund të ndahen ëndrrat e shejtanit nga ëndrrat e Zotit (xh.xh.)?

Veprat që janë në kundërshtim me Sunnetull-lahun, janë në kundërshtim edhe me Kuranin Fisnik, edhe me Sunetin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Mrekullitë janë aftësi të mbinatyrshe që u janë dhënë profetëve. Ato janë gjendje të veçanta që shfaqen për t'i bindur ata që i kanë mendjet dhe zemrat e kyçura. Në të vërtetë, çdo gjë është mrekulli për atë që shikon. Çdo gjë tregon ekzistencën dhe njësimin e Allahut të Lartësuar. I gjithë universi është vepër e Zotit (xh.xh.). Prandaj, feja që ka dërguar Zoti, asnjëherë nuk bie në kundërshtim me vepren e Tij.

Ka dy lloj librash. Njëri është libri i gjithësisë (pra, vetë universi) që nuk ka shkronja, ndërsa tjetri është Kurani Fisnik i cili ka shkronja dhe është komentuesi i librit të parë.

Njeriu ka një kureshtje të madhe kundrejt gjërave të mbinatyrshe. Prandaj kanë dalë shumë mashtrues që e kanë shfrytëzuar këtë kureshtje. I Dërguari i Allahut, (a.s.), gjithmonë ka jetuar si një rob modest dhe nuk i ka toleruar ekzagjerimet. Ai është shprehur: **“Mos më lartësoni siç e kanë lartësuar tepër të krishterët birin e Merjemes, Isain. Unë jam vetëm rob i Allahut. Mua m'u drejtoni duke më thënë: Robi dhe i Dërguari i Allahut.”** (Buhari, Enbija, 48.)

Ditën kur ndërroi jetë biri i Pejgamberit (a.s.), Ibrahim, ndodhi eklipsi i diellit. Njerëzit e komentuan këtë ngjarje sikur kishte ndodhur për shkak të vdekjes së Ibrahimit. Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: **“Me të vërtetë, dielli dhe hëna janë dy krijime të Allahut. Ato nuk e zënë njëra-tjetrën për vdekjen e asnjërit.”**

Dija e vërtetë dhe besimi i vërtetë mësohen nga libra të besueshëm dhe njerëz normalë. Ata që thonë se kanë cilësi të mbinatyrshe, ata që kryejnë veprime të cilat nuk mund të testohen nëse janë apo jo të vërteta dhe ata që mburren e që shtiren, asnjëherë nuk duhet të merren në konsideratë.

Udhërrëfyesi prej të cilit mund ta mësojmë dhe praktikojmë fenë në mënyrën më të saktë është i Dërguari i Allahut, (a.s.), të cilin Allahu Teala e ka cilësuar si **“Usvetunhasene / Shembulli më i shkëlqyer”**, dhe dijetarët e sinqertë e të vërtetë, që janë trashëgimtarët e Hz. Pejgamberit.

Rinia dhe xhamia



— Prof. dr. Mehmet Gërmez —


Allahu çdo njeriu i ka dhënë një afat të caktuar jete në këtë botë. Në gjuhën arabe fjala “jetë” dhe “ndërtim” vijnë prej së njëjtës rrënjë. Prandaj një jetë e cila nuk është e mbushur me ndërtim nuk konsiderohet jetë. Allahu e ka krijuar njeriun prej toke dhe i ka dhënë atij detyrën e ndërtimit në tokë. Në këtë proces ndërtimi, parësor është ndërtimi i zemrës dhe shpirtit, sepse njeriu pa ndërtuar shpirtin dhe zemrën nuk mund të ndërtojë qytete, fshatra, kulturë dhe qytetërim. Çdo njeri për të ndërtuar vetveten ka nevojë për besim dhe për një faltore. Në Ditën e Gjykimit njeriu, pasi të pyetet se ku dhe si e ka kaluar jetën e tij, do të pyetet veçanërisht për periudhën e rinisë e cila në vetvete është pjesa më e rëndësishme e gjithë jetës së tij. (Trimidhi, Sifatu'l Kijame, 1.) Pejgamberi (a.s.), të riun ideal e ka përkufizuar si personin i cili e kërkon lumturinë dhe gëzimin në ibadetin ndaj Allahut. Nga ana tjetër, ka lajmëruar se i riu që mbron nderin dhe zemrën e ka të lidhur me xhaminë në Ditën e Gjykimit do të jetë nën hijen e Allahut. (Buhari, Ezan, 36.) Pejgamberi (a.s.), të riun në rrugë të drejtë dhe të vetëdijshëm për përgjegjësinë që mbart e ka konsideruar si një pengesë të fortë përballë dënimit hyjnor. Sipas Pejgamberit (a.s.), për ndërtimin e një shoqërie të shëndoshë është i një rëndësie jetësore kalimi i periudhës së rinisë në ibadet dhe larg ndalesave hyjnore. Në jetën e Profetit (a.s.), të rinjtë kanë pasur një vend të veçantë. Pejgamberi (a.s.), ndërtonte një komunikim shumë të sigurt dhe të rinjtë që kaluan përmes edukimit të Pejgamberit (a.s.), u bënë gjithsecili nga një pishtar i cili ndriçonte njerëzimin. Ishte ky besim që kishte Pejgamberi (a.s.), tek rinia që e shtyu atë t'u jepte atyre detyra të rëndësishme, duke filluar nga drejtimi tek komandant ushtrie, nga mësimdhënia në tregti. Sahabët e rinj, të edukuar nga Pejgamberi (a.s.), si Ebu Hurejre, Abdullah ibn Omer, Abdullah ibn Mesud,

Abdullah ibn Abbas, Muadh ibn Xhebel, Enes ibn Malik etj., të cilët kanë kontribute të veçanta në ndërtimin e qytetërimit islam. Në qytetërimin islam janë dalluar shumë të rinj të cilët me diturinë, urtësinë, shkencën, poezinë, letërsinë, kulturën, artin, dashurinë i kanë dhënë tonin qytetërimit islam. Në qytetërimin islam të rinjtë gjithmonë janë konsideruar si personalitetet e së ardhmes.

Natyrisht që periudha e rinisë ka edhe vështirësitë e veta. Së pari periudha e rinisë është periudha ku forca, fuqia, entuziazmi dhe dëshira janë në kulmin e tyre. Të rinjtë janë të gatshëm të përqafojnë kulturë të ndryshme, pa i situar vlerat e tyre dhe kanë aftësi t'u përshtaten menjëherë gjendjeve të reja. Kjo sjell tëhuajzimin e tyre me shoqërinë, përplasjen e brezave dhe krizë identiteti. Dhe si përfundim, një rini e shkëputur nga familja, nga vlerat fetaroshpirtërore, një rini e cila vrapon mbas përmbushjes së dëshirave momentale krejtësisht larg idealeve, normalisht që e ka shumë të vështirë për të përballuar dhe luftuar sëmundjet e kohës.

Rinia e sotme e konsideron botën e paraardhësve të ngushtë dhe të papranueshme. Prandaj është e rëndësishme që në komunikim me rininë të ndërtojmë një mënyrë të re. Rinia e sotme i jep rëndësi të madhe individualitetit, prandaj ne nuk duhet të ndërhyjmë në çështjet individuale të tyre, por duhet të krijojmë ura komunikimi me zemrën dhe botën e tyre të mendimeve, të bisedojmë dhe t'u paraqesim atyre një model përmes të cilit të zbulojnë veten e tyre. Është e vërtetë që të rriturit kanë probleme të theksuara në krijimin e një komunikimi normal me brezin e ri, por kjo vjen edhe nga fakti që ne jemi mësuar vetëm t'u flasim atyre, por në të vërtetë ne më tepër se t'u flasim duhet t'i dëgjojmë ata. Kjo është një domosdoshmëri për t'i kuptuar dhe hyrë në botën e zemrës së tyre.

Lutja jonë është rritja e një rinie e cila mbron vlerat shpirtërore dhe merr përsipër përgjegjësitë për të ardhmen!



Harith ibn Asim el-Esh'ariu

- RADIJALLAHU ANHU -

njëri prej luftëtarëve të Uhudit

— Mustafa Erish —

Harith ibn Asim el-Esh'ariu (r.a.), ishte një fatlum që kishte merituar lutjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.)!.. Ai ishte njëri prej luftëtarëve të Uhudit dhe një sahab që njihet me llagapin Ebu Maliku!.. Ai është transmetuesi i hadithit i cili fillon në formën: “Pastërtia është gjysma e besimit...”, dhe që vazhdon: “Të gjithë e nxjerrin veten në treg në mëngjes. Dikush e çliron veten dhe dikush tjetër e shkatërron atë.”

Ai e kishte prejardhjen prej fisit të njohur el-Esh'ari nga anët e Jemenit. Kështu që kuptohet se ka lindur dhe është rritur në ato vise.

Në literaturën islame nuk gjenden shumë informacione në lidhje me jetën e Harith ibn Asim el-Esh'ariut (r.a.). Për sa u përket çështjeve se si është bërë mysliman dhe se si ka emigruar në Medinë, nuk gjendet asnjë e dhënë. Thuhet vetëm se ai ka qenë prej luftëtarëve të Uhudit. Përveç të tjerash, ka të dhëna se ai ka transmetuar njëzet e shtatë hadithe nga i Dërguari i Allahut, alejhi's-salam. (Isabe, II, 165.)

Ky hadith fisnik, i cili është i njohur ndërmjet këtyre transmetimeve, përmendet kështu në “Përkthimin dhe Shpjegimin e Rijazu's-Salihin”: Ebu Malik Harith ibn Asim el-Esh'ariu (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qof-

të mbi të, ka thënë: “Pastërtia është gjysma e besimit. Falënderimi i Allahut (el-hamdulil-lah) e plotëson peshoren, ndërsa lavdërimi dhe falënderimi i Allahut (subhanall-llah dhe el-hamdulil-lah) mbushin me sevape hapësirën ndërmjet tokës dhe qiejve. Namazi është dritë. Lëmosha është argument dhe durimi është shkëlqim. Ndërsa Kurani është argument ose pro, ose kundër teje. Të gjithë në mëngjes (dalin në treg) dhe e shesin veten. Dikush e çliron veten dhe dikush tjetër e shkatërron atë.” (Muslim, Taharet, 1. Veçanërisht shik. Tirmidhi, Daavat, 86.)

Çdo nen i këtij hadithi fisnik tregon nga një të vërtetë të rëndësishme. Prandaj ky hadith, i cili përfshin shumë çështje, është si një recetë për ne, e cila na ndihmon për të marrë nën kontroll jetën tonë të përditshme. Ky hadith është një udhërrëfyes për rrugën tonë, që të bëhemi myslimanë të devotshëm dhe robër të mirë të Zotit (xh.sh.). Ky hadith në “Përkthimin dhe Shpjegimin e Rijazu's-Salihin” shtjellohet në formë nenesh. Në shpjegimin e pjesës së fundit të hadithit, thuhet si më poshtë:

“Çdo ditë e re është një treg i ri për të gjithë. Në këtë treg, nga njëri aspekt njeriut i merret kjo botë e bota tjetër, dhe i shiten. Disa persona përpiqen të qëndrojnë brenda kufijve të ligjshëm. Në këtë mënyrë, kalojnë një ditë me fitim. Disa të tjerë nuk bëjnë kujdes kundrejt kufijve dhe kërkojnë t'i plo-



tësojnë dëshirat e tyre me çfarëdo çmimi. Në këtë mënyrë, ata përgatisin për vete një të ardhme që nuk është aspak e dëshirueshme.” Nisur nga këto fjalë, çdo ditë të re myslimani duhet të synojë dhe të përpiqet të bëhet një besimtar i disiplinuar, pra “prej besimtarëve nga të cilët Allahu ua ka blerë veten e tyre”. (Teube, 111.)

Ndërmjet pastërtisë dhe namazit, ndërmjet falënderimit “el-hamdulil-lah” dhe besimit e Kuranit Fisnik, ndërmjet lëshoshës dhe allishverishit në treg, dhe ndërmjet të gjithë këtyre faktorëve dhe durimit, në këtë hadith fisnik ka një lidhje të fortë. Hadithi e përkufizon myslimanin si një njeri që ka besim të mbështetur në durim. Gjithashtu e përkufizon atë si një njeri që bën ibadet, dhikër, mirësi dhe që merret me tregti. Në këtë mënyrë, hadithi kërkon prej nesh që të edukohemi si myslimanë të tillë të denjë.

Përfundimisht, durimi është burim energjie dhe drite për besimtarin. Durimi është kushti themelor për korrijen e fitores dhe arritjen e suksesit, sepse “ndihma e Allahut është për ata që durojnë”. (Bekare, 153.) Durim nuk do të thotë heshtje kundrejt probleme, por do të thotë t’i përballosh me guxim ata. Jeta e përditshme është një skenë tregu. Çdo mysliman duhet të zërë vendin e tij në këtë treg të jetës, si një “mysliman i devotshëm”.

Më poshtë po japim edhe këtë hadith që Harith ibn Asim el-Esh’ariu, radijall-llahu anih, e transmeton nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Ky transmetim është si recetë për gabimet që po ndodhin në shoqëritë tonë.

Ebu Malik el-Esh’ariu (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Nëse vajtuesi nuk pendohet para se të ndërrojë jetë, ditën e Kiametit

do të ngrihet nga varri me një rrobë prej katrani dhe me një këmishë të zgjebosur.” (Muslim, Xhenaiz, 29; Ibn Maxhe, Xhenaiz, 51.)

Ndërkohë që hadithi fisnik nga njëra na tregon ndëshkimin që do të marrë vajtuesi në Botën e Përtëjme, nga ana tjetër na inkurajon për t’u penduar kur shprehet: “Nëse nuk pendohet para se të ndërrojë jetë.”


Derisa shpirti të vijë te fyti, mund të pendohemi për çdo lloj mëkati. Ajo që kërkohet në pendim është lënia në mënyrë të prerë të atij gjynahu dhe kërkimi i faljes nga Allahu Teala. Edhe vajtuesit duhet të heqin dorë nga vajtimi dhe të pendohen duke kërkuar falje për ato që kanë bërë në të kaluarën. Në të kundërt, hadithi na e ka deklaruar krejt qartë ndëshkimin që do të marrin në Ahiret.

Bazuar në hadithin e mësipërm, në fenë tonë është haram vajtimi, qarja duke bërtitur dhe nxitja e të tjerët që të qajnë për të vdekurin. Nëse ai/ajo që vajton, vdes pa u penduar, do të ngrihet nga varri i/e veshur me një rrobë prej katrani dhe një këmishë të zgjebosur. Ne kemi mundësi të pendohemi për çdo mëkat derisa shpirti të vijë te fyti. Prandaj, në vend që të kemi frikë nga mëkati, duhet të kemi frikë nga mospendimi për atë mëkat.

Harith ibn Asim el-Esh’ariu (r.a.), në kohën e Omerit (r.a.), u sëmur nga kolera. Ai nuk shpëtoi dot prej kësaj sëmundjeje dhe u shpërngul për në Botën e Përhershme.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Allahu i Lartësuar na e mundësoftë të gjithëve që të bëjmë një jetë nën dritën e haditheve që ka transmetuar Harith ibn Asim el-Esh’ariu (r.a.)!

Amin!



Një udhëtim me Sheherazaden

(PJESA E DYTË)

— Nuredin Nazarko —

Izolimi është dërrmues. Lodhës për shpirtin. E rëndon. E transformon në pamje të cilat shpërfaqin etjen hakmarrëse të dhimbjeve që vijnë prej izolimit. Qëndrimi në errësirën e izolimit ndryshon perceptimin e njeriut mbi realitetin. Zhvlerëson jetën dhe e bën të duket një mallkim që duhet ta plotësosh dhe jo një bekim që duhet ta përjetosh në të gjitha poret. Kthen njeriun në akull. Verbon zemrën. Urren të bukurën. Dashuron shkatërrimin, përmbysjen, ekzekutimin e atyre që urren në mënyrë që të mbetet vetëm i izoluari dhe madhështia e tij e rreme e errësirës.

Zgjuarsia dhe kuraja janë aleatë besnikë që të shërbejnë si në paqe ashtu dhe në vështirësi. Edhe nëse gjendesh përballë rreziqeve më të mëdha nuk duhet të dorëzohesh duke bërë kurban këta dy aleatë. Nëse ia del t'i mposhtësh me zgjuarsia ata të cilët duan të të dëmtojnë medoemos, do të njohësh karakterin e tyre real. Do të betohen se asnjëherë s'kanë patur qëllime të këqija. Kanë qenë dashamirësit e tu. Kanë dashur të të shohin vetëm mirë, e ku e ku më lart se vetja e tyre. Janë gati të të përulen. Fjalën tënde e konsiderojnë

ligj. Pse kjo sjellje, kur ishin gati të të jepnin shtyrjen e fundit drejt humnerës? Ky ndryshim ndodh, sepse ia ke dalë të fitosh pushtet mbi ta. Prej frikës së ndëshkimit transformohen në krijesa që s'kanë aspak ngjashmëri me kohën kur të kishin në dorë. Kësisoj, trajtimi i situatave me zgjuarsia dhe kurajë, nxjerr në pah pafytyrësinë e disa syresh që janë këmbë e urës. Njohja e thellë e tyre është një mundësi e madhe për t'u ruajtur prej së keqes që sjellin. Duhet gjithmonë syçeltësi.

Të gjendurit në vështirësi, vuajtjet dhe humbja e shpresës për shërim, të bëjnë t'u besosh edhe praktikave më të çuditshme e më të padëgjua shëruese. Kjo ndodh ngaqë shërimi prej vuajtjeve është tepër i dashur, aq më tepër kur kujton kohët e begata. Por nuk duhet të humbësh busullën e të bëhesh viktimë e shëruesve çudibërës që në të shumtën e rasteve arrijnë të kurojnë vetëm xhepat e tu. Por jo të gjithë janë shërues të këtij rangu. Nëse ndokush bëhet shkak për shërimin e vuajtjeve të tua, je gati ta mbulosh me dhurata e pasuri. Përballë lumturisë së shërimit nuk të hyjnë në sy harxhet. E mira duhet shpërblyer me

të mirë. Duhet të jemi mirënjohës ndaj atyre që bëjnë mirë me qëllimin e pastër dhe jo si kusht për të qenë në borxh apo të varur prej tyre. Nuk duhet harruar mirëbërësi. Mirëpo ndodh që njeriu pasi ka dalë nga gjendja e trazuar të harrojë bamirësin e vet dhe jo vetëm kaq.

I ligu gjithnjë qëndron në pusi. Mezi pret rastin e favorshëm të ndezë eshkën e dyshimeve. I mjaftojnë vetëm disa aludime për të goditur dhe tronditur në sytë e të shëruarit vlerën e bamirësit të vet, kinse ka patur qëllime të errëta prej të cilave i shëruari prej vuajtjeve duhet të ketë shumë kujdes. Shërimi është vetëm një grackë -, thotë intriganti. Do të mjaftojë vetëm një çast dobësie dhe nga një do të hapen dhjetë dyer, prej të cilave do të depërtojnë dyshimet që ngre intriganti. Nëse të sheh të lëkundur në qëndrimin tënd, do të nxitojë të të shfaqet si bamirës, duke të dëndur me sajdisje dhe duke stisur situata që ndezin edhe më shumë zjarrin e dyshimeve. Në qoftë se i toleron dyshimet dhe i merr të mirëqena pa patur durim për t'i faktuar, shndërrohen në mulli përbindësh që të bluan së brendshmi. Jo pak herë kjo gjendje ka rezultuar edhe me pasoja të rënda, deri edhe në kryerjen e akteve kriminale. Nënshtrimi ndaj dyshimeve të humb arsyt, të çorienton emocionalisht, të nxit urrejtjen e verbër dhe pafre. Nëse je i mbërthyer nga kjo gjendje je në prag të katastrofës nëse nuk merr antihelmin për të qetësuar shpirtin dhe zemrën.

Mund të jesh vetë protagonist i së keqes, ose të urdhërosh dikë tjetër të bëhet pjesë e së keqes. Në të dy rastet i humburi je ti, ndërsa intriganti, djallëzori që ndezi zjarrin e dyshimeve rri dhe ngroh duart duke të parë ty që digjesh prej trilleve të tij. Anti helmi duhet patur gati në çdo kohë. Dyshimet duhen trajtuar me durim dhe maturi. Po kështu duhet bërë kujdes nga fjalët e atyre që shtiren se na duan të mirën dhe në të njëjtën kohë shërbejnë helmin me mjaltë. Nëse nuk tregohemi të kujdesshëm, drejtësia ndaj padrejtësive që mund të kryejmë nën efektin e dyshimeve do të rëndojë një ditë mbi shpinën e kryerësit të padrejtësisë. Mund t'ia hedhësh drejtësisë njerëzore, por jo asaj qiellore. Prandaj tregohu i kujdesshëm që të mos gërryesh nga brenga e padrejtësisë për aq sa je gjallë.

Gjendjet në jetën e njeriut janë të ndryshueshme. Jo gjithmonë do të ketë gëzime. Pas tyre vijnë vuajtjet. Jo gjithmonë do të ketë vuajtje. Pas tyre do të vijnë gëzimet. Nuk ka një kohë të përcaktuar qartë në dijeninë njerëzore sesa do

të jetë kohëzgjatja fizike e njëres apo tjetres gjendje. Gjendjet janë kaq të ndryshueshme saqë nuk lënë kënd pa prekur. Nuk ka kush të thotë që jeta e tij apo e saj ka qenë krejt e paqtë në gjithë dimensionin kohor që ka jetuar. Madje dhe ata të cilët prej së largu duken se janë duke shijuar shumë më tepër se disa të tjerë, nuk janë të sigurtë se ditët e tyre të mira do të vazhdojnë gjatë. Ata që përpiqen të gjejnë paqen e përhershme në një botë të përkohshme me siguri do të kalojnë në gjendjen e absurdit, sepse janë duke u përpjekur të kalojnë devenë në brimën e gjilpërës. Për t'i shpëtuar kësaj gjendje duhet pranuar që ndryshimi i gjendjeve është një normalitet dhe nuk na mbetet tjetër veç të lutemi që të kemi durimin dhe maturinë e nevojshme për të përballuar me qëndrueshmëri këtë ndryshueshmëri.

Por përveç durimit dhe maturisë lypset dhe diçka tjetër që na e lehtëson dhimbjen e vuajtjeve të ndryshimeve të gjendjes. Miku i mirë që nuk gjurmon dobësitë dhe lodhjet që vijnë prej vuajtjeve për të të telendisur, por të dëgjon me durim duke të lehtësuar barrën e rëndë që shtyp shpirtin në vetmi. Është shumë e rëndësishme kjo mënyrë e të çliruarit nga pesha prej së cilës shtypesh. Shpesh njerëzit kur janë në gjendje tepër të vështira mund t'i rrëfehen madje dhe ndonjë të panjohuri. Kujdes! Jo çdokush dëshiron të të shohë të lehtësuar nga brengat. Prandaj duhet zgjedhur miku të cilit je gati t'i besosh historinë e jetës tënde. Ka plot gjëra që njeriu mund t'ia rrëfejë atij apo asaj që i beson. Por ka edhe plot gjëra që njeriu duhet t'ia rrëfejë vetëm Qiellit. Nxjerrja e brengave jashtë do të të lehtësojë me siguri, edhe pse nuk do t'i japë zgjidhje përfundimtare shqetësimeve. Por vetë lehtësimi, sidomos kur di që ke përballë një mik të drejtë dhe ruajtës besnik të amanetit, është një hap i madh në kthjellimin e gjendjes shpirtërore. Prandaj duhet të shohim se kush na gjendet mik në ditë të vështira. Të vlerësojmë mbajtjen e amanetit si shenjë të vlerave që duhet të ketë njeriu. Kjo, për t'u ndjerë në paqe dhe të sigurt se pesha jote nuk do shpërndahet gjithandej si një histori me të cilën do të mbushin ditën gojët që merren me thashetheme. Për të lehtësuar brengat, vuajtjet le të zgjedhim miq më të mirë se vetja. Një fjalë e mirë në kohë të vështira ndoshta vlen ku e ku më tepër se një ndihmë monetare. Nëse nuk zgjedhim miq të mirë, të mos çuditemi nga pasojat që mund të na përfshijnë.



Virtytet që thurin MYSLIMANIZMIN TONË

— Xhafer Durmush —

Kurani Fisnik është damari i jetës sonë. Ai është njëri prej dy themeleve ku mund të mbështetemi. Ai është burimi i të gjitha cilësive të bukura që e bëjnë jetën të jetueshme.

Kur lexoj këtë ajet në suren Isra: **“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët...”** (Isra, 82.), mendoj këto që thashë më sipër. Unë e di se Kurani Fisnik e rrethon si një det mëshirë jetën e atyre që lexojnë ajetet e tij për të marrë frymëzim dhe mësim. Ai u jep begati zemrave. Disa ajete, disa fjali, madje edhe disa fjalë të tij, ndërtojnë botën mentale dhe shpirtërore të besimtarit. Disa ajete bëhen shprehje për gjuhët e besimtarëve, ndërsa disa të tjera bëhen dije që thurin personalitetin e myslimanëve dhe që i japin drejtim jetës. Ja pra, pikërisht prej këtej buron mendimi se Kurani Fisnik është shërim dhe mëshirë për besimtarët.

Tani dëshiroj të shtjelloj shkurtimisht disa prej virtuteve që janë marrë prej ajeteve e haditheve dhe që kanë ndërtuar shoqëritë myslimane përgjatë shekujve:

1- Besnikëria ndaj premtimit: Të jesh besnik ndaj premtimit do të thotë të qëndrosh në fjalën e dhënë dhe të veprosh si të ngarkon kjo fjalë. E kundërta është tradhti dhe mosmbajtje e fjalës. Aventura e njeriut ka filluar me marrëveshjen që është bërë kur Zoti e ka pyetur: “A nuk jam Zoti yt?” - dhe njeriu është përgjigjur: “Sigurisht që je Zoti im!” Allahu i Lartësuar urdhëron: **“Mbajeni fjalën që e keni dhënë!”** (Isra, 34.) Me këtë urdhër, Ai kërkon që njeriu të shfaqë besnikëri ndaj premtimit. Bazuar në këto që thamë, mund të shprehemi se besnikëria ndaj premtimit të dhënë është boshti i humanizmit.

2- Durimi: Të durosh do të thotë të rezistosh pa u ankuar kundrejt dhimbjeve të fatkeqësive si sëmundja, padrejtësia dhe të tjera të ngjashme me këto. E kundërta e durimit është nxitimi. Në ajetin fisnik është dhënë ky përgëzim: **“Atyre që durojnë do t’u jepet shpërblim pa masë.”** (Zumer, 10.) I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, ka thënë se *“durimi i pra-*

nuar është durimi që shfaqet në momentin e parë të fatkeqësisë”. (Buhari, Xhenaiz, 43.)

3- Falënderimi ndaj Zotit (xh.xh.): Të falënderosh Zotin do të thotë të shprehësh mirënjohje kundrejt Tij për mirësitë që Ai ka dhënë. E kundërta e falënderimit është mosmirënjohja. Në ajetin fisnik ka ardhur ky paralajmërim: **“Prandaj, më kujtoni Mua** (me namaz e lutje) **që Unë t’ju kujtoj** (me shpërblime) **dhe falënderoni Mua** (duke M’u bindur) **e mos i mohoni dhuntitë e Mia** (me mosbindje!)” (Bekare, 152.) I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Besimi përbëhet prej dy gjysmave. Njëra gjysmë është durimi për t’u larguar nga ndalesat Hyjnore dhe gjysma tjetër është falënderimi që përbëhet nga bindja ndaj Allahut duke zbatuar urdhrat e tjerë.”* (Dejlemi, Musned, hadithi nr: 378.)

4- Pranimi i çdo gjëje që vjen nga Zoti (xh.xh.). Kjo do të thotë që të jesh i kënaqur me gjendjen tënde. E kundërta e kësaj është pakënaqësia. I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“O Allah! Kërkoj që të më bësh të kënaqur kundrejt caktimit Tënd!”* (Hakim, Mustedrek, I/724, hadithi nr: 1900.) Pastaj ka dhënë këtë përgëzim: *“Ai i cili është i kënaqur me caktimin e Allahut Teala, arrin pasurinë shpirtërore.”* (Munavi, Kunuzu’l-Hakaik, 141.)

5- Mbështetja te Zoti (xh.sh.): Të mbështetesh ndaj Zotit do të thotë të presësh rezultatin nga Allahu pasi t’i kesh kryer të gjitha detyrat e nevojshme dhe të tregosh nënshtrim ndaj caktimit Hyjnor për kryerjen e një vepre. E kundërta është mosbesim ndaj Allahut Teala dhe privim nga prehja shpirtërore që të jep besimi ndaj Zotit. Në ajetin fisnik besimtarët janë urdhëruar që të thonë: **“...Na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”** (Al Imran, 173.) Kur Hazreti Ibrahim Hakiu flet për rrishtun, tregon edhe për rëndësinë e mbështetjes te Allahu (xh.xh.). Ai shprehet se rrishtu është mev’ud/i premtuar dhe memluk. Kuptimin e këtyre termave e shpjegon si më poshtë: Rrishtu që njeriu do të konsumojë dhe për-

dorë është i premtuar dhe i marrë përsipër nga Allahu Teala. Sasia e tij i shkon njeriut si është ndarë dhe caktuar në amshim. Ndërsa pasuria që njeriu e kursen quhet rrisht mehluk. Këtë pasuri njeriu e ka amanet.

6- Besnikëria: Një kuptim i besnikërisë është edhe ndershmëria. Ndërsa një kuptim tjetër i saj lidhet me të qenit falënderues dhe mirënjohës ndaj atij që na bën ndonjë nder. E kundërta është tradhtia dhe mosmirënjohja. Në ajetin Fisnik ka ardhur ky urdhër: **“Kini frikë nga Allahu dhe qëndroni me të drejtët!”** (Teube, 119.) Ndërsa në një ajet tjetër besimtarët janë mësuar t’i luten Zotit (xh.xh.): **“...O Zoti im! Më shpjer në një hyrje të kënaqur, më nxirr nga një dalje të kënaqur dhe më dhuro nga Ti fuqi, që do të më ndihmojë!”** (Isra, 80.) I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka dhënë këtë sihariq: “E vërteta të çon te mirësia, ndërsa mirësia të çon në Xhenet. Njeriu, duke thënë të vërtetën, shkruhet te Allahu në fletoren e të drejtëve.” (Buhari, Edeb, 69.)

7- Mëshira: Mëshirë do të thotë që të ndjesh në zemër dhimbjen dhe fatkeqësinë e çfarëdo lloj gjallese. E kundërta është tirania. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka mbjellë në zemrat tona farërat e mëshirës duke u shprehur: **“Unë jam dërguar vetëm si mëshirë.”** (Muslim, Birr, 87.) Krahas kësaj, na ka paralajmëruar duke thënë: **“Atë që nuk i mëshiron njerëzit, nuk e mëshiron Allahu.”** (Buhari, Tevhid, 2.)

8- Të mjaftuarit me atë që posedon: Të mjaftohesh me atë që posedon do të thotë të jesh i kënaqur me rrishtun që të ka dhënë Allahu Teala. E kundërta është pangopësia. Në ajetin fisnik thuhet: **“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij...”** (Hud, 6.) Ndërsa në hadithin fisnik është thënë se të mjaftuarit me atë që posedon është një thesar i pafund. (Dejlemi, Musned, hadithi nr: 4699.) Vetëm ky ajet dhe ky hadith janë të mjaftueshëm për

ta shpjeguar vlerën e “thesarit të pashoq” që është ilaçi i të gjitha kërkesave të njerëzve.

9- Bujaria: Të jesh bujar do të thotë t’ua zgjasësh të gjithëve dorën e ndihmës. E kundërta e është koprracia. Në hadithin fisnik, bujari përkufizohet si një pemë, degët e së cilës arrijnë deri në Xhenet. (Bejhaki, Shuabu’l-Iman, VII, 435.) Nga bujaria burojnë edhe cilësitë e tjera të larta si sakrifica dhe altruizmi.

Të gjitha cilësitë e bukura në lidhje me moralin, disa nga të cilat i kemi përmendur më sipër, janë vlera esenciale që thurin personalitetin tonë. Myslimanizmi ynë merr kuptim prej tyre. Për këtë arsye, ne jemi të obliguar që të jetojmë sipas këtyre cilësive të bukura që u japin drejtim ndjenjave, mendimeve dhe veprimeve tona. Gjithashtu duhet t’i ftojme edhe të tjerët që të jetojnë me këto cilësi. Nëse njëra apo disa prej këtyre cilësive nënvlerësohet, atëherë fillojnë problemet në qëndrimin tonë prej myslimani. Pastaj, në vend të këtyre cilësive të bukura vihen të kundërtat e tyre, që janë sjelljet negative.

LEXO MENDO

PËR TË ARRITUR NDIHMËN HYJNORE

Në ajetin fisnik, në të cilin njoftohemi për dy gjëra që na mundësojnë ndihmën Hyjnore, thuhet: **“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit.”** (Bekare, 45.)

Siç shprehet në librat e tefsirit, nga durimi këtu synohet agjërimi, sepse agjërimi dhe namazi e forcojnë besimin, thyjnë mendjemadhësinë e nefsit, largojnë dembelizmin e plogështinë, dhe i japin fuqi për të rezistuar njeriut në kohë të vështira. Sipas një transmetimi të Taberanit, i Dërguari i Allahut, (a.s.), menjëherë falte namaz kur përballej me ndonjë çështje të vështirë.

Nga ajeti fisnik kuptojmë se për ta arritur ndihmën Hyjnore duhet të kryejmë detyrat që ushqejnë durimin dhe namazin duhet ta shndërrojmë në pjesë të jetës. Pas kësaj, në zemër duhet të kërkohet frikërespekti ndaj Zotit (xh.xh.), sepse në ajet thuhet se namazi dhe durimi janë të vështira, përveçse për ata që kanë frikërespekt ndaj Allahut Teala.

Fjalën “hashiin” këtu e kemi përkthyer si “atyre që u dridhet zemra nga respekti ndaj Allahut”. Ja, pikërisht njerëzve të tillë, të cilët posedojnë këtë frikërespekt ndaj Zotit, nuk u vjen i vështirë durimi kundrejt detyrimeve si falja e namazit, mbajtja e agjërit, etj. Ata e kanë arritur këtë gjendje, sepse kanë arritur një pjekuri shpirtërore të tillë që mundëson t’u dridhet zemra kur thuhet “Allah”. Ata kanë arritur një pjekuri të atillë që i çon në përfundimin: “Urdhri i Allahut është mbi çdo gjë.” Prandaj, adhurimet dhe përgjegjësitë që janë të vështira për ata të cilët janë të privuar nga kjo dashuri, nuk janë aspak të rënda për njerëzit e devotshëm. Madje, këto detyra mund të jenë burimi i prehjes shpirtërore që ua qetëson zemrat atyre. Nga kjo kuptojmë se çdo gjë fillon në zemër dhe mbaron po në zemër. Kjo gjendje është e domosdoshme për të falur namazin dhe për t’u bërë prej durimtarëve, në mënyrë që të arrijmë ndihmën e Allahut (xh.xh.).



Namazi dhe koha

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Koha është nga gjërat më të çmuara të njeriut në këtë botë. Koha pa u ndjerë e shpie njeriun drejt botës së amshuar. Koha që në momentin e lindjes së njeriut me shpejtësi fillon të largohet nga ai dhe gjërat e përkohshme të kësaj bote drejt botës së amshuar. Synimi kryesor i saj është mbushja me gjëra të vlefshme që shërbejnë në botën tjetër. Prandaj mos shfrytëzimi i kohës për punë të mirë është konsideruar si humbje e madhe. Sipas këndvështrimit Islam koncepti “kohë e lirë” nuk ekziston siç e shpreh edhe Allahu qartë në Kuran: “**Kur të kryesh një punë menjëherë fillo tjetrën dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!**” (Inshirah, 7-8.)

Sipas ajetit të lartpërmendur për myslimanin nuk ekziston kohë e lirë. Myslmani e vlerëson dhe shfrytëzon kohën sipas nevojave të shpirtit dhe trupit. Në kohën e besimtarit aq sa ka vend për ibadet dhe punë ka hapësirë edhe për pushim dhe argëtim. Personi që e vlerëson kohën sipas mësimave islame nuk mund të ketë kohë bosh dhe të pa shfrytëzuar. Sepse pushimi që i shërben forcës dhe gjallërisë së njeriut në punë dhe ibadet nuk konsiderohet kohë e lirë.

Në vlerësimin dhe shfrytëzimin e kohës i rëndësishëm është qëllimi kurse qëllimi nga ana tjetër ruan freskinë dhe gjallërinë përmes vigjilencës së vazhdueshme.

Në islam të gjitha ibadet si namazi, agjërimi, zekati, haxhi etj janë të lidhur ngushtë me kohën, ata janë obligative në një kohë të caktuar. Agjërimi

është në muajin e Ramazanit, Haxhi në muajin e Dhul hixhes, Zekati është farz kur sasia e caktuar e pasurisë mbi të cilën jepet zekati plotëson vitin. Po ashtu edhe namazi është i lidhur me kohën. Ajeti Kuranor “**...namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar.**” (Nisa, 103.) shpreh varësinë e namazit ndaj kohës. Prandaj midis namazëve farz ka një ndarje kohore të përpiktë. Ndërsa për qëndrimin në këmbë, për abdesin, për drejtimin nga kibla ekzistojnë tolerime për kohën e namazit nuk ka asnjë tolerancë. Ndërsa ai që nuk mundet ta falë namazin në këmbë i lejohet ta falë ulur, ai që nuk gjen ujë për abdes mund të marrë tejemum apo ai që nuk e gjen dot drejtimin e kibles i lejohet të falet në drejtimin që ai e mendon si më të saktë. Kurse namazi kryhet vetëm në kohën e caktuar. Kjo na tregon rëndësinë e namazit në menaxhimin e kohës.

Një ngjarje shumë interesante e ndodhur midis profesorit dhe një studenti në kursin e gjermanishtes tregon neglizhencën e myslimanëve në shfrytëzimin e kohës. Profesori i cili njihej për rreptësi për të siguruar seriozitetin e mësimdhënies dhe vazhdimësinë e pjesëmarrjes zbatonte disa metoda, një ndër këto ishte mbajta e studentit pas mësimit për aq kohë sa ishte vonuar. Studentët të cilët ishin të preokupuar edhe me punë të tjera nuk ishin aspak të kënaqur nga ky lloj dënimi.

Kur një ditë e mbajti në klasë një student për 18 minuta, studenti i zemëruar i tha: Profesor! Kjo që

po bëni është e tepruar. Tani më duhet të iki sepse kam një punë emergjente por për respektin ndaj jush, dënimin do ta kryej një herë tjetër.

Profesori i vrenjtur tha:

- Si kur ju t'i jepnit rëndësinë e duhur punëve emergjente nuk merrnit këtë dënim. Sepse edhe mësimi është emergjent për ju. Pas një heshtje vijoi:

- Studentë të dashur ju nuk e shfrytëzoni si duhet kohën, madje zemëroheni për kujdesin që tregoj unë ndaj menaxhimit të kohës.

Pastaj nga çanta nxori një broshurë ku ishin shënuar oraret e trenit dhe kërkoi prej studentëve ta shikonin me kujdes, pastaj u lexoi oraret e nisjes dhe mbërritjes duke i shkruar në tabelë nisja: 18:18, 21:35, mbërritja: 12:46, 9:27.

Pastaj tha, juve këto mund t'ju duken të ekzagjeruar por në fakt ne evropianët këto i kemi mësuar prej myslimanëve. Sepse për ju koha është shumë e rëndësishme. Ju çdo adhurim e keni të përcaktuar në varësi të kohës. Për më tepër që kohët janë të përcaktuar me përpikëri si oraret e trenit. Për shembull koha e namazit të sabahut fillon në 6:20 dhe mbaron në 7:12. Dhe ky rregullim ndryshon çdo ditë nga një, dy minuta. Prandaj myslimanët duhet të jenë të përgatitur për të vlerësuar siç duhet kohën sepse ata janë të detyruar t'i përshtaten sipas minutave që ndryshojnë çdo ditë. Në këtë mënyrë profesori i dha një mësim të mirë studentëve në lidhje me kohën. Kjo është një ndodhi që duhet të na bëjë të reflektojmë më shumë rreth çështjes së kohës.

Namazi i cili është ibadeti më i vlefshëm dhe i rëndësishëm krahas ndihmës që i jep myslimanit për të vlerësuar dhe menaxhuar si duhet kohën, e ndihmon atë të largohet dhe qëndrojë larg veprave të këqija. Kurani këtë fakt e evidenton në këtë mënyrë: **“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.”** (Ankebut, 45)

Nga ajeti mësojmë që namazi që kryhet siç duhet e lartëson shpirtërisht dhe e mbron nga të këqijat njeriun. Rruga e vetme për të shpëtuar nga dëshirat dhe presioni i egos dhe për të jetuar një jetë të qetë dhe të lumtur është lidhja e zemrës me Allahun. Namazi është një lidhje e fortë e cila krijon qetësi dhe bëhet një mburojë e fortë për besimtarin përballë tundimeve dhe joshjeve të ndryshme të kësaj bote.

Por jo çdo person që fal namazin mund ta arrijë këtë. Ne jemi dëshmitarë të shumë njerëzve që megjithëse falin namaz nuk arrijnë të shkëputen nga veprat e këqija. Atëherë ku qëndron problemi? Si shpjegohet gjendja e këtyre personave që megjithëse

falin namaz nuk mundin të shpëtojnë prej mëkateve. Cilat janë shkaqet që e pengojnë përmbushjen e këtij premtimi hyjnor?

Në lidhje me shkaqet që çojnë në këtë mund të numërojmë:

1. Një pjesë e njerëzve janë të pavetëdijshëm për madhësinë e namazit. Falja e namazit iu është bërë rutinë e përditshme. Thënë ndryshe namazi i tij ka humbur veçorinë e qetësisë. Ajeti Kuranor **“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre”** (Muminun, 1-2.) aludon pikërisht për qetësinë dhe përkushtimin shpirtëror në namaz. Kur në ajet tjetër qorton ata që janë të pakujdesshëm ndaj namazit **“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet”** (Maun, 4-5.) Prandaj një namaz i cili është privuar nga përqendrimi, qetësia dhe përkushtimi nuk mund ta pengojë njeriun nga e këqija.

2. Disa njerëz e kryejnë namazin për syfaqësi dhe për përfitime materiale. Kjo kryesisht ndodh me personat, zemra e të cilëve është e ndotur nga hipokrizia. **“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtronë Allahun, por është Ai që i mashtron ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t'u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.”** (Nisa,142.) **“Ata duan vetëm që të duken dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve.”** (Maun,6-7)

3. Kurse të tjerë tregojnë dembelizëm në kryerjen e ibadeteve. Mirëpo Islami është një i tërë dhe mund të funksionojë vetëm si i tërë, zinxhiri i ibadeteve dhe të gjitha vlerat morale mbështesin njëra-tjetrën. Plogështia, shkuajdesja dhe mefshtësia në njërin nga ibadetet ndikon në prishjen e ekuilibrit dhe për pasojë mos e rritjen e pritshmërisë së synuar prej ibadeteve. Pra nuk mjafton vetëm të falet namazi por krahas namazit duhet treguar kujdes edhe ndaj adhurimeve të tjera.

Sipas Ibn Haxher Askalanit përfitimet që ka personi prej namazit që falet siç duhet janë:

1- Shëndeti

2- Begati

3- Fitimi i dashurisë hyjnore

4- Mbrojtja nga fatkeqësitë

5- Zemërbutësi

6- Siguri në rrugën e drejtë

7- Shpëtim prej dënimit dhe fitim të lumturisë së përhershme.

Namazi siguron lirinë e ndërjegjes e nevojshme për një stil jete ideale. Namazi i siguron njeriut shpëtimin prej robërimit të egos dhe menaxhimin sa më efektiv dhe produktiv të kohës. Besimtari i vetëdijshëm për përkohësinë e kësaj botë vazhdimisht përpiqet të ndryshojë për mirë.

KAOS

TERMINOLOGJIK:

Islami politik dhe islamizmi

“Shumica dërrmuese e këtyre termave dhe kategorive, arabe dhe të huaja, kanë një pikë të dobët fundamentale që e kufizon aftësinë e tyre për ta shpjeguar qartë fenomenin islam, me të gjithë përbërësit dhe larinë e tij; kjo pikë e dobët është se pjesa më e madhe e tyre burojnë nga baza e huaj epistemologjike.”

— Abdelrahman Rashdan —

Ndonëse tingëllon shumë intelektuale dhe teorike për një shumicë njerëzish, mënyra e përkufizimit të gjërave ndikon drejtpërdrejt në veprimet e ndërmarra në lidhje me to. Lexuesit e lajmeve, për shembull, mund të mos e vënë re dallimin midis “mizorive,” “dhunës,” “krimeve” dhe “masakrës” kur lexojnë mbi Sirinë, por veprimi/mosveprimi i tyre do të përcaktohet nga mbresa që marrin nga lajmi. Po të ishte një luftë civile, atëherë, “pse të mos i lëmë ata ta vendosin vetë,” mund të mendojë një lexues; por sikur të përkufizohej si një masakër kundër civilëve, atëherë i njëjti lexues mund të mendojë për ndihmë.

E njëjta gjë vlen, ama në një mënyrë më të thellë, për t'i kuptuar lëvizjet islame, ideologjitë dhe aksionet e tyre, veçanërisht në botën arabe. Pse ato janë aq këmbëngulëse në përzierjen e fesë me politikën? Pse nuk mësuam nga përvoja e dhimbshme europiane? A janë të tëra të verbuara nga shkëlqimi

i pushtetit? Sigurisht, pyetje shumë legjitime dhe logjike; por për t'i trajtuar ato duhet bërë një hap prapa.

KRIZA E IDENTITETIT

Qytetërimet që ishin në majë në një kohë të caktuar në histori janë ato që përcaktuan ligjërimin intelektual për shumicën e botës. Është marrë e mirëqenë, ndonëse mund të ndryshojë së shpejti, që qytetërimi perëndimor e di mirë. Në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, shumë arabë dhe muslimanë, veçanërisht intelektualë, janë shtridhur nga akademia dhe kultura perëndimore; disa e filtrojnë atë që marrin, e shumica nuk e filtrojnë. Ibni Halduni e shpjegon këtë te *Mukkadime*-ja e tij: “I munduri kërkon ta imitojë gjithmonë fitimtarin në shenjë (shenjat) e tij dalluese [...]; ai pretendon gabimisht se nënshtrimi ndaj tij nuk është për shkak të natyrës së humbjes, por të përsosurisë së fitimtarit.”

Për shembull, shumë universitete në Egjipt nxjerrin shkencëtarë politikë që janë duke marrë e duke dhënë me teoritë e Lokut, Rusoit, e të ngjashmëve, për sa kohë që mund të kenë fare pak kurajë intelektuale për të menduar mbi Ibni Haldunin si një i barabartë, për të mos përmendur të qenit tepër përpara. Kriza e tillë e identitetit është ajo që i bën mendimtarët arabë dhe muslimanë të mendojnë mbi veten përmes syve të tjetrit. Intelekti i tyre është i shtypur nën servilizmin civilizacional dhe identitetet e deformuara, që krijuan një hendek të madh midis vetes dhe realiteteve rreth tyre në botën arabe.

Një dijetar symprehtë musliman i cili është në pajtim me identitetin e tij, që vjen nga trashëgimia fetare dhe civilizacionale, do të kalonte një kohë të vështirë në shpërfilljen e kaosit terminologjik dhe intelektual, të pranishëm në pjesën më të madhe të literaturës, në përpjekje për të shpjeguar sjelljen e lëvizjeve islame në ditët e sotme. Termat si “Islami politik” dhe “islamizmi” duhet ta bëjnë lexuesin të ndalojë për një çast dhe të vrasë mendjen për saktësinë e tyre: A ka një version politik të Islamit që është ndryshe nga vetë Islami? A po bëjnë ata “islamistë” diçka që do të kërkonte medoemos një term tjetër të veçantë për ta veç termit muslimanë?

A ËSHTË ISLAMI NJË FE?

Një dijetar perëndimor, i kufizuar me identitetin dhe qytetërimin e tij, do të përgjigjej, po. Në fakt, shumica e studiuesve dhe autorëve perëndimorë argumentojnë se atyre muslimanëve që e përziejnë fenë me politikën duhet t’u jepet një emër i veçantë, islamistë, dhe se ajo çka ata praktikojnë duhet etiketuar si Islam politik.

Në anën tjetër, historia islame ka parë shumë ulje e ngritje në lidhje me aktivizmin dhe angazhimin politik, por termi *islamijun* (fjala arabisht për *islamistë*) nuk u gjet kurrë në literaturën e saj deri së fundi. Kurani përdor termit *muslimun* (muslimanë) dhe *mu’minun* (besimtarë), por kurrë *islamijun* (islamistë); “e njëjta traditë është respektuar dhe ndjekur në kohët moderne mes autorëve muslimanë të shekullit të tetëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë dhe njëzetë.”

Problemi kryesor të cilin shumica e studiuesve perëndimorë nuk mund ta tejkalojnë gjendet në kuptimin e tyre të fjalës *fe*, si dhe në pretendimin e rremë se ai është përkufizim transkulturore. “Nuk mund të ketë një përkufizim universal të fesë, jo vetëm sepse marrëdhëniet dhe elementët e saj përbërës janë specifikë historike, por ngaqë ai përkufizim është vetë produkt historik i proceseve diskursive,” argumenton Talal Esedi.

Kuptimi i studiuesve të tillë perëndimorë mbi fenë bazohet në përvojën e tyre me Krishterimin, si një fe ngurtësisht shpirtërore. Muslimanët e quajnë Islam

një “*din*”, e cila është fjala arabe me kuptimin, një mënyrë jetese. Ky fakt mbi Islamit provohet anembanë Kuranit; dy ajete në suren *el-En’am*, 162 dhe 163, thonë:

“*Thuaj: ‘Në të vërtetë, namazi im, sakrifica ime, jeta dhe vdekja ime, janë (të gjitha) për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shoqërues. Për këtë u urdhërova, dhe unë jam i pari i atyre që i nënshtrohem vullnetit të Tij.’*”

Ajete të tjera i etiketojnë si jobesimtarë, keqberës dhe të ligj ata që nuk qeverisin me atë që Allahu i reveloi Profetit të Tij, Muhammedit, pagja dhe bekimet qofshin mbi të. Sunneti dhe veprimet e kalifëve të drejtë janë prova se praktikimi i politikës në përputhje me Kuranin dhe Sunnetin nuk është çështje zgjedhjeje, sipas dijetarëve të shariatit. Në fakt, kushdo që është në pozitën për të praktikuar politikën dhe nuk e bën këtë në përputhje me ligjin islam, Kurani e etiketon atë si jobesimtar, keqberës, të lig.

TË KUPTUARIT E BOTËS ARABE

Sido që muslimanët praktikues mund të kenë dalime mbi atë se cila është rruga “e saktë” për ta praktikuar politikën në një mënyrë islame, ata janë domosdoshmërisht në një mendje se Islami është një mënyrë e gjithmbarshme jetese, një *din*, që e lë pas sferën private dhe futet në politikë, ekonomi, kulturë, e në të tëra fushat e sferës publike. Si rrjedhim, “Islami politik” dhe “islamizmi” janë terma që tregojnë paditurinë mbi natyrën e Islamit dhe mënyrën si besimtarët e tij e kuptojnë atë.

“Shumica dërrmuese e këtyre termave dhe kategorive, arabe dhe të huaja, kanë një pikë të dobët fundamentale që e kufizon aftësinë e tyre për ta shpjeguar qartë fenomenin islam, me të gjithë përbërësit dhe larinë e tij; kjo pikë e dobët është se pjesa më e madhe e tyre burojnë nga baza e huaj epistemologjike,” thotë në librin e tij, *Udhërrëfyes për Lëvizjet Islame në Botë*, Zija Rashvani, drejtuesi i Qendrës për Studime Politike dhe Strategjike el-Ahram.

Jo të gjithë shkencëtarët politikë mund ta trajtojnë atë çka po e rrëmben tani botën arabe si një lojtar gjithnjë e më shumë me ndikim, lëvizjet islame. Një studiues perëndimor duhet ta lërë ndenjësën e tij lehtësuese kulturore dhe të vështrojë objektivisht në rrënjët e mendimit që po analizon për të qenë në gjendje të kuptojë dhe analizojë aksionet e grupeve të bashkëshoqëruara; vetëm atëherë bota mund të vijë te kuptimi se identiteti është në fakt në skenë, e u jep trajtë veprimeve në përputhje me të.

Përzgjedhë dhe përktheu:

Bujar M. Hoxha



DY PIKA TË PËRBASHKËTA TË SHKATËRRUESVE TË FESË NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN E SHOQËRISË

— Mustafa Asim Kyçykashçë —

Një problem i madh që po e përjetojmë këto kohët e fundit: Komentet fetare që ngelin jashtë ehli sunnet ve’l-xhemaatit. Kush i bën këto komente? Prej këtyre që i bëjnë, dikush është profesor teologjie, ndërsa disa të tjerë janë njerëz mediatikë, si ligjërues apo shkrimtarë që pohojnë se janë edukuar në mënyrë autodidakte... Ata i nxjerrin në pah komentet e tyre në kundërshtim me Kuranin Fisnik dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), me anë të programeve televizive, shkrimeve nëpër qoshet e gazetave, librave dhe rrjeteve sociale. Shoqëria jonë ka një mangësi të madhe në dituritë fetare, sepse në vendin tonë edukimi fetar në kuptimin që e meriton është nënvlerësuar për shumë vite. Për shkak të injorancës fetare të popullit, kushdo flet si të ketë dëshirë dhe i mashtron të tjerët. Kjo është edhe arsyeja pse dalin disa që lozin me kushtet e besimit dhe me bazat e jurisprudencës islame...

Kur pyeten se: “Çfarë është ky guxim?” - shtrojnë në përpara një sërë justifikimesh dhe pretekstesh. Pika e përbashkët e të gjithëve është gjoja “dobia e shoqërisë”. Domethënë, ata shprehen se i kanë nxjerrë këto komente në dobi të shoqërisë dhe në emër të shërimit të plagëve që i shohin në shoqëri.

Për shembull: Besimi në kader dihet shumë qartë se është njëri prej kushteve të besimit... Në lidhje me këtë çështje ka me dhjetëra ajete dhe hadithe fisnike... Përveç të tjerash, vetë koncepti i uluhijetit të saktë e bën të domosdoshëm besimin në kader. Krahas këtyre, prapë se prapë merren me fjalë boshe duke u shprehur: “Kaderi nuk është prej kushteve të besimit. Kader do të thotë vetëm masë.” Përse i thonë këto? Përgjigjen e gjejmë te shpjegimet e tyre:

“Shoqëria ia lë çdo gjë në dorë kaderit dhe si rezultat nuk e rregullon veten.”

Mirë, por ky nuk është problem i besimit në kader. Përkundrazi, ky është problem i atyre që nuk e kuptojnë saktë besimin në kader. Ky është problem i dembelizmit dhe plogëshitisë. Myslimanët kanë pasur periudha të arta në fushën e shkencës, ekonomisë, shoqërisë dhe politikës. Ky umet i besonte kaderit edhe në ato periudha të arta. Nëse sot punët janë kthyer ters, fajin e kësaj nuk e ka kaderi. Le të japim edhe një shembull tjetër:

Dihet shumë qartë se namazi i teravive është sunnet, por profesorët e ekraneve thonë: “Jo, është bidat.” Justifikimi përsëri është social. Ata thonë:

“Populli nuk fal akoma pesë kohët e namazit që janë farz, por kur fal namazin e teravive pandeh se i falen të gjitha mëkatet. Këtë koncept duhet ta shkatërrojmë.” Çfarë dobie do të kishte nxjerrja e namazit të teravive prej sunetit një njeriu që i lë pesë kohët e namazit prej përtacisë? A janë të pakët ata njerëz që kanë filluar të falin pesë kohët e namazit pasi kanë falur teravitë? Le të japim edhe një shembull tjetër:

Dihet shumë qartë se gratë nuk mund të falin namaz, nuk mund të mbajnë agjërim dhe nuk mund të lexojnë Kuran përgjatë kohës së menstruacioneve dhe lehonisë. Kjo është e vërtetuar me ixhma/konsensus të dijetarëve. Krahas kësaj, ka prej atyre që mundohen ta anulojnë këtë. Shkaku? Shkaku është i fshehur në justifikimet e tyre:

“Të mos diskriminohen gratë. Të mos trajtohen gratë sikur të ishin klasë e dytë!”

Mirë, por ky është diskriminim pozitiv! Allahu Teala u jep atyre pushim të detyrueshëm në ato gjendje që i përshkruan si sëmundje. Dhe më e rëndësishmja, kjo është fe. Ne duhet të bëjmë çfarëdo që të thotë Allahu i Lartësuar. Rregulli është ai që ka treguar i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili u dërgua për predikimin dhe përhapjen e fesë islame. Përndryshe, a mund të ndryshojnë bazat dhe praktikat fetare ngaqë nuk përputhen me disa vlera që i ka arritur perëndimi? Le të japim edhe një shembull tjetër:

Institucioni i ndërmjetësimit të Pejgamberit tonë të nderuar është i vërtetuar me ajetet dhe hadithet fisnike. Krahas kësaj, ka armiqtë ndaj ndërmjetësimit të Dërguarit të Allahut (a.s.). Shkaku? Përsëri është shoqëror:

“Populli i beson ndërmjetësimit. Për këtë arsye, nuk bën ibadet. Ai mendon: Sidoqoftë do të na shpëtojnë pejgamberët dhe evliatë. Atëherë duhet ta shkatërrojmë këtë mendim.”

A janë gjëra të ndryshme nga njëra tjetra fitimi i ndërmjetësimit dhe fitimi i kënaqësisë së Allahut Teala? Siç e kemi thënë edhe në çështjen e kaderit, a janë plogështuar sahabët e nderuar që e kanë dëgjuar nga vetë goja e bekuar e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, se ndërmjetësimi është i vërtetë? Përkundrazi, mund të themi se edhe ata që u përgëzuan me Xhenet që në këtë botë prej sahabëve, nuk u plogështuan nga ky sihariq. Nga ana tjetër, nëse shpresa për ndërmjetësim është e dobishme të paktën për të mbrojtur ndjenjën e respektit dhe dashurisë, a është e drejtë që të përpiqemi për ta shkatërruar? Shikoni, në ditët e sotme, në disa faqe të rrjeteve sociale, kanë dalë disa njerëz që flasin keq, ofendojnë dhe tallen haptazi me vlerat

fetare. Nënata dhe baballarët e këtyre, edhe pse nuk e zbatojnë fenë për shkaqe si mungesa e vullnetit, mosbindje e vetes etj, ndjenin një frikë të përzier me respekt dhe dashuri.

Ndërmjetësimi i të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, është përpjekja e tij për ta shpëtuar edhe atë që ka besim sa një grimcë në zemrën e tij. Por i zoti i kësaj përpjekjeje në të njëjtën kohë ka thënë: “O Fatime! Mos i beso babait tënd!” Duke e bërë këtë paralajmërim, shprehet se respekti dhe dashuria nuk janë të mjaftueshme, por se duhet edhe ibadet dhe përpjekje. Tashmë nuk ka nevojë që të japim edhe shembuj të tjerë. Shoqëria jonë ka problemet e saj. Ajo ka probleme në çështjen e moralit, jetës fetare, jetës tregtare dhe në jetën familjare, por fajin për këtë nuk e ka feja, nuk e ka besimi në kader, nuk e ka ndërmjetësimi i të Dërguarit të Allahut (a.s.), nuk e kanë dispozitat e jurisprudencës islame. Zoti na faltë...

Ata që nxjerrin shkaqe jo të vërteta për problemet në të cilat gjendet shoqëria, në të vërtetë, po i neglizhojnë paralajmërimet hyjnore në lidhje me këtë çështje. Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.), i kanë numëruar një nga një shkaqet që i zvarrisin shoqëritë drejt rënies:

1- Lënia e “el-emru bi'l-ma'rufi ve'n-nehju ani'l-munkerit”. Domethënë, shndërrimi në një shoqëri të pandjeshme. Feja jonë kërkon një sistem që këshillon dhe sugjeron të drejtën. Perëndimi e ka shtuar ndjeshmërinë e shoqërisë duke formuar një strukturë që ankohet për padrejtësitë. Ndërsa ne akoma nuk kemi asnjërin prej këtyre të dyjave.

2- Humbja e ndjenjave të bashkimit, unitetit dhe vëllazërisë.

3- Shndërrimi i të pasurve, të llastuarve, të shkujdesurve dhe arrogantëve në njerëz me influencë të lartë shoqërore. Shtimi i imoralitetit, bërja e mëkateve të mëdha dhe përhapja e harameve.

4- Tamahu i madh ndaj kësaj bote dhe pasurisë. Koprancia dhe lakmia. Frika e tepërt nga vdekja, harrimi i kiametit e ahiretit dhe lënia e istigfarit.

5- Ekstremizmi në fe (kapërcimi i rregullave që kanë vënë Allahu dhe i Dërguari i Tij), debati rreth kaderit, bërja e shumë pyetjeve në vend që të shfaqet bindje dhe nënshtrim kundrejt Zotit (xh.sh.).

6- Padrejtësia, shkelja e të drejtave të njeriut, përvojimi, spiunimi dhe çdo lloj sjellje tjetër e papraueshme nga morali...

“Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë thënë të vërtetën.” Diagnoza është shumë e saktë. Për këtë arsye, edhe receta duhet të jetë efikase për shërimin e kë-

tyre sëmundjeve, por këta doktorë mashtrues dhe manipulues, në vend se të diskutojnë këto shkaqe, po rendin pas diagnozave të shpifura dhe analizave të gabuara. Sigurisht se edhe mjekimi i gabuar që ata këshillojnë e bëjnë sëmundjen të pashërueshme. Këta mjekë, për një sëmundje që ka të bëjë me sjelljet, propozojnë një mjekim që e prish edhe akiden. Tashmë në mendje mund të na vijë kjo pyetje:

“Këta njerëz po interesohen me hallet e popullit. Ata duan që ta rregullojnë shoqërinë. Domethënë se e kanë emocionin për të kryer obligimin e el-emru bi'l-ma'rufi ve'n-nehju ani'l-munkerit. Atëherë, përse nuk paskan të drejtë?..

Përgjigja për këtë është shumë e thjeshtë: “Ata urdhërojnë, ama urdhërojnë të keqen dhe jo të mirën. Ata ndalojnë, por ndalojnë të mirën dhe jo të keqen. Pikërisht siç veprojnë edhe hipokritët. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njëri-tjetrin: kërkojnë që të bëhen vepra të këqija e pengojnë të mirat dhe janë dorështrënguar. Ata e kanë harruar Allahun, por edhe Ai i ka harruar ata. Me të vërtetë, hipokritët janë keqbërës.”** (Teube, 67) Përveç të tjerash, cilësia e përbashkët e atyre që dëshirojnë ta rregullojnë shoqërinë dhe e atyre që dëshirojnë ta prishin atë është ndjenja për t'i futur në sistem masat e gjera njerëzore. Për këtë arsye, njerëzit mblidhen rreth tyre. Ndërsa ata u thonë: “Zgjidhja është kjo!” Për shkak të injorancës së theksuar fetare, njerëzit nuk e kanë ndjenjën për t'i peshuar ato që thuhet. Për këtë arsye, justifikimi për “rregullimin e shoqërisë” sjellë në pah atë masë të gjerë njerëzore që nuk di tjetër gjë përveçse të duartrokasë. Ndërkohë Allahu Teala nuk ua ka dhënë njerëzve të degraduar detyrën për ta rregulluar, për t'ia shtuar emocionin dhe për ta rinovuar shoqërinë. Shikoni, në ajetin fisnik thuhet: **“Unë nuk i bëra ata dëshmitarë të krijimit të qiejve dhe të Tokës e as të krijimit të vetë atyre; dhe, sigurisht që Unë nuk mund t'i marr si ndihmës ata, që çojnë të tjerët në humbje.”** (Kehf, 51)

Njerëzit e degraduar dhe ata që i zvarrisin ndjekësit e tyre drejt humbjes, nuk mund t'i thonë ndonjë gjë të dobishme shoqërisë. Edhe Allahu Teala nuk ua ka kërkuar diçka të tillë atyre. Ata që e rregullojnë shoqërinë dhe që e pastrojnë janë të urtët.

Fuqitë dëshirojnë të ndikojnë te shoqëria. Pasuria (Karunët, bankat çifute, lobi i kamatës), fama (pseudartistët), fuqia ushtarake (luftërat, kryengritjet, grushtet e shteti), fuqia e medias (poetët, letrarët dhe shkrimtarët), fuqia akademike (shkenca), fuqia e pozitës (fisnikët, burokratët)...

Të gjitha këto janë fuqi materiale që duan ta shkatërrojnë shoqërinë. Ndikimi i këtyre është si ndikimi i shejtanit të mallkuar. Pra, nuk është i përhershëm. Ndikimi i tyre nuk funksionon te ata që strehohen në kuptimin e vërtetë të Allahu Teala. Ndërsa Allahu (xh.sh.), e dëlir shoqërinë me duart e të urtëve. Le t'i hedhin një sy historisë: Në kohën e Osman Gazit ka qenë Sheh Edebaliu, në kohën e Fatihut ka qenë Akshemseddini, në kohën e Kanunit ka qenë Jahja Efendi, në kohën e Sulltan Ahmetit ka qenë Aziz Mahmut Hydaji. Në këtë mënyrë, e gjithë shoqëria pastrohej dhe dëlirej me përpjekjet e këtyre personaliteteve të larta.

Sot, shkatërruesit e fesë që e quajnë veten rregullatorë të shoqërisë, kanë edhe këtë pikë të përbashkët: “Ata janë armiq të të gjithë udhërrëfyesve shpirtërorë të cilët janë rregullatorë të vërtetë të shoqërisë.” Që të gjithë shkatërruesit e fesë janë kundër mistikës islame, tarikatit etj. Përse? Sepse i shikojnë si rivalë. Këta njerëz, me mendjemadhësinë që ua jep dituria pa urtësi, i shohin nga lart (i përçmojnë) udhërrëfyesit shpirtëror që kanë dije të thellë. Për këtë arsye, dikush prej tyre është i dhënë pas pozitës, dikush pas parasë e pushtetit dhe dikush tjetër pas disa interesave të tjera të kësaj bote. Njerëzit e tillë nuk mund ta kapërdijnë dot faktin se shoqëria mblidhet me dashuri, e cila është dhuratë e Rrahmanit, rreth e rrotull këtyre udhërrëfyesve të cilët janë rregulluesit e vërtetë të saj. Prandaj ata përpiqen të fitojnë njerëz duke bërë reduktime në fe pikërisht si mashtruesit që pohojnë se janë profetë. Ndërkohë, disa prej këtyre janë të nxitur nga vendet e jashtme. Atyre u është dhënë detyra për të shkatërruar besimin e ehli sunetit, i cili është vlera jonë. Për këtë arsye, sulmi ndaj të urtëve shpirtërore që e mbrojnë besimin është misioni i përhershëm i tyre.

Për fat të mirë, nuk arrijnë dot t'i bëjnë ato që shpresojnë. Përgjatë gjithë historisë i janë bërë shumë sulme umetit që është udhëtar i rrugës së drejtë dhe që ne e quajmë ehli sunnet ve'l-xhemat, por ata që kanë sulmuar nuk kanë arritur ta manipulojnë dhe shkatërrojnë çdo gjë edhe pse kanë arritur të bëjnë disa dëme. Njerëzit e shkretë që kanë arritur t'i shkëpusin nga ehli sunet ve'l-xhemati janë bërë pjesë e tyre. Prej përfitimit të ditorisë nga dijetarët, të cilët janë trashëgimtar të të Dërguarit të Allahut, alejhi's-salam, umeti do të vazhdojë ta mbajë të vërtetën deri në Kiamet. Ky është një përgëzim profetik...

Nëse shoqëria ka probleme, recetat për zgjidhjen e këtyre problemeve duhet të merren nga këta dijetarë dhe jo nga devijuesit...

Bëhu shërbëtor i atij Sulltani

— Ferudun Ozdemir —

Në kohën e Sulltan Muratit të IV-t në qytetin e Erzurumit jetonte një njeri i devotshëm me emrin Habib i cili kishte vendosur të shkonte në Haxh. Në ato kohëra njerëzit tuboheshin nga katër anët e vendit në Stamboll dhe pastaj niseshin grupe-grupe për në udhën e gjatë të Haxhit.

Habibi mendoi të shkonte në një hamam para se të nisej me karvanët e gjatë të Haxhit por për fatin e tij në të njëjtin hamam do grumbulloheshin të gjithë vezirët e Sulltanit, prandaj askush nga populli nuk lejohej të hynte brenda. Habibi këmbënguli duke thënë se do mbaronte punë shumë shpejt dhe nuk do shqetësonte askënd dhe kështu u lejua të hynte. Nuk kaloi shumë kohë dhe paria e vezirëve dhe punonjësve të lartë të shtetit hynë në hamam.

Ndërkohë, sulltani i veshur me rroba të thjeshta që të mos njihet nga të tjerët, u afrua pranë derës së hamamit dhe iu drejtua punonjësit me të njëjtat fjalë: "Ju lutem më lejoni të hyj, do mbaroj punë shumë shpejt dhe nuk do shqetësoj askënd."

Kështu edhe ai u lejua të hynte me kusht që të qëndronte në dhomëzën e vogël të hamamit ku ishte edhe Habibi. Sulltani e përshëndeti Habibin dhe filloi të bisedonte me të si një njeri i thjeshtë i cili më pas i kërkoi t'i fërkonte shpinën. Sulltani nuk ngurroi dhe menjëherë iu drejtua me fjalët: "Eh mor vëlla! Shih ne e shih këto vezirë!"

Habibi i hodhi një vështrim të shpejtë dhe vazhdoi me fjalët: "Eh mor mik! Lëri ato. Bëhu shërbëtor i atij Sulltani në mënyrë që edhe sulltani i vezirve të vijë e të lajë shpinën tënde!"

Habibi e kishte njohur sulltanin...

Kur njëri bëhet shërbëtor i Sulltanit të vërtetë. të gjithë botën mund ta sundojë.

Bëhu shërbëtor i Sulltanit të sulltanëve, mos mendo më gjatë...

Bëhu robi, miku, i dashuri i Allahut, besoji Atij, mbështetu vetëm tek Ai!

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI





Një Ajet

"Ky (Kuran) është një libër i bekuar,
që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed),
për të përsiatur mbi vargjet e tij
dhe për t'u këshilluar me të mendarët!"

(Sad, 29)

Qëllimi kryesor i Kuranit është t'i sigurojë njeriut jetë të lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër duke e udhëzuar që të veprojë brenda direktivave hyjnore.

Për të realizuar këtë qëllim, pra lumturinë e njeriut në të dyja botët, njeriu duhet të përvetësojë një mënyrë jete-se në përputhje me parimet e Kuranit. Edhe pse njeriu herë pas herë mund të bjerë në gabime, qëllimi kryesor dhe filozofia e jetës së tij duhet të jetë kënaqësia e Allahut.

Njeriu duhet të jetë në kontakt me Kuranin në çdo moment për të kryer më sukses detyrimet që ka karshi Krijuesit por edhe detyrimet që ka kundrejt shoqërisë. Sepse vetëm duke qenë në kontakt me Kuranin mund të edukohet me frymën e Kuranit. Edukimi i njeriut përmes Kuranit është një proces që vazhdon gjithë jetën. Është e qartë se një zemër dhe një mendje, që ndërpret marrëdhëniet me Kuranin do të jetë e hapur ndaj çdo lloj tundimi. Është evident fakti se në shoqëritë që qëndrojnë larg boshtit të mësimave Kuranore tradita dhe zakonet fillojnë të pranohen si pjesë e fesë.

Nëse njerëzit në përpjekje për të kuptuar Kuranin, nuk kanë një qasje të shëndoshë, fillojnë të formojnë marrëdhënie të ndryshme me Kuranin. Këto

janë marrëdhënie që nuk kanë asnjë lidhje me qëllimin e zbritjes së Kuranit. Si shembull të këtyre marrëdhënieve të gabuara që kanë krijuar njerëzit me Kuranin mund të përmendim nuskat që përmbajnë ajete Kuranore, mbajtja e Kuranit në makinë për t'u mbrojtur nga fatkeqësitë. Me keqardhje vëmë re se përpjekjet e myslimanëve për të kuptuar Kuranin janë minimale, nuk ka dyshim që leximi i Kuranit pa e kuptuar shpërblehet tek Allahut por qëllimi kryesor i Kuranit është të jetohet sipas udhëzimeve të tij. Të lexohet Kurani pa u kuptuar sot, në kohën kur literatura është e bollshme nuk është një sjellje që mund të justifikohet lehtë. Kurani së pari i drejtohet arsyes, mendjes, është nga synimet e kryesore të Kuranit vënia në lëvizje e arsyes së njeriut.

Kurani në shumë vende thekson rëndësinë që ka kuptimi si duhet i mesazhit Kuranor prandaj duhet të bëjmë përpjekje për ta kuptuar dhe jetuar Kuranin mos të qëndrojmë pasiv ndaj fjalës së Allahut. Marrëdhënien me Kuranin duhet ta shpëtojmë nga formaliteti duke e ngritur në dimensionet e dijes siç ka qenë në kohën e Pejgamberit (a.s.) dhe shokëve të tij. Ajetet që nuk janë të qëndisur në mendje dhe në zemër nuk mund të na ndriçojnë jetën tonë. Duhet patjetër që mbruhemi me moralin e Kuranin.

Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.)
se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

"...Fjala e mirë është sadaka..."

Ndër organet shqisore organi më kompleks është gjuha. Ndërsa organet e tjera si syri, veshi, dora kanë një perceptim të anës së jashtme të sendeve ose të dukurive që vjen si pasojë e veprimit të drejtpërdrejtë mbi këto sende ose dukuri.

Kurse gjuha është shprehës e kumtues i mendimeve e i ndjenjave të njeriut. Ajo luan rolin e përkthyesit të mendimeve dhe besimeve tona. Pejgamberi (a.s.) duke treguar për rëndësinë e gjuhës mbi organet e tjera thotë: "Kur zgjohet njeriu, të gjitha gjymtyrët e tij i drejtohen gjuhës duke i thënë: "Ki frikën Allahut edhe për ne, sepse ne jemi të varura prej teje. Nëse ti je në rrugë të drejtë, edhe ne jemi në rrugë të drejtë, e nëse ti lajthit, edhe ne kemi lajthitur." (Tirmidhiu, Zuhd, 60)

Pejgamberi (a.s.) na informon se pozita e gjuhës në krahasim me organet e tjera është në një pozitë më të rëndësishme jo në aspektin e funksionit të saj biologjik por etik. Gjuha njeriut e lartëson ose e ul përballë Allahut dhe përballë njerëzve. Një fjalë e bukur siç bëhet shkak për të fituar kënaqësinë e Allahut bëhet shkak për të fituar edhe mirënjohjen e njerëzve. Pejgamberi (a.s.) e shpreh kështu këtë fakt:

"Njeriu për një fjalë që e pandeh të parëndësishme por që Allahu është i kënaqur bëhet shkak që lartësohet nga Allahu dhe për një fjalë të parëndësishme që thotë por që Allahu nuk është i kënaqur me të, hidhet në xhehenem."

Kurse Kurani na mëson se një fjalë e mirë është më e vlefshme se një lëmoshë që shoqërohet me fjalë fyese. Plaga e hapur nga gjuha është shumë e vështirë për t'u shëruar sepse fjala godet zemrën.

Muhamedi (a.s.) i ka shpjeguar Muadh ibn

Xhebelit disa tema shumë të rëndësishme që përfshijnë edhe rëndësinë e gjuhës në jetën e myslimanit. Muadh ibn Xhebeli tregon: Isha me të Dërguarin e Allahut, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të dhe e pyeta me trego një vepër që më shpie në xhenet dhe më largon nga xhehenemi?

Muhamedi (a.s.): "Më ke pyetur për diçka shumë të vështirë. Por që është e lehtë për atë që ia lehtëson Allahu. Të adhurosh Allahun dhe të mos i shoqërosh ortak, ta falësh namazin, të japësh zekatin, ta agjërosh Ramazanin dhe të kryesh haxhin."

Pastaj vazhdoi dhe tha: "A dëshiron të tregoj dyert e mirësisë? Agjërimi është mburojë (nga zjarri i xhehenemit). Lëmosha i shuan mëkatet siç shuan uji zjarrin. Namazi i natës është simboli i njerëzve të mirë." Pastaj i Dërguari lexoi ajetet: "Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë." (Sexhde, 16, 17)

Pastaj përsëri i tha: "A të tregoj për bazën, shtyllën dhe kulmin e çdo gjëje? Baza e çdo gjëje është Islami, ndërsa shtylla e tij është namazi, kurse kulmi tij është xhahadi (përpjekja për të lartësuar fjalën e Allahut). A të tregoj për më të rëndësishmen nëpërmjet së cilës i zotëron të gjitha ato që përmendëm më sipër?"

Ai kapi gjuhen e tij dhe tha: "Ruaje këtë." I thashë: A do të gjykohe mi për atë që flasim o Pejgamber i Allahut?!

"Çfarë mendon se i hedh njerëzit në zjarr në Ditën e Gjykimit përveç gjuhës dhe të korrurat e saj."

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Një fjalë e bukur thënë vëllait besimtar është si kur i ke dhënë lëmoshë për nga shpërblimi
2. Fjala e mirë është shkak për të hyrë në xhenet.
3. Fjala e rëndë mund të bëhet shkak për të shkuar në xhehenem.

Mjehadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- PJESA VII -

Edhe pse nga jashtë duket si një grumbull dheu i heshtur, në fakt varri ku do të hyjë biri i njeriut është një shembull i ditës së mahsher-it. Varri, i cili është stacioni i parë i Ahiretit, do të marrë formë sipas zbatimit të urdhrave të Allahut në këtë botë. Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Varri është ose një kopsht prej kopshteve të Xhenetit, ose një gropë prej gropave të Xhehemit...” (Tirmidhi, Kiamet, 26.)

JETA E BERZAHUT DHE BOTA E AHIRETIT¹

Pasi të ndahemi nga kjo botë, në sajë të vdekjes, do të kalojmë në jetën e varrit, e quajtur ndryshe “bota e Berzahut”, e cila është një ndalesë e përkohshme. Më pas do të fillojë edhe ndalesa e fundit që është jeta e Ahiretit.

Jeta e berzahut është kalimtare njësoj si kjo botë. Ndërsa jeta e Ahiretit është ajo ku lumturia ose ndëshkimi janë të përjetshëm.

Pika më e rëndësishme që nuk duhet të harrojmë kurrë në lidhje me botën e berzahut dhe atë të Ahiretit është fakti që jeta në këto dy botë është shumë më ndryshe nga jeta e kësaj bote, në shumë aspekte. Në këto dy botë koha edhe hapësira do të matet ndryshe.

Për shembull, në këtë botë koha matet në bazë të lindjes dhe perëndimit të diellit. Ditën e llogarisim me orë, muajin me ditë, e vitin me muaj. Por me të hyrë në varr, të gjitha këto njësi ma-

tëse do ta humbasin kuptimin e tyre. Matja e kohës në varr, do të jetë në përputhje me botën e berzahut.

E njëjta gjë vlen edhe për jetën e Ahiretit. Madje, për shkak se jeta e Ahiretit do të jetë e përjetshme, njësitë matëse, sasitë, koha dhe hapësira në atë jetë do të jenë komplet ndryshe nga ato të jetës së dynjasë. Ndërkohë që përpiqemi të kuptojmë më shumë në lidhje me jetën e Ahiretit, përmes të dhënave që marrim prej ajeteve dhe haditheve, ne nuk duhet të anashkalojmë edhe faktin se krahasimet janë bërë duke u bazuar në kriteret e kësaj bote.

Njeriu ka zbuluar se edhe koncepti i kohës dhe hapësirës që njohim në këtë botë, vlen vetëm për Tokën (si planet), sepse është vërejtur se në kozmos koha dhe hapësira janë relative. Ato mund të shkurtohen e ngushtohen ose të zgjaten e të zgjerohen në kushte të ndryshme. Shkencëtarët kanë vërtetuar se nëse marrim një fëmijë dhe e vendosim të jetojë 10 vite sipas matjes së Tokës në një planet tjetër me tërheqje gravitacionale më të fuqishme, kur të kthehet në Tokë pas 10 vitesh do të vërehet se ai do të jetë më i ri se një fëmijë tjetër i lindur po në të njëjtën ditë por që ka jetuar në Tokë. Po ashtu, astronauti Scott Kelly, i cili u dërgua në hapësirë nga NASA në vitin 2015, kur u kthye në Tokë, pas afro 1 viti, ishte zgjatur 5 cm dhe ishte rinuar afro 1 të 100 e sekondit.

Këto të dhëna na ndihmojmë të kuptojmë më mirë se pse nuk është e drejtë të përpiqemi ta kuptojmë jetën e pafundme të Ahiretit me kriteret matëse të kësaj bote. Gjërat që nuk i dimë, mend-

1. Relacioni që hoxha i nderuar Ebu Bekir Sifil ka bërë në librin tonë në lidhje me jetën e varrit dhe gjendjen në botën tjetër.



ja jonë përpigjet t'i kuptojë duke i krahasuar me ato që dimë. Kur dikush është duke përshkruar dikë që nuk e njohim, ai tregon duke lidhur ngjashmëri me të njohurit e përbashkët. Për shembull, trupin e ka si të filanit, fytyrën si filani, ndërsa sytë si filani, etj...

Por si mund ta përshkruajmë një qenie të cilën nuk e njohim aspak?! Nëse dikush na thotë: *"Pak më parë pashë dikë, që nuk ishte as burrë, as grua. Pra nuk kishte gjini."*, çfarë do të kuptojmë ne nga kjo?! Në fakt nuk do të kuptojmë asgjë, sepse ne nuk kemi parë asnjëherë dikë që është pa gjini. Megjithatë, ne besojmë në mënyrë absolute në ekzistencën e një qenie që quhet "melek", për shkak se jemi njoftuar nga Kurani Fisnik dhe Sunneti i Profetit (a.s.). E melekët nuk kanë gjini.

As për shpirtin ne nuk kemi dijeni, pra nuk e dimë se çfarë është "shpirti", nga se përbëhet dhe çfarë cilësish ka. Mirëpo ne besojmë në mënyrë absolute në ekzistencën e tij. Allahu i Madhëruar, në ajetin 85 të sures Isra, na lajmëron se në lidhje me shpirtin, *"nevena është dhënë veçse pak dijeni"*, duke na e bërë të qartë se **"ka shumë"** gjëra që nuk mund t'i dimë e t'i shpjegojmë.

Pra, "të besosh" është tjetër gjë, "të kuptosh" tjetër. Ne i besojmë shumë gjërave për të cilat lajmërohem në Kuran dhe Sunnet, edhe pse mund të mos i kuptojmë ashtu siç duhet. Ky është edhe kuptimi i **"besimit në të fshehtën"**.

Në këtë aspekt duhen vlerësuar edhe çështjet e jetës së berzahut si pyetjet në varr, zgjerimi i varrit për besimtarët, ngushtimi për mohuesit, etj. Po ashtu edhe çështjet e tjera në lidhje me Ahiretin si pafundësia e jetës në Xhenet, fakti që atje nuk ka plakje, sëmundje dhe gjëra që të

bëjnë të vuash, djegia e trupave të mohuesve në Xhehenem dhe ripërtëritja e tyre vazhdimisht pa u lënë të digjen komplet, etj. Të gjitha këto janë të vërteta dhe reale, megjithëse nuk mund t'i shpjegojmë siç duhet duke u nisur nga njohuritë dhe termat e kësaj bote.

JETA E VARRIT

Jeta e varrit nënkupton "jetën e berzahut", e cila fillon me vdekjen e njeriut dhe vazhdon deri në ditën e ringjalljes në Mahsher. Kjo e vërtetë shprehet kështu në Kur'anin Fisnik:

"Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: «O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!» Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai e thotë(kot)! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen." (Mu'minun, 99-100.)

Sado dhe sido që të jetojë njeriu në këtë botë të përkohshme, pasi të konsumojë frymët e tij të numëruara, ai patjetër do të bëhet udhëtari i një bote tjetër që është varri. E vetmja gjë e kësaj bote që ai mund të marrë me vete në këtë udhëtim, është pak metra beze të qefinit.

Qefini, që është edhe veshja e fundit e tregut të kësaj

jete të përkohshme, një ditë do t'i mbështjellë të gjithë dhe vdekja do t'i vërë vulën e anullimit të gjitha marrëdhënieve të kësaj bote, kënaqësive, argëtimit dhe bukurive mashtruese!.. Trupi i njeriut do të kthehet në dheun prej të cilit është krijuar.

Trupi i njeriut është si një mbështjellëse për shpirtin e tij. Në ditën e Kiametit, kur të realizohet ringjallja, këtij shpirti do t'i vishte një trup i ri. Përbërja e këtij trupi të ri do të jetë në bazë të



Pika më e rëndësishme që nuk duhet të harrojmë kurrë në lidhje me botën e berzahut dhe atë të Ahiretit është fakti që jeta në këto dy botë është shumë më ndryshe nga jeta e kësaj bote, në shumë aspekte. Në këto dy botë koha edhe hapësira do të matet ndryshe.

nivelit shpirtëror të fituar në dynja.

I nderuari Mevlana lidhur me këtë fakt është shprehur:

“Mos e ushqe shumë trupin tënd me yndyrë e gjëra të ëmbla, sepse ushqimi me tepri të bën pre të dëshirave të nefsit dhe në fund largohesh i poshtëruar.”

“Shpirtin mëkoje me ushqime shpirtërore. Jepi mendim të pjekur, botëkuptim të thellë dhe bukuri, që të marrë forcë për atje ku duhet të shkojë.”

Në frymën e fundit do të fillojnë të duken shenjta e para të lumturisë apo katastrofës që na pret në jetën e përjetshme. Po kështu edhe jeta e varrit, si ndalesa e parë e Ahiretit, do të jetë niveli i dytë më i rëndësishëm në lidhje me këtë çështje.

Hani (r.a.), skllavi i liruar i Osman ibn Affanit (r.a.), tregon:

Kur Osmani (r.a.), qëndronte pranë një varri, qante aq sa i lagej mjekra. Njëherë i thanë:

“Ti nuk qan kur përkujtohet Xheneti dhe Xhenemi! Pse qan kur kujton varrin?” Osmani (r.a.), u përgjigj:

“Sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.), të thotë:

«Varrri është ndalesa e parë e Ahiretit. Nëse njeriu arrin të shpëtojë prej tij, të tjerat janë më të lehta. Nëse nuk arrin të shpëtojë prej tij, ndalesat e tjera do të jenë më të vështira dhe më të ashpra se varri... Asnjë prej pamjeve që kam parë nuk është më e frikshme dhe më e tmerrshme se ajo e varrit!» (Tirmidhi, Zuhd, 5/2308; Ahmed, I, 63-64.)

I vdekuri në varr është si një person që po mbytet në det dhe kërkon ndihmë i tmerruar. Ai pret dua prej nënës, babait, vëllait dhe shokëve të mirë e të singertë. Nëse vjen ndonjë dua, kjo është më e vlefshme dhe më e gëzueshme për të se e gjithë bota dhe çka në të.

Për këtë arsye, kur një besimtar shkon në varreza, në fillim duhet të përshëndesë me selam banorët e varrezave, pastaj duhet të lutet për ta, duhet të lexoj Kuran sa ka mundësi dhe duhet të

meditojë mbi faktin se një ditë edhe ai do të jetë aty. Një prej miqve të Allahut, i nderuari Hatem-i Esam ka thënë:

“Një njeri që shkon në varreza dhe nuk lutet për banorët e varreve duke medituar edhe për fundin e vet, ka tradhtuar edhe veten edhe ata.” (Ihja, IV, 868.)

Ndërsa dijetari i madh Islam, Sufjan ibn Ujejne ka thënë:

“Nevoja që të vdekurit kanë për duanë është më e madhe se nevoja që kanë të gjallët për ushqimin dhe pijen.” (Sujuti, Sherhu’s-Sudur, Lubnan, 1417, fq. 297.)

Padyshim se Allahu i Madhëruar i shpërblen banorët e varrit në sajë të begatisë së duasë së të gjallëve. Dhurata më e mirë që të gjallët mund t’i dërgojnë të vdekurve është lutja për faljen e tyre dhe dhënia e sadakasë në emër të tyre.

Sipas besimit të ehl-i sunetit, një person që vdes mund të dëgjojë, të ndjejë e të jetë i vetëdijshëm. Ai përfiton dhe gëzohet prej mirësive që bëhen. E po ashtu vuan e hidhërohet nga të këqijat që bëhen. Pra, njeriu vdes me trup por jo me shpirt.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“Qënia ime gjallë është në të mirën tuaj: Ju bisedoni me mua dhe unë bisedoj me ju! Edhe vdekja ime është mirësi për ju: Veprat tuaja më prezantohen mua. Kur shoh punët tuaja të mira, falënderoj Allahun për to. Por kur shoh punët tuaja të këqija, i kërkoj Allahu që t’ju falë.” (Hejthemi, IX, 24.)

Po ashtu, në Hutben e Lamtumirës, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kujdes, mos ma nxini fytyrën (me gjynahe)!” (shih. Hejthemi, III, 271; Hamidullah, el-Uesaik, fq. 367.)

Pra, të gjitha veprat që kryejmë ne si ummet i Profetit (a.s.), i paraqiten atij. Po ashtu, atij i arrin edhe çdo selam që i dërgojmë. (Ebu Daud, Menasik, 96)



Ndërsa në një tjetër hadith fisnik lajmërohem se veprat tona i paraqiten edhe të afërmve tanë që janë robër të udhëzuar (besimtarë):

“Veprat tuaja u tregohen të vdekurve prej të afërmeve dhe fafesisit tuaj. Nëse veprat tuaja janë të mira, ata gëzohen. Por nëse nuk janë të mira, ata luten duke thënë: «O Allah! Mos ua merr shpirtin pa i udhëzuar edhe ata, ashtu siç na udhëzove neve!»” (Ahmed, III, 164; Taberani, Kebir, IV, 129/3887.)

Shkurtimisht, varri është pika e fillimit të hidhërimeve dhe vuajtjeve të mëdha për ata që e çojnë dëm jetën e tyre të përkohshme, duke vrapuar pas dëshirave të egos. Ndërsa për ata që e kalojnë jetën e tyre në atmosferën shpirtërore të Kuranit dhe Sunnetit, varri është shkalla e parë e lumturisë së pafundme.

“Kur vdes një rob besimtar, ai qetësohet prej lodhjes e vështirësive të kësaj bote dhe arrin mëshirën e Allahut. Ndërsa kur vdes një gjynahqar, njerëzit e tjerë, qytetet, pemët dhe kafshët shpëtojnë prej tij dhe gjejnë qetësi.”

Një ditë, pranë Profetit tonë (a.s.) kaloi një xhenaze, e ai tha:

“Ka arritur qetësinë ose kanë shpëtuar prej tij!”

Sahabët pyetën të habitur:

“-O i Dërguar i Allahut! Çfarë deshët të thoshit me shprehjen: «Ka arritur qetësinë ose kanë shpëtuar prej tij?»”

Resulallahu, (a.s.), u përgjigj:

“Kur vdes një rob besimtar, ai qetësohet prej lodhjes e vështirësive të kësaj bote dhe arrin mëshirën e Allahut. Ndërsa kur vdes një gjynahqar, njerëzit e tjerë, qytetet, pemët dhe kafshët shpëtojnë prej tij dhe gjejnë qetësi.” (Buhari, Rikak, 42.)

PYETJET E VARRIT

Çdo njeri që i nënshtrohet provimit të devotshmërisë, në shkollën e kësaj bote, patjetër që do të merret në pyetje pasi të ketë plotësuar frymët e tij të numëruara e të hyjë në varr. Madje, edhe ata që janë djegur në zjarr, janë mbytur në ujë ose kanë përfunduar si ushqim për kafshët e shpendët dhe nuk kanë hyrë në varr, do ta arrijnë botën e berzahut e do të merren në pyetje.


I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Kur besimtari vendoset në varr, atij i vijnë melekët dhe ai dëshmon: «Përveç Allahut nuk ka zot tjetër dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut!». Pikërisht për këtë gjendje bën fjalë edhe Allahut i Madhëruar në Fjalën e Tij: **«Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse keqbërësit i shpie në humbje; Allahu bën ç'të dojë.»** (Ibrahim, 27.)” (Buhari, Xhenaiz, 87, Tefsir, 14/2.)

Osmani (r.a.), transmeton se pas varrimit të një personi, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është ulur në krye të varrit dhe ka thënë:

“Kërkoni prej Allahut faljen e vëllai tuaj dhe dëshironi suksesin e tij, sepse ai tani po merret në pyetje.” (Ebu Daud, Xhenaiz, 69.)

Njeriu ndjen gjithmonë tension dhe shqetësim



të madh nga çështjet e panjohura për të. Një nga çështjet, që reflekton shqetësime të tilla në zemra, është padyshim edhe ajo e jetës së varrit, sepse njeriu nuk ka asnjë njohuri në lidhje me aventurën e nëntokës. Në fakt, edhe pse Profeti ynë (a.s.), na ka lajmëruar shkurtimisht se, “*Varrri është ose një kopsht prej kopshteve të Xhenetit, ose një gropë prej gropave të Xhehenemit...*” (Tirmidhi, Kijamet, 26), ai na ka dhënë edhe detaje të tjera në lidhje me këtë çështje. Për shembull, Esma bint-i Ebi Bekr (r.anha), thotë:

“Njëherë, i Dërguari i Allahut filloi të mbante hutbe dhe tregoi në lidhje me pyetjet që do t’i bëheshin njeriut (në varr). Ndërkohë që Profeti (a.s.), po e tregonte gjendjen e varrit me detaje, myslimanët filluan të qanin përnjëherësh me zë të lartë.” (Buhari, Xhenaiz, 87.)

Këto fjalë të Profetit (a.s.), janë gjithashtu prej atyre haditheve fisnike që na japin të dhëna të detajuara në lidhje me gjendjen e njeriut në varr:

Enesi (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“*Kur rob vendoset në varr e të afërmit i kthejnë në shpinën dhe ikin (në këtë moment i vdekuri i ndjen hapat e njerëzve që po ikin), atij i vijnë pranë dy melekë. Ata e ulin dhe e pyesin:*

«Çfarë thoshe në lidhje me personin që quhet Muhammed?» Besimtari, kësaj pyetje i përgjigjet duke thënë:

«Dëshmoj se ai është rob dhe i Dërguari i Allahut!» Më pas i thuhet:

«Shiko vendin tënd në Xhehenem! Allahu e ndërroi atë me një vend në Xhenet për ty.» (Njeriu i sheh që të dyja vendet)

[Katade thotë: “*Sipas një transmetimi, atij i zgjerohet varri shtatëdhjetë parakrah dhe i mbushet me mirësi. E ai do të jetë në mirësi të tilla derisa të ringjallet.*”] (Muslim, Xhennet, 70)

Nëse i vdekuri është mohues apo hipokrit (pyetjes së melekëve) u përgjigjet:

«Nuk e di. Unë thosha atë që thoshin njerëzit!» Atij i thuhet:

«Nuk e mësove, nuk e kuptove dhe as nuk shko-ve pas një të dituri!»

Më pas, ai goditet me një çekiç prej hekuri midis veshëve dhe si shkak i dhimbjes nga kjo goditje, ai bërtet aq fort saqë zërin e tij e dëgjon çdo gjë përreth tij, përveç dy botëve (ajo e njerëzve dhe

e Xhinëve).” (Buhari, Xhenaiz, 68, 67; Muslim, Xhennet, 70; Ebu Daud, Xhenaiz, 78/3231; Nesai, Xhenaiz, 110; Tirmidhi, Xhenaiz, 70/1017.)

Në një transmetim tjetër thuhet se dy melekët që vijnë kanë ngjyrë të zezë, sy blu qiell dhe emrat e tyre janë Munker dhe Nekir.

Po ashtu, në një tjetër hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), thotë:

“*I vdekuri vendoset në varr. Nëse është njeri i mirë do të qëndrojë në varr pa u shqetësuar dhe pa frikë. Pastaj pyetet:*

«Çfarë feje kishe?»

«Unë isha në fenë Islame!» -përgjigjet ai. Më pas pyetet (në lidhje me besimin në Profetin a.s.):

«Kush është ky njeri?» E ai thotë:

«Është Muhammedi (a.s.), i Dërguari i Allahut. Ai na solli argumente të qarta prej Allahut dhe ne e pranuan atë.» Më pas pyetet:

«A e ke parë Allahun e Madhëruar?»

«Askush nuk mund ta shohë Allahun e Madhëruar në dynja!» -përgjigjet ai.

Më pas i hapet një dritare nga ana e Xhehenemit. I vdekuri vështron në të dhe sheh flakët e Xhehenemit që godasin njëra-tjetrën (prej fuqisë dhe nxehtësisë së madhe). Në atë moment i thuhet:

«Shikoje zjarrin prej të cilit të ka ruajtur Allahu i Madhëruar!»

Më pas i hapet një dritare nga ana e Xhenetit, ku ai sheh bukuritë dhe mirësitë e tij. Pastaj i thuhet:

«Ja, ky vend i bukur është i yti!»

«Ti kishe besim të fortë (në dynja), me këtë besim të fortë ke vdekur dhe inshaAllah po me këtë besim do të ringjallesh.»²

Ndërsa njeriu i keq do të vendoset në varr mes tmerrit e frikës dhe do të pyetet:

«Çfarë feje kishe?»

«Nuk e di!» -përgjigjet ai. Më pas pyetet (në lidhje me besimin në Profetin a.s.):

«Kush është ky njeri?» E ai thotë:

«Njerëzit thoshin disa gjëra në lidhje me të. Po

2. -Edhe pse në hadith thuhet se besimtari do të pyetet dhe më në fund do t’i tregohet vendi i tij në xhenet, në të vërtetë, njeriu do të merret në pyetje pas Kiametit. Atëherë, njeriu do të shohë shpërblimin e çdo të mire apo të keqeje, qoftë edhe sa grimca. Në Kuranin fisnik thuhet qartë se edhe profetët, të cilët nuk ka dyshim se janë në xhenet, do të merren në pyetje. (shih. A’raf, 6.)

ato thosha edhe unë.» (Pra, ai shprehet se nuk ka qenë shumë i interesuar në lidhje me fenë dhe ka ndjekur verbërisht njerëzit e tjerë.)

Pastaj, atij i hapet një dritare nga ana e Xhenetit, ku ai sheh bukuritë e tij. Në atë moment i thuhet:

«Shikoje Xhenetin që Allahut i Madhëruar e largoi prej teje (për shkak se nuk ke besuar)!»

Më vonë i hapet një dritare nga ana e Xhehenemit, ku ai vështron dhe sheh flakët që godasin njëra-tjetrën. Aty i thuhet:

«Ja ky është vendi yt! Ke jetuar me dyshim (në lidhje me Islamin), ke vdekur me dyshim dhe inshaAllah do të ringjalleh me dyshim (në ditën e Kiametit)!»» (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 32. Shih. Buhari, Xhenaiz, 68, 87; Muslim, Xhennet, 70.)

Në një hadith tjetër thuhet se nëse personi i vdekur është prej banorëve të Xhenetit, atij do t'i tregohet një vend prej Xhenetit, e nëse është prej banorëve të Xhehenemit, do t'i tregohet një vend prej Xhehenemit. Më pas, atij do t'i thuhet:

“Ky është vendi yt (i ardhshëm e i përjetshëm). Këtu do të dërgojë Allahu ditën e Kiametit.” (Buhari, Xhenaiz, 90.)

“...Vendi ku përket do t'i tregohet në këtë mënyrë deri në ditën që do të ringjallet.” (Buhari, Rikak, 42.)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut, (a.s.), na lajmëron se njerëzit do t'i nënshtrohen një lloj prove besimi në varr dhe do t'u bëhen disa pyetje. Lidhur me këtë ai thotë:

“Mua më është shpallur se në varr ju do t'i nënshtroheni një sprove si fitnja e dexhallit (ose), përafërsisht si ajo.” (Buhari, Udu, 37.)

Me anë të këtij hadithit, Profeti ynë (a.s.) na paralajmëron me forcë në lidhje me ashpërsinë dhe tmerrin e pyetjeve.

Uathile Ibnu'l-Eska (r.a.), transmeton:

Njëherë i Dërguari i Allahut fali namazin e xhenazes së njërit prej myslimanëve. Më pas, dëgjova që i Dërguari i Allahut, (a.s.), bëri këtë dua:

“O Allah! Filanin, birin i filanit, e ke amanet dhe nën mbrojtjen Tënde! Ruaje atë nga fitnja e varrit dhe dënimi i Xhehenemit. Ti e mban premtimin dhe meriton falënderimin!

O Allah! Fale dhe mëshiroje atë! Padyshim Ti je falës dhe mëshirues...” (Ebu Daud, Xhenaiz, 56; Ibn-i Maxhe, Xhenaiz, 23.)

Sa lumturi e madhe është arritja e mëshirës së Allahut të Madhëruar. Njëherë, njërin prej miqve të Allahut, Maruf-i Kerhin, e kanë pyetur:

“O Maruf! Çfarë të shtyn të bësh kaq shumë adhurime?” Maruf-i Kerhi heshti, por pyetësi nguli këmbë dhe tha:

“Përkuajtimi i vdekjes?”

Maruf-i Kerhi tha:

“E çfarë është vdekja?”

“Apo mos vallë meditimi mbi varrin dhe botën e berzahut?” –pyeti ai përsëri.

“E çfarë është varri?” –tha përsëri Maruf-i Kerhi. Por pyetësi vazhdoi të këmbëngulte dhe tha:

“Apo frika nga Xhehenemi dhe shpresa për Xhenet?” Pas kësaj pyetje, Maruf-i Kerhi i dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

“E ç'janë këto?! Ai që ka në dorë fenomenet që ti përmende, është një Zot aq madhështor sa nëse arrijmë të ndiejmë dashuri dhe dëshirë të thellë karshi Tij, Ai na mundëson t'i harrojmë të gjitha këto. Nëse midis nesh dhe Allahut lindin njohja dhe dashuria në të tilla përmasa, në sajë të tyre, Ai na shpëton prej të gjitha dukurive që ti numërove!”³

3. - Babanzade Ahmed Naim, Islam Ahlakının Esasları, Istanbul 1963, fq. 66.

*“Njëherë,
i Dërguari i Allahut
filloi të mbante hutbe
dhe tregoi në lidhje me pyetjet
që do t'i bëheshin njeriut (në varr).
Ndërkohë që Profeti (a.s.), po e
tregonte gjendjen e varrit
me detaje, myslimanët filluan
të qanin përnjëherësh
me zë të lartë.”*





EL-ADHIM

MADHËSHTORI

— Ilir Hoxha —

Zoti ynë ka krijuar çdo gjë që ne e konsiderojmë madhështore. Por, ky emër hyjnor shpreh madhështinë e Allahut, përtej çdo perceptimi të mendjes njerëzore. Po ashtu, ky emër shpreh Atë genie madhështore, urdhrat e të Cilit nuk mund t'i kundërshtosh, që nuk mund ta përulësh dhe që zotëron cilësi të paperceptueshme nga mendja.

Të besosh në madhështinë e pakufishme të Zoti tonë, do të thotë ta madhërosh Atë, ta respektosh Atë ashtu siç duhet dhe të mos ia atribuosh asnjë qenieje tjetër madhështinë e Tij. Dhe, rezultati i paevitueshëm i këtij besimi, është t'i bindesh Atij pa asnjë mëdyshje, të falënderosh për gjithçka që vjen prej Tij dhe të mos tregohesh mosmirënjohës: “... **Kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.**” (Haxhaxh, ۳۲.)

Madhështia absolute i takon vetëm Allahut. Këtë madhështi nuk e posedon asgjë tjetër, qoftë në tokë apo në qiej dhe çdo gjë dëshmon për madhështinë e Tij. Surja Uakia, ku pasi tregohet fuqia dhe madhështia e Allahut në funksionimin e gjithësisë, mbyllet me shprehjen, “**Prandaj lavdëroje emrin e Zotit tënd Madhështor!**”. Nga kjo, kuptohet se për të falënderuar për të gjitha mirësitë, duhet ta përmendim Zotin tonë me emrin e Tij el-Adhim / Madhështori. Si përfundim i këtij urdhri, edhe Profeti ynë (a.s.), ka këshilluar të themi, “*sub’hane rabbjel adhim*”, kur jemi në ruku gjatë faljes së namazit, duke e bërë falënderimin pjesë të adhurimeve tona të përditshme.

Që të arrijmë të kuptojmë me aq sa mundemi manifestimin e madhësisë së Zotit tonë që

reflektohet në gjithësi, ne duhet të analizojmë veprat e Tij në gjithësi. Kurani Fisnik, në shumë ajete të tij, na fton ne njerëzit për ta bërë këtë dhe, këtu hyjnë në lojë shkencat fizike dhe natyrore, të cilat studiojnë gjithësinë. Edhe pse dija dhe meditimi mund të na ndihmojë deri diku në kuptimin e kësaj madhështie, kur ne të arrijmë në kufijtë e mendjes, ajo madhështi qëndron ende para nesh me gjithë lavdinë e saj. Këtu mbaron kuptimi e shpjegimi dhe fillon mahnitja e heshtja. Ai është më i madh se çdo i madh. Asnjë mendje nuk mund ta perceptojë dot madhështinë e Tij në kuptimin absolut dhe asnjë sy nuk mund ta përfshijë përsosmërinë e Tij.

Emri Adhim në Kuran

Emri el-Adhim, në Kuranin Fisnik është përdorur shtatë herë si cilësi e Allahut (shih. Bekare, ۲۵۵; Shura, ۴; Uakia, ۷۴, ۹۱; Hakka, ۳۳, ۵۲.) Në pesë vende ku Allahu është përmendur me cilësinë Adhim, është shoqëruar bashkë me termat “*tesbih*” ose “*ulu*”, të cila shprehin pastërtinë e Allahut prej çdo të mete. Kjo tregon qartë se Allahu i Madhëruar, qoftë në esencë, qoftë në cilësi, është përtej çdo botëkuptimi njerëzor dhe se madhështia i takon vetëm Atij në kuptimin absolut. Në dy vende, ku ky emër përdoret së bashku me emrin Alij, që do të thotë “*i Lartë*”, na tërheq vëmendjen në dallimin delikat midis superioritetit dhe madhësisë. Jo çdo lloj superioritetit zotëron madhështi. Por Allahu zotëron një superioritet madhështor që të zgjon ndjenjën e respektit dhe madhërimit. Shumë domethënës është edhe fakti që Ajetu'l-Kursij, i cili konsiderohet si ajeti ku përmbledhen të gjitha parimet themelore të



besimit monoteist, mbaron me këto dy emra. Dihet se emrat që vijnë në fund të ajetit, kanë lidhje me përmbajtjen e atij ajeti. Për rrjedhojë, fakti që ky ajet madhështor i cili mbaron me emrat Alij dhe Adhim, tregon se superioriteti dhe madhështia janë cilësi parësore të Allahut. Ndërsa në ajetin ۱۲۹ të sures Teube, Zoti ynë i Madhëruar e urdhëron Profetin (a.s.), (dhe në emër të tij, të gjithë myslimanët) që të strehohet tek Ai prej së keqes së dyftytrëshve dhe, në fund të ajetit e arsyeton me këtë shprehje urdhrin e Tij: “.. (sepse) **Ai është Zot i Fronit Madhështor**”. Po ashtu, edhe kur flet për Fjalën e Tij (Kuranin), Allahu i Madhëruar i jep cilësinë “*adhim*” (shih. Hixhr, ۷۷.), gjë e cila na tregon qartë se mbi Fjalën e Tij nuk ka asnjë fjalë tjetër.

Sa më shumë mësojmë për emrat e bukur të Allahut, e shohim se duke e njohur Zotin tonë me emrat dhe cilësitë e Tij, i ndjejmë edhe më fuqishëm këto cilësi. Për rrjedhojë, neve na shtohet edhe respekti, edhe dashuria për çdo gjë që vjen prej Tij dhe ruhem i prej çdo gabimi ndaj Tij. Siç thonë edhe mistikët, “*kush përpigjet ta njohë Zotin me të gjitha emrat e Tij, në zemrën e tij shtohet dashuria, respekti, frika dhe madhërimi ndaj Tij.*”

Me qëllim që emri Adhim të manifestohet në besimin tonë dhe, për rrjedhojë ta njohim dhe ta respektojmë Allahun ashtu siç e meriton, duhet të arrijmë të shohim Madhësinë e Allahut që prej një grimce pluhuri, e deri tek galaktikat e stërmëdha, duke shtuar dijen dhe falënderimin për të gjitha këto. Një mendje e zbrazët nga dija, nuk mund ta perceptojë madhësinë e Allahut në gjithësi. Vlerën e diçkaje mund ta kuptojë vetëm ai që e njih

atë ashtu siç duhet. Kjo vlen edhe për të kuptuar madhësinë e Zotit tonë. Pra, më parë duhet të kesh në mendje një mendim dhe kriter në lidhje me madhësinë. Edhe pse asnjë mendje nuk e ka kapacitetin e duhur për të përfytyruar ashtu siç duhet madhësinë e Allahut, njeriu duhet ta vendosë Atë në pikën më të lartë të botës së vet të imagjinatës dhe nuk duhet ta krahasojë me asnjë madhësi tjetër. Pasi të ketë arritur këtë kthjelltësi në pikën e besimit, duhet të qëndrojë larg prej veprave që janë në kundërshtim me dinjitetin që i ka hije një njeriu, tek i cili manifestohet emri hyjnor Adhim dhe që është krijuar si krijesa më e nderuar.

Rrënja e emrit Adhim, është “A-Dh-M” dhe do të thotë, “forcë, parim, themel, kryesor”. Madje, për shkak se edhe kocka është pjesa kryesore që e mban në këmbë trupin e njeriut, ajo është quajtur “adhm”. Kështu, edhe Allahu i Madhëruar, i Cili është Zoti i Botëve, është esenca dhe themeli i gjithçkaje. Të gjitha argumentet që shpjegojnë krijimin vijnë e mblidhen vetëm në një pikë përfundimtare, në ekzistencën e Tij. Ata që nuk arrijnë, ose nuk duan ta bëjnë këtë lidhje, nuk arrijnë të gjejnë as edhe një shkak kryesor në atë pikë dhe, për këtë arsye, përpigjen të prodhojnë ekzistenca nga “asgjëja”.

Po ashtu, nga e njëjta rrënjë vjen edhe fjala “adhimet”, që do të thotë durim, qëndresë dhe rezistencë. Nëse i marrim parasysh të gjitha këto domethënie, do të kuptojmë se ndërkohë që ndërtojmë moralin tonë me vullnetin tonë, përpjekja për të qenë themel në shoqërinë tonë dhe qëndresa me durim në parimet tona, do ta ngrenë edhe më tepër gradën tonë.



Të qenët i hapur ndaj ndikimit

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Çdo fe në vetvete posedon një tërësi dhe sistematikë. Për këtë arsye, fetë mund të konceptohen dhe përjetohen vetëm brenda vetvetes së tyre. Të copëtuarit është në kundërshtim me esencën dhe cilësinë e tyre. Fetarët që mund të hyjnë në këtë rrugë (në rrugën e copëtimit të fesë), nuk i pret gjë tjetër përveç se shkatërrimit. Këtë të vërtetë ajetet fisnike e shprehin si më poshtë:

“...Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?! Cilido prej jush që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.” (Bekare, 85)

Dihet se popujt e mëparshëm, prej të cilëve duhet të marrim mësim të ndryshme, kanë qenë të prishur dhe të paqëndrueshëm nga aspekti i besimit dhe adhurimit. Ndërkohë që prej tyre nuk është kërkuar një çrregullim i tillë, por vetëm njësimi i Zotit (xh.sh.) dhe singëriteti në këtë besim. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singërtë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.”** (Bejjineh, 5)

Të krishterët e përziën besimin e tevhidit dhe adhurimin ndaj Allahut me elemente të tjera dhe e shndërruan në trinitet. Çifutët e “privatizuan” Zotin dhe e bënë karakteristik vetëm për popullin e tyre. Pasi erdhi i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, si një argument dhe udhërrëfyes, i lëshoi ata në një mosmarrëveshje të thellë dhe rivalitet të pakuptimtë. Për këtë arsye, ata u zvarritën drejt një dileme të madhe në ndjenja dhe veprime.

Kjo gjendje e dhimbshme i bëri ata që t’i luftonin myslimanët dhe të përpëliteshin në ndjenjat e padurimit kundrejt tyre. Për shkak të këtyre, tentuan t’u prisnin rrugën myslimanëve.

Ndërkohë që nga njëra anë Zoti i Lartësuar na i shpjegon gjendjet e tyre në Kuranin Fisnik, nga ana tjetër i paralajmëron myslimanët kundrejt rreziqeve që mund t’u vijnë nga Ehli Kitabi për sa i përket karakteristikës dhe virtytit të tevhidit në besim dhe unitetit në shoqëri:

“Thuj: “O ithtarët e Librit! Pse e pengoni nga rruga e Allahut atë që beson e përpigëni ta shtrembëroni (atë rrugë), ndërkohë që jeni dëshmitarë (se kjo është rruga e vërtetë)? (Dijeni se) Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprave që ju bëni!” O ju që keni besuar! Nëse i bindeni një grupi nga ata që u është dhënë Libri, ata do t’ju kthejnë në jobesimtarë, pasi patët besuar. E si mund të mos besoni kur juve ju lexohen shpalljet e Allahut dhe midis jush ndodhet i Dërguari i Tij?! Kush mbahet fort pas (fesë së) Allahut, sigurisht që është i drejtuar në udhë të mbarë. O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Al Imran, 99-102) Për ta arritur një jetë të tillë plot respekt dhe një përfundim të mirë / Husni hatime, bëhet ky apel: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!..”** (Al Imran, 103)

Ky paralajmërim dhe apel që u bëhet myslimanëve për të jetuar me këtë Islam tregon se do të ketë zhvillime negative sa i përket ndikimit nga popujt e mëparshëm dhe ndjekjes së rrugës së tyre. Këto lloj ndryshimesh nga njëra anë tregojnë ndjenjën e padurimit, ekzistencën e përpjekjeve të veçanta dhe të planifikuara dhe ndikimin e tyre te besimtarët. Nga ana tjetër nuk mund të mohohet se ky është rezultati i gjendjes së myslimanëve që janë të hapur ndaj këtij ndikimi.

Paralajmërimi i të Dërguarit të Allahut (a.s.)

Sado që të jenë të prishura gjendjet dhe qëndrimet e Ehli Kitabit / pasuesve të feve të mëparshme, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, na ka lajmëruar se me kalimin e kohës, për shkak të ndikimit sociologjik, myslimanët do të

përpiqen t'u ngjajnë atyre. Pastaj na ka bërë këtë paralajmërim:

Ebu Said el-Hudriu (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Ju do ta ndiqni pëllëmbë për pëllëmbë dhe hap pas hapi rrugën e atyre që kanë qenë para jush. Madje do ta ndiqni aq shumë sa që nëse ata hyjnë në vrimë të hardhucës, edhe ju do të tentoni të hyni pas tyre.”* Transmetuesi Ebu Saidi (r.a.), thotë: “E pyetëm: A çifutët dhe të krishterët do të jenë ata që do t'i ndjekim kaq shumë, o i Dërguari i Allahut?” Pejgamberi (a.s.), u përgjigj duke shtruar këtë pyetje: *“Kush mund të jetë tjetër përveç atyre?”* (Buhari, Enbija 50; Muslim Ilm 6)

Dijetarët shprehen se ky ndikim negativ dhe imitim nuk do të jetë në kufër, por në mëkate. Shprehjen absolute të hadithit më së shumti e komentojnë me shfaqjet në jetën sociale. Të menduarit se nuk do të jetë shkak për devijim nga aspekti i besimit ndjekja e gjurmëve të të tjerëve deri në këtë gradë, pra deri në prishje dhe mëkate, nuk mund të jetë gjë tjetër përveçse një shpresë dhe dëshirë optimizmi. Domethënë, madhësia e rrezikut kurrë nuk është e vogël apo zvogëluar me komentin “ndjekje në mëkate”.

Fjala “senen” që përmendet në hadithin fisnik do të thotë ecuri, stil i jetës, zakon dhe traditë. Konsiderimi si aftësi, mjeshtëri apo me një shprehje të re, civilizim dhe zhvillim ndjekjen e rrugës apo gjurmëve, domethënë, ndjekjen e formës së jetesës së umeteve të mëparshme si çifutët dhe të krishterët pa i dhënë aspak rëndësi vështirësisë së kësaj qoftë edhe në veprat më të papranueshme si “hyrja në vrimën e hardhucës”, padyshim se është shkatërrim dhe humbje e identitetit dhe personalitetit si individ e si umet. Kjo do të thotë që identitetin e veçantë dhe të lartë që na e ka dhënë Kurani Fisnik dhe Suneti ta ndërrojmë me një identitet të huaj. Asnjë lloj justifikimi nuk është i mjaftueshëm për ta shfaqur si të pranueshëm dhe logjik këtë falimentim dhe shkatërrim. Zgjidhja për këtë është lidhja me Kurantin Fisnik dhe Sunetin në çdo fushë e në çdo kohë, përpjekja për t'u kapur fort pas tyre dhe mbrojtja e identitetit me çdo çmim.

APELI PËR BASHKIM

Ja pra, pikërisht në këtë pikë na del përpara thirrja e Allahut të Lartësuar për bashkim: *“(O ju që keni besuar!) Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!..”* (Al Imran, 103)

Fakti që Allahu i Lartësuar u drejtohet myslimanëve duke u thënë: *“O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”* – dhe menjëherë pas këtij jep urdhrin: *“(O ju që keni besuar!) Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!..”*, nxjerr në pah rëndësinë e madhe që ka edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër që

myslimanët të jenë në identitetin original të tyre si myslimanë dhe si rezultat ta ruajnë unitetin në shoqëri.

Pasi Allahu Teala në vazhdimësi të këtyre urdhrave ua kujton mirësitë dhe nderimet e Tij myslimanëve të asaj kohe, u ka treguar atyre dhe si rezultat edhe brezave të myslimanëve që do të vijnë pas tyre rrugën e mbrojtjes së shoqërisë së bashkuar duke u shprehur: *“Le të dalë prej jush një grup/kuadër që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara!..”* (Al Imran, 104)

Funksioni i kuadrit që i theksohet domosdoshmëria e ekzistencës së tij në ajetin fisnik është caktuar me të qenët e tij përfshirës i të gjitha shtresave të shoqërisë në thirrjen për mirësi e në emri bil-ma'ruf ve nehji anil-munker dhe me të qenët e tij në vijën: *“Mbahuni fort për litarin/librin/fenë e Allahut”*. Në ajetin që vijon është urdhëruar që myslimanët të mos bëhen si ata që janë përçarë dhe janë ndarë në çështjen e fesë ndërkohë që çdo gjë është e qartë”. Myslimanëve u është kërkuar që të mos e nxjerrin në plan të parë ndarjen dhe copëtimin duke bërë thirrje për medh'heb, fraksion grup apo diçka tjetër. Për këtë arsye, myslimanët duhet të kenë shumë kujdes që të mos e shndërrojnë si thirrje të xhematëve të tyre shërbimin dhe detyrën e tebligut/predikimit që do të thotë shpirje e Islamit te njerëzit, apo me një shprehje tjetër, informim i robërve të Allahut me fenë e fundit të Tij. Myslimanët para së gjithash duhet të fokusohen te fakti se, për sa njerëz janë bërë shkak që ata të pranojnë Islamin, sepse sihariqi që i Dërguari i Allahut (a.s.), kur i ka thënë Aliut (r.a.): *“Nëse bëhesh shkak që një njeri të arrijë udhëzimin dhe të zgjedhë Islamin, është më e mirë për ty se sa posedimi i pasurisë më të vlefshme të kësaj bote.”* (Buhari, Fedailu'l-as'hab, 9), është në kontekstin fe-besim-umet. Futja e këtij sihariqi në një kornizë të ngushtë dhe tentativa për ta praktikuar në atë mënyrë, sjell probleme serioze dhe lëkundje të mëdha edhe nga aspekti i besimit, edhe nga aspekti i tërësisë, bashkimit dhe fuqisë së umetit ngaqë i zvarrit njerëzit deri në pikën e shenjtërimit dhe të imitimit të njerëzve të cilët nuk janë të mbrojtur nga gabimet /gajri ma'sum. Për sa i përket kësaj pike, rëndësi jetike ka që të bëjmë kujdes, në mënyrë që të mos ndikohemi nga mendimet e miqve të shkuajdesur dhe armiqve tradhtarë, sepse ne jemi të kënaqur me Allahun për Zot, me Islamin për fe dhe me Muhamedin (a.s.), për pejgamber. Ne asnjëherë nuk kërkojmë alternativa për këto vlera. Ne e pranojmë dhe pohojmë se vëllazëria islame është më e lartë, më e mjaftueshme dhe më primare se çdo lloj lidhjeje tjetër.

ZHVILLIMI DHE RENDI GLOBAL

NJË KËNDVËSHTRIM MORAL

— Ibrahim Kallën —

Problemet e varfërisë dhe të zhvillimit të pamjaftueshëm ekonomik mbeten kujtesë e fuqishme e papërsosurisë së rendit ekzistues global, ndërsa hyjmë në dekadën e dytë të shekullit të njëzet e një. Niveli i zhvillimit ekonomik dhe sofistikimi teknologjik ka sjellë pasuri dhe begati në pjesë të ndryshme të botës. Modernizmi në të cilin jetojmë e ka shndërruar mënyrën se si ne ndërveprojmë me botën natyrore në një anë, dhe me krijesat e tjera njerëzore në anën tjetër. Ai e ka ndryshuar mënyrën në të cilën e shohim veten në univers dhe pretendojmë pronësinë mbi të.

Por kjo botë është larg të qenit e drejtë. Madje nuk mund të thuhet se funksionon ashtu siç duhet. Rendi aktual global prodhon më shumë çrregullim dhe kaos se rregull e harmoni. Ai lejon një përqendrim ekstrem të pushtetit në duart e një grupi të vogël vendesh me fuqi hegjemonike dhe e privon nga të drejtat pjesën tjetër të botës. Dikotomia “Përrëndimi” dhe “Pjesa Tjetër e Botës” po bëhet shpejt një nga elementët përcaktues të rendit ekzistues global, një rend i bazuar ende në një botëkuptim eurocentrik.

KAPËRCIMI I EUROCENTRIZMIT

Mbështetja politike dhe ekonomike e këtij rendi prodhon lloje të ndryshme çekuilibrimesh dhe padrejtësish. Nga dështimi për ta ndarë pasurinë të mungesa e përfaqësimit politik, ai krijon një ndjenjë shpronësimi dhe tëhuajtjeje nga ana e shumicës së gjerë së botës joperëndimore. Nocionet eurocentrike të historisë, kulturës, politikës, mjeteve të informimit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare e shtynë pjesën tjetër të botës në cep të historisë, duke i privuar nga një ndjenjë identiteti dhe veprimi të vetëdijshëm. Ai i bën ata në shkallë të ndryshme skllëvër të rendit global.

Ne jemi zhgënjyer tashmë me dy premtime të modernizmit, të shpjguara pothuajse një shekull

më parë në mënyrë elokuate nga Maks Veberi: individi i lirë dhe shoqëria racionale. Ideja se bota do të bëhej një hapësirë globale që funksionon në mënyrë racionale, me individë të lirë dhe vetëpërbushës, është zëvendësuar me kohë nga hierarkitë mizore dhe mungesa e barazisë së modernizimit klasik.

Zhvillimi dhe modernizimi për botën joeuropiane nënkuptoi adoptimin e modernizmit përrëndimor. Por kjo ngjau shumë më shpesh në mënyrat më të kushtueshme dhe jo të efektshme, për të mos folur për dhunën dhe brutalitetin që i shoqëroi fund e krye politikat e modernizimit në botën në zhvillim.

Ne hyjmë në një terren të ri ndërsa lëvizim nga modernizimi klasik te globalizimi. Modernizimi ishte i bazuar pak a shumë në një model eurocentrik, të kontrolluar nga një qendër e vetme pushteti, dhe pretenduar të jetë i parashikueshëm në proceset dhe rezultatet e tij. Globalizimi paraqet mundësi të reja. Ai lëviz në drejtime të shumta, është i hapur ndaj interpretimeve të larmishme, dhe u jep mundësi të luajnë një rol aktorëve gjithfarësojës, me shkallë të ndryshme pushteti dhe ndikimi. Për definicion, globalizimi nuk mund të jetë eurocentrik apo të ketë një qendër tjetër të vetme në botën konfuciane apo islame.

Por ky nuk është një proces aq në vaj, sa ç’mendojnë mbrojtësit e globalizimit. Edhe globalizimi, ashtu si modernizimi klasik, paraqet sfida dhe krijon hierarki pushteti, pasurie dhe ndikimi. Arsyeja për këtë është e thjeshtë, por fundamentale: bota si një e tërë nuk funksionon kurrë si një njësi. Globalizimi ka krijuar hapësira mundësish të reja për popujt më pak të avantazhuar të botës. Vendet e varfra kanë përfitime të caktuara nga programet ndërkombëtare. Por sistemi ekonomik dhe politik global u jep gjithashtu mundësi vendeve më të fuqishme ta ushtrojnë ndikimin e tyre në përpjestime më të mëdha, duke çuar në lloje të ndryshme pa-

drejtësish dhe çekuilibrimesh. Edhe programet më të suksesshme të ndihmës krijojnë forma të reja varësie. Kjo ka të bëjë deri diku me natyrën e rendit global në të cilin jetojmë.

NJË REND I RI GLOBAL?

Rendi aktual ndërkombëtar po funksionon pa një qendër, apo me qendra të ndryshme, gjë e cila është e barabartë me të njëjtën gjë. Diskutimi për një “botë postamerikane” po kthehet gjithnjë e më tepër në një debat mbi një “Amerikë postimperiale” në njërën anë, e mbi “ngritjen e pjesës tjetër të botës” në anën tjetër. Mbetet për t’u parë se si kanë për t’u shfrytëzuar në politikën botërore përkufizimet e reja të fuqisë amerikane, veçanërisht pas vrasjes hollivudiane të Osama bin Ladenit. Megjithatë, një gjë është e qartë: kanë ikur kohët kur ne e shihnim botën nga një këndvështrim vetëm amerikan, apo europian, apo rus. Filozofi gjerman Jurgen Habermas ka të drejtë kur thotë se “kundërshtitë empirike ndaj mundësisë së përmbushjes realisht të vizionit amerikan [për dominim global] përkojnë me tezën se shoqëria globale është bërë tejet komplekse për t’u kontrolluar nga një qendër, përmes një politike të mbështetur nga fuqia ushtarake.”

Habermasi argumenton më tej se “vetëkuptimi i modernizmit ... është trajtësuar nga një universalizëm barazimtar, që kërkon një shfokusim të këndvështrimit. Ai kërkon relativizimin e pikëpamjeve ndaj këndvështrimeve interpretuese të të tjerëve njëjloj të pozicionuar dhe njëjloj të ngarkuar.” Eshtë e diskutueshme nëse modernizmi përëndimor e ka zbatuar këtë parim në mënyrë të njëmendtë dhe koherente në sferat kryesore të politikës dhe kulturës moderne. Por fakti i njohjes së ekzistencës së të tjerëve është bërë gjithnjë e më shumë një realitet i ngutshëm dhe një imperativ politik. Kjo vlen për fuqinë amerikane, si dhe për të tjerët që mund të ëndërrojnë t’i zëvendësojnë SHBA-të si superfuqia e ardhshme e botës, nëse mund të ndeshet përsëri në histori diçka e ngjashme me fuqinë e SHBA-ve në shekullin e njëzetë.

Rënia e besimit në një fuqi të vetme globale shkon krah për krah me një kërkim për një shpërndarje të re të pushtetit, për një bosht të ri të rendit global dhe një seri të re vlerash, për të mbështetur dhe mbajtur në këmbë një sistem të tillë. Ne mund ta shohim veten si “realistë hobesianë” apo “idealistë kantianë”: ndërsa të fundit e afirmojnë nocionin e Kantit mbi “paqen e përhershme” dhe “gjendjen kozmopolitane”, që bën thirrje për multilateralizëm, diplomaci dhe ligj ndërkombëtar, të parët operojnë,

për të cituar Robert Kagan-in, “në një botë arkaike hobesiane, ku nuk mund t’u zësh besë rregullave dhe ligjeve ndërkombëtare, dhe ku siguria e vërtetë, mbrojtja dhe promovimi i një rendi liberal varet ende në posedimin dhe përdorimin e fuqisë ushtarake.”

Parashikimi i parakohshëm i Fransis Fukujamës se kërkimi i njeriut për sistemin më të mirë moral dhe politik ka ardhur në fund me shtrirjen globale dhe komandimin e kapitalizmit liberal, demokratik (teza e “Fundit të Historisë”) ka rezultuar i gabuar nga dinamika e globalizimit në njërën anë, e nga realitetet e reja të ngritjes së feve në anën tjetër. Ata të cilët mbrojnë idenë se “bota është e rrafshët” paraqesin argumente kundër përbalueshmërisë së një superfuqie të vetme apo hegjemonike. Por kjo është një analizë e tejthjeshtëzuar e mënyrës se si janë gjeneruar dhe shpërndarë globalisht pushteti dhe pasuria. Hendeku në zgjerim midis të pasurve dhe të varfërve sugjeron dëshmi të bollshme të mungesës së vazhdueshme të barazisë së botës.

KOZMOPOLITANIZMI MORAL

Korrigjimi i të metave fundamentale të sistemit ndërkombëtar ekzistues kërkon më shumë se ekonomi të efektshme dhe programe ndihme. Ai kërkon asgjë më pak se një rishikim të hamendësimeve dhe premisave tona bazë se si mund të bëhet i mundur një rend i drejtë global. Një nga tundimet më të mëdha të historisë moderne është të përpiqet të ndërtojë një rend ndërkombëtar nëpërmjet inxhinierisë sociale dhe të pretendojë se planifikimi më i mirë mund të japë zgjidhje për çdo problem. Një sistem botëror njëmend barazimtar dhe kozmopolitan mund të lindë vetëm kur ne t’i vëmë poshtë hierarkitë e pushtetit që përcaktojnë parametrat bazë të marrëdhënieve ndërkombëtare sot. Me këtë domethënie të përgjithshme, edhe ndryshimi i përbërjes së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pranimi i dy apo tre vendeve të tjera synon përqendrimin në çështjet më fundamentale, që pengojnë një rend global kozmopolitan.

Çështjet e zhvillimit, varfërisë dhe të drejtësisë ekonomike, nuk janë thjesht të karakterit teknik apo burokratik. Ato janë para së gjithash çështje morale, me nënkuptime të thella për humanitetin tonë. Çështja fundamentale nuk është nëse ne mund t’u japim ndihmë vendeve të varfra, por nëse të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtën e asaj që Aristoteli e quajti “jetë e mirë.” Shkalla në të cilën ne kemi mundësi t’u qasemi përbërësve bazë të një jete të mirë përcakton gjithashtu nivelin e qytetërimit dhe

humanitetit tonë. Ky është dallimi midis njerëzve të menduar se jetojnë një jetë të mirë dhe qenieve të tjera të gjalla që thjesht jetojnë një “jetë”.

Pra, çfarë është jeta e mirë? Aristoteli e përkufizoi atë si përmbushjen maksimale të një aftësie unike për njerëzit. Ajo është aftësia për të arsytuar, por për të arsytuar mirë, d.m.th., në mënyrë të saktë dhe të duhur. Njerëzit, si kafshë racionale, pritet të jetojnë si qenie racionale. Aristoteli argumentoi më tej se synimi përfundimtar i arsytimit njerëzor është të mësojë se si të jetojë në përputhje me virtytin. Ne e disjelojmë mendjen tonë për të njohur dallimin së vërtetës dhe së rremes, por po ashtu midis së drejtës dhe së gabuarës.

Një mendimi racional që nuk ka lidhje me realitetin i mungon diçka fundamentale, dhe kjo është ajo ku arsyeja dhe moraliteti bëhen bashkë. Virtytet janë mënyra në të cilën ne veprojmë në përputhje me natyrën e gjërave. Kjo do të thotë që ne të njohim vetveten, por gjithashtu realitetin e gjërave, si janë ato dhe si ne vendosim lidhje me to. Të bashkuara, arsyeja dhe virtyti na japin urretësi në kuptimin më të gjerë të fjalës, pra, aftësinë për ta kuptuar botën dhe për t’u marrë me të nëpërmjet syve të arsyes dhe virtytit në të njëjtën kohë.

Çdo rendi, rajonal apo global, i duhet t’i përmbushë këto kriteret bazë që të meritojë të quhet human dhe i përshtatshëm për humanitetin tonë. Jeta e mirë është e drejtë e të gjitha krijesave njerëzore, pavarësisht nga feja, kultura, etniciteti apo shtëpësia e tyre. Kjo është baza e kozmopolitanizmit moral, dhe sfidon paradigmen ekzistuese të sistemit të kombit.

JETË E MIRË, QYTET I VIRTYTSHËM

Filozofi musliman i shekullit të nëntë, Ebu Nasër el-Farabiu, duke punuar mbi këtë çështje, shqiptoi nocionin e “qytetit të virtytshëm”, si baza e një rendi politik të drejtë dhe human. Ai paraqet te “Pikëpamjet e banorëve të qytetit të virtytshëm” një diskutim të shtjelluar mbi atë se si lind nga një metafizikë dhe kozmologji e gjithmbarshme një rend politik i bazuar në arsyen dhe virtytin. Synimi i rendit politik është t’u mundësojë njerëzve të çojnë një jetë të virtytshme, dhe ky është një kusht thelbësor për lumturinë tonë. Ai është një rend i bazuar në parimet e arsyes, drejtësisë, virtytit dhe përgjegjshmërisë. Është një sistem socio-politik në të cilin mbizotëron etika e bashkekzistencës, dhe që u jep mundësi bashkësive të ndryshme njerëzore të jetojnë së bashku, për të punuar për të mirën e përgjithshme.

Arsyeja se pse i vura në dukje Aristotelin dhe Fa-

rabiun është ngaqë rendit ekzistues global i mungon diçka fundamentale, aq shumë sa miliarda njerëz po jetojnë në kushte që lëndojnë dinjitetin njerëzor, e në disa raste i privojnë ata nga humaniteti i tyre. Ne po trajtojmë diçka që shkon përtej ndihmës apo programeve teknike, qoftë kur flasim mbi trafikimin e qenieve njerëzore, mbi meritë e bazuara në identitetin, apo mbi varfërinë ekstreme.

Një tregues alarmues i kësaj është hendeku në rritje midis të pasurve dhe të varfërve në botë. Çështjet për të cilat mund të japim shpjegime alternative janë ato se çka krijon pasuri dhe çka çon në varfëri. Mënyra në të cilën e shfrytëzojmë botën ka të bëjë deri diku me mënyrën në të cilën duam të arrijmë një nivel pasurie dhe mirëqenie materiale. Gara për zhvillim dhe tejzhvillim është një nga elementët përcaktues të epokës sonë. Qeveritë, korporatat ndërkombëtare, tregjet e lira, kompanitë e mëdha, dhe miliona njerëz, të cilët i bëjnë ato të punojnë, janë pjesë e asaj që ne tashmë e quajmë ekonomi globale.

Por një pyetje morale fundamentale është ajo se ç’duhet të bëjmë me pasurinë që kemi. Pa mohuar ekzistencën e programeve të suksesshme të zhvillimit ekonomik dhe shpërndarjes së barabartë të pasurisë, ne na mungon ende etika e ndarjes, e cila do ta zvogëlonte e jo ta thellonte hendekun midis të pasurve dhe të varfërve. Ky është një parim moral që nënvizon humanitetin tonë të përbashkët dhe na sjell në mendje se për ekzistencën tonë në botë ka më shumë se sa një garë të pamëshirshme për përfitime dhe interesa. Theksohet se ne jemi të tërë bij të Ademit dhe Havasë, dhe se të tërë e ndajmë botën, sepse askush prej nesh nuk është zot i saj. Ne na bashkon një parim më i lartë moral se gjeografia, ekonomia, apo politika.

Etika e bashkekzistencës dhe etika e ndarjes janë dy shtyllat mbi të cilat mund të funksionojë një rend i ri global, i bazuar në drejtësinë, barazinë dhe dinjitetin njerëzor. Ndërsa i hedhim sytë në dekadën tjetër, gjatë së cilës kërkojmë ta zvogëlojmë numrin e vendeve më pak të zhvilluara, nevojitet që të bëjmë ndryshime të mëdha në rendin ekzistues ndërkombëtar dhe të zhvillojmë një këndvështrim të ri mbi pasurinë, varfërinë dhe ndërvarësinë. Ndërkohë që bota jonë bëhet gjithnjë e më shumë e globalizuar dhe e ndërvarur, nuk mund të pretendojmë t’i shpërfillim këto probleme, me idenë se nuk na përkasin ne, dhe të përqendrohemi thjesht në përparësitë tona kombëtare. Etika e ndarjes nuk është vetëm një ideal i lartë moral. Ajo ka pasoja reale në jetë dhe mund të ndryshojë mënyrën se si ne jetojmë në botë dhe si i trajtojmë çështjet e zhvillimit dhe varfërisë.

“O Allah!
Të kërkoj mbrojtje Ty
nga zhdukja e mirësive të Tua, nga
prishja e shëndetit,
nga fatkeqësia e befasishme
dhe nga çdo lloj zemërim i yti!”

(Nesai, es-Sunenu'l-Kubra,
Istiadhe, 56, nr: 7955.)

Plepi dhe kungulli

Pranë pemës së plepit po rritej një filiz kungulli. Çdo ditë që kalonte pranvera, kjo bimë filloi të lartësohej duke u kacavjerrë te plepi. Kungulli i cili po rritej me shpejtësi duke u ndikuar edhe nga shiu dhe dielli, arriti lartësinë e plepit. Kur koka i arriti majën e plepit me një shpejtësi kaq të madhe, një ditë nuk duroi dot dhe e pyeti plepin: “Për sa muaj je bërë kaq i gjatë?” Plepi i tha: “Për dhjetë vjet...” Kungulli qeshi duke i lëkundur lulet dhe i tha: “Për dhjetë vjet? Unë për dy muaj pothuajse kam arritur të njëjtën gjatësi me ty.” Plepi ia ktheu: “E vërtetë... Shumë e vërtetë.” Ditët pasuan njëra-tjetrën. Kur filluan të frynin erërat e vjeshtës, kungulli së pari kishte të ftohtë, pastaj gjithë filluan t’i binin një nga një. Sa më shumë që shtohet i ftohti, aq më shumë filloi të ulej poshtë. Kungulli e pyeti plepin me një shqetësim dhe pikëllim të madh: “Çfarë po më ndodh kështu?” Plepi iu përgjigj: “Po vdes.” Kungulli rënkoj dhe e pyeti përsëri: “Përse?” Përgjigja që mori ishte shumë domethënëse: “Për shkak se u përpoqe të arrije për dy muaj në vendin që kam arritur për dhjetë vjet.”

• Fëmijët rriten më shumë në pranverë.

Fakte
Interesante

• Diametri i Diellit është 109 herë më i madh se i Tokës (1.5 milion km). Vëllimi i Diellit është 1.3 milion herë më i madh se i Tokës. Masa e Diellit është 333.000 herë më e rëndë se masa e Tokës.

• Një plesht mund të hidhet në një lartësi 150 herë më të madhe se vetja e tij. Për ta arritur këtë largësi, njeriu duhet të hidhet afërsisht 30 metra.

Aforizëm

“Sa më pak që të dijë
njeriu, aq më shumë
pandeh se di.”

(J. J. Rousseau)

VËLLAZËRIA

dhuratë nga Zoti

— Ferit Piku —

Allahu thotë në Kuranin fisnik: “**Është Allahu Ai që i bashkoi zemrat e tyre**”. (Enfal: 63).

Në këtë temë do të flasim për një nga dhuratat e Zotit, për vëllazërinë. Ajo nuk fitohet as me para, as me interesa, as me imponim, por ajo është dhuratë e Zotit. Kjo vëllazëri është dhuratë e besimit dhe nuk ka besim, ku nuk ka vëllazëri. Kjo fe është daluar gjithmonë për lidhjen që kanë besimtarët me njëri-tjetrin. Këtë vëllazëri e kanë zili shejtani dhe pasuesit e tij, prandaj duhet ta mbajmë fort këtë vëllazëri. Këtë çështje e ka sqaruar Zoti, për këtë çështje ka folur profeti (a.s.), i cili e ka praktikuar atë bashkë me besimtarët. Pra këtu do të flasim për të drejtat e vëllazërisë dhe çfarë e prish atë.

E pyetën profetin (a.s.), se cili është haku i një myslimani ndaj një tjetri. Ai u përgjigj: “Ato janë gjashtë:

1- KUR TA TAKOSH VËLLAIN TËND, JEPI SELAM ATIJ.

Prandaj ai që jep selam i pari është më i mirë dhe ndërsa ai që jep selam i pari bën sunetin, ai që e

dëgjon e ka vaxhib ta kthejë selamin. Selami është përshëndetja e Zotit për banorët e xhenetit, është përshëndetja, që melekët i dhanë Ademit (a.s.). Selami është ai që i bashkon zemrat, selami është dua (lutje). Kur t’i japësh dikujt selam, dije se je lutur për atë njeri, që paqja dhe mëshira e Allahut të jetë mbi të. Prandaj le ta përhapim selamin jo vetëm ndërmjet nesh, por edhe më gjerë. Selami nuk është shprehje arabe, por është shenjë e besimit, është tregues i vëllazërisë muslimane dhe është ajo që i bashkon muslimanët kudo që janë. Profeti (a.s.) sqaron, se ai që është një i jep selam grupit, ai që është në këmbë i jep selam atij që është ulur, i vogli i jep selam më të madhit e kështu me radhë, derisa në fund ka thënë, se më i miri mes dy muslimanëve është ai që e nis me selam. Pra selami duhet të bëhet me nijetin, që më shumë se një përshëndetje të jetë një lutje dhe bashkim i zemrave të njerëzve.

2- NËSE TË FTON, PËRGJIGJU FTESËS SË TIJ.

Nëse vëllai yt të thërret në familjen e tij, në ndonjë

gëzim apo hidhërim që ka dhe ti nuk sheh ndonjë pengesë, atëherë shko tek ai. Përgjigjia e ftesës në hidhërim është më obligative sesa në gëzim. Ndryshe është një musliman, që të ka vizituar dhe e ke vizituar dhe ndryshe është një tjetër, që vetëm të jep selam dhe nuk e di as ku e ke shtëpinë, as çfarë hallesh ke. Përveç kësaj, çdo musliman që hyn në shtëpinë e një tjetri, është ftesë për të tjerët, sepse ne besojmë se kur një musliman hyn në një shtëpi, aty hyn bereqeti i Zotit. Gjithashtu nuk duhet të bëjmë dallim, nëse ai që të fton është i pasur apo i varfër, i shkolluar apo i pashkolluar, por duhet t'u përgjigjemi të gjithëve dhe Zoti na faltë se sa herë mund t'ia thyejmë zemrën dikujt dhe ai mund të mendojë keq për ne, për shkak të këtij veprimi. Profeti (a.s.) nuk ka refuzuar asnjë ftesë. Ai shkoi tek një plakë, e cila e ftoi për drekë. Ai (a.s.) nuk refuzonte ftesat e vajzave të vogla të Medines, kur ato e merrnin për dore dhe e çonin nga të donin për të kryer hallet e tyre. Ai (a.s.) nuk ka refuzuar as ftesën e çifutëve, që në atë kohë ishin jobesimtarë dhe jetonin në Medine.

3- NËSE TË KËRKON KËSHILLË, KËSHILLOJE.

Këshilla duhet të jepet gjithmonë, por nëse të kërkohet, atëherë e ke obligim akoma më shumë që ta japësh, sepse ai që ta kërkon, të ka zgjedhur ty si konsulent për të zgjidhur hallin e tij, prandaj jepja këshillën dhe thuaja të vërtetën siç është ajo, pa hatërmbetje, pa lajka dhe pa zbukurim fjalësh, por vetëm këshilloje me të vërtetën. Por duhet ta këshillosh edhe kur nuk ta kërkon atë, sepse këshilla është thelbi i kësaj feje. Profeti (a.s.) thotë: **“Feja është këshillë”**.¹ Nëse nuk shkon në Arafat, nuk të quhet haxhi. Po kështu nëse nuk e jep këshillën, ti nuk e ke kuptuar Islamin. Profeti (a.s.) tha: **“Ndhmoje vëllain tënd edhe kur ka të drejtë edhe kur nuk ka të drejtë”** Shokët e tij e pyetën: “O profet i Zotit! Ne e ndihmojmë kur i kanë bërë padrejtësi, por si do ta ndihmojmë atë, kur ai vetë bën padrejtësi”? Profeti (a.s.) tha: **“Ndhmoje duke e ndaluar nga padrejtësia”**.² Pra ndalesa mund të jetë edhe me një këshillë. Shpesh vihemi në siklet për t'i thënë një këshillë vëllait tonë, duke menduar se mund të na e marrë për keq, por har-

rojmë se dhënia e këshillës është obligim përpara Zotit. Disa nga sahabët kanë thënë: “I dhamë besën profetit (a.s.), që të dëgjojmë të parët tanë dhe t'ia japim këshillën çdo muslimani”. Por një rëndësi të madhe ka edhe forma sesi jepet këshilla. Merre vëllain anash dhe thuaji fjalë të buta, se këshilla është amanet dhe qëllimi kryesor nuk është ta demaskosh tjetrin, por t'i tregosh një gabim, që ai nuk e shikon. Surja “Asr” ka qenë ajo sure, me të cilën sahabët ndaheshin nga njëri-tjetri, pasi kishin biseduar. Ajeti i fundit i sures Asr thotë, që besimtarët porosisin njëri-tjetrin për të ndjekur të vërtetën dhe për të pasur durim. Të urdhërosh për mirë dhe të ndalosh nga e keqja është urdhër për njerëzit e tjerë, jo më pastaj për vëllezërit e tu. Sikur të ekzistonte sinqerisht kjo punë, ne do të ecnim shumë përpara, por kam frikë se shpesh ne i mbyllim sytë dhe veshët, ndërsa gabimet shtohen dita-ditës dhe secili mendon vetëm për vete. Duke vepruar kështu, ne mbetemi individë dhe individët gjithmonë janë të dobët. Ndërsa xhemati sado gabime që të ketë, përsëri është më i fortë se individi. Zoti na bëftë nga ata që e japin këshillën në formën më të mirë.

Ne themi “Shëndet”. Kjo nuk është fjalë e keqe, por duaja që ne bëjmë për atë njeri që teshtin, është më e madhe se shëndeti. Pra ne lutemi, që Zoti ta mëshirojë atë person, ta pastrojë nga të këqijat në dynja dhe ahiret.

4- NËSE TESHTIN DHE FALËNDERON ZOTIN, LUTU PËR TË.

Kjo duhet diçka shumë e rëndomtë, por e kemi detyrë që të lutemi për vëllain tonë, kur ai teshtin dhe falenderon Allahun. Teshtima është pjesë e fizikut të njeriut. Ajo mund të jetë çlirim, por edhe tregues sëmundjeje. Kur njeriu teshtin, ai çliron energji. Në këtë moment njeriu falënderon Zotin për këtë, ndërsa ai që e dëgjon i thotë: “Zoti të mëshiroftë”. Nëse ai nuk e falënderon Zotin, atëherë mësoje ti që ta falenderojë Zotin. Ne themi “Shëndet”. Kjo nuk është fjalë e keqe, por duaja që ne bëjmë për atë njeri që teshtin, është më e madhe se shëndeti. Pra ne lutemi, që Zoti ta mëshirojë atë person, ta pastrojë nga të këqijat në dynja dhe ahiret. Kështu na ka mësuar profeti (a.s.). Profeti (a.s.) na ka mësuar edhe formën e teshtimës. Ai ka thënë: **“Nëse dikut i vjen për të teshtirë, të mundohet sa të mundet ta mbajë zërin e tij dhe ta largojë gojën e tij nga njerëzit e tjerë. Gjithashtu duhet ta afrojë edhe dorën tek goja”**. Çifutët kishin dëgjuar, se profeti (a.s.) lutej për atë që teshtinte dhe lutja e profetit (a.s.) nuk kthehet mbrapsht. Prandaj ata shkonin

1. Hadith i vërtetë. Muslimi (55).

2. Hadith i vërtetë. Buhariu (2444).

tek ai dhe e provokonin teshtimën, por kur e bënin këtë, profeti (a.s.) u thoshte: **“Zoti u drejtoftë dhe ua rregulloftë punët”**.³ Pra e ke obligim të lutesh për atë që teshtin.

5- NËSE VËLLAI YT ËSHTË SËMURË, SHKOI PËR VIZITË.

Kur njeriu sëmuret, në atë formë që shtrihet në shtrat, ai pret njerëz dhe është më afër se asnjëherë tjetër me Allahun, sepse është i dobët e i pafuqishëm dhe është i dorëzuar tek Allahu. Ne e dimë, se profeti (a.s.) ka shkuar për vizitë tek çifutët, kur ata ishin sëmurë. Por nëse e ke obligim njëherë tek njerëzit e tjerë, mendo si është puna e vëllait tënd, që pret vizitën tënde. Pra shkoji për vizitë vëllait tënd, ngushëlloje dhe jepi atij durim e shpresë. Ditën e Gjykimit Zoti i thotë njeriut: “O bir i Ademit, U sëmura dhe nuk erdhe të më shikosh”. Njeriu thotë: “I lartësuar qofsh ti o Zot. Po ku sëmuresh Ti”?! Allahu thotë: “U sëmuri rob i Im. Po të vije tek ai, do të më gjeje Mua aty”. Profeti (a.s.) thotë: **“Ai që bën nijet dhe niset të vizitojë vëllain e tij të sëmurë, 70.000 melekë e shoqërojnë atë person dhe lutën për të derisa të kthehet”**.⁴ Të gjithë e kemi provuar, se kur sëmuremi dhe nuk na vjen kush për vizitë, na mbetet merak kjo gjë. Prandaj sa herë që profeti (a.s.) merrte vesh se dikush është sëmurë, menjëherë nxitonte t’i shkonte për vizitë.

6- NËSE VËLLAI YT VDES, SHOQËROJE XHENAZEN E TIJ.⁵

Ky është obligimi i fundit që ke ndaj vëllait tënd. Të marrësh pjesë në xhenazen e dikujt, ka sevap shumë të madh. Profeti (a.s.) thotë: **“Kush e shoqëron xhenazen e një muslimani dhe e pret derisa të varroset, merr dy male me sevape. Nëse nuk pret derisa të varroset, merr vetëm një mal me sevape”**.⁶ Pra ky veprim është sevap për ne, por është gjithashtu edhe lehtësim për të vdekurin, sepse profeti (a.s.) thotë: **“Nëse mbliidhen dyzet persona për të falur xhenazen e një besimtari, Zoti i bën ata ndërmjetës për atë person dhe e fut atë në xhenet”**.⁷ Prandaj merr pjesë në xhenazen e vëllait tënd musliman, sepse kjo është dita, kur ai ka më shumë nevojë se kurrë për duanë (lutjen)

3. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (6223), Muslimi (2995) dhe Ebu Daudi (4999).

4. **Hadith i vërtetë.** Ibn Maxheh (1442) dhe Ebu Daudi (3099). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.

5. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (1240) dhe Muslimi (2162). Në rivajetin e Buhariut përmenden pesë detyrime, ndërsa rivajeti i Muslimit përmend gjashtë detyrime.

6. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (1325) dhe Muslimi (945).

7. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (948).

tënde. Kur dikush vdiste, profeti (a.s.) shkonte tek varri i atij personi dhe lutej: **“O Zot fale, o Zot mëshiroje, zgjeroja varrin, bëja kopsht prej kopshteve të xhenetit dhe jo gropë prej gropave të zjarrit, falja gjynahet dhe prite me mëshirën Tënde”**.⁸ Prandaj prania jote në xhenazen e dikujt është gjë e mirë për ty, për atë që ka vdekur dhe për të afërmit e tij. Kjo është ftesë në vetvete. Nuk është njëlloj si ai që e provon e si ai që flet. Na ka ndodhur të gjithëve të marrim pjesë në xhenazet e vëllezërve tanë, por është ndryshe kur të tjerët marrin pjesë në xhenazen e njeriut tënd të afërm. Kur njerëzit lënë punën dhe vijnë për të marrë pjesë në xhenazen e një muslimani, pa pasur asnjë interes, kjo është ftesa më e madhe që mund të bëhet, sepse të afërmit e atij që ka vdekur e kuptojnë, se këta njerëz i ka sjellë në këtë vend vetëm vëllazëria e besimit që kanë pasur me të vdekurin, mëshira e Zotit dhe sevapi i Tij.

Prandaj lus Zotin e gjithësisë të na mundësojë t’i bëjmë këta punë, të na mundësojë që t’i rregullojmë kohët tona, detyrimet tona, po gjithashtu t’i kryejmë edhe detyrimet ndaj këtyre myslimanëve të tjerë. Njeriu mund ta rregullojë edhe me pak të mira aty ku s’ia merr mendja, por mund ta prishë edhe me pak gjëra aty ku nuk ja merr mendja. Inshallah dëshira është e madhe, po shpresojmë që të ekzistojë edhe mundësia, se me të vërtetë ka shumë mundësi për të ofruar një model të mirë për njerëzit e tjerë. Zoti na mundësoftë t’i bëjmë këta punë.

Këto ishin gjashtë detyrime të përmendur në një hadith dhe po i përsëris edhe njëherë shumë shkurt:

- 1- Kur ta takosh një mysliman, jepi selam atij.
- 2- Kur të të ftojë, përgjigju ftesës së tij.
- 3- Kur kërkon këshillë, këshilloje atë.
- 4- Kur teshtin, lutu për të.
- 5- Kur sëmuret, vizitoe atë.
- 6- Kur të vdesë, shko dhe fali xhenazen atij.

Ka disa rregulla disa detyrime të tjera, të cilat i kam zgjedhur. Ato janë:


- Detyrimi i një myslimani ndaj një tjetri është **dua** (lutja) për të, pra është detyrë të lutesh për vëllain tënd mysliman. Prandaj po të shikoni duatë e besimtarëve në Kuran, ata lutën për vëllezërit e tyre dhe për ata që kanë kaluar përpara tyre, se vëllazëria është e madhe e muslimanët nuk janë vetëm ata që sheh me sy. Ka shumë muslimanë

8. **Hadith i dobët.** Tirmidhiu (2460). Shejh Albani e vlerëson hadithin shumë të dobët, ndërsa shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të dobët, por për pjesë të hadithit ka dëshmi përforcuese.

në botë, ka dhe shumë të tjerë që kanë kaluar në shpinën e kësaj toke dhe ka shumë të tjerë që do të vijnë mbas nesh, prandaj muslimani e ka lutjen e madhe. Duaja e tij nuk ka kufij dhe profeti (a.s.) i mësonte shokët e tij, të bënin dua për njëri-tjetrin, madje i mësonte të bënin dua edhe për atë vetë personalisht. Mos mendon se profeti (a.s.) ka nevojë për lutjet e ndonjë njeriu? Thonë, që kur e çoi një herë Omerin (r.a.) në një mision, i tha: “Mos na harro me dua o vëllaçko”, pra ia tha me përkëdheli. Imagjino se çfarë ndikimi kishte kjo tek Omeri (r.a.), që profeti (a.s.) i kërkon atij të lutet për të (a.s.). Profeti Muhamed (a.s.) i mësonte gjithmonë shokët e tij, të bënin dua për njëri-tjetrin, madje ka pasur prej pasuesve të sahabëve, që në duatë

vëllain tënd”. Pra në këtë rast ti indirekt po bën një dua për vete. Lutu për tjetrin, sepse lutja të kthehet edhe tek vetja jote. Duaja është obligim për të gjithë muslimanët. Nëse një musliman ka një problem dhe ti s'ke mundësi ta ndihmosh me ndonjë mënyrë tjetër, atëherë lutu për të, se ndoshta duaja jote ka peshë të madhe dhe sot kemi vëllezër në katër anët e botës, që kanë nevojë për lutjet tona.

- Detyrim tjetër është **ta falësh muslimanin, kur ti ke mendim të ndryshëm me të**. Asnjëherë nuk kanë qenë dy muslimanë me mendime të njëjta. Ibn Tejmija thotë kështu: “Nëse dy muslimanë do të ziheshin me njëri-tjetrin vetëm se kanë mendime të ndryshme, s'do të ngeleshin dy muslimanë në këtë botë, që do të ishin të pajtuar”. S'ka njerëz që kanë



“NËSE DY MUSLIMANË
DO TË ZIHESHIN ME NJËRI-TJETRIN
VETËM SE KANË MENDIME
TË NDRYSHME,
S'DO TË NGELESHIN
DY MUSLIMANË NË KËTË BOTË,
QË DO TË ISHIN TË PAJTUAR”

e tyre nuk thoshin vetëm “O Zot fali muslimanët dhe muslimanet besimtarët dhe besimtare”, por i përmendnim tek për tek me emra, saqë njëri prej tyre thoshte: “70 emra i kam gjithmonë gjithmonë ndërmend, kur lutem”. A e dini çfarë peshe ka kjo tek Zoti? Çfarë peshe ka në zemër, kur e përmend dhe emrin e tjetrit.

Të mësojmë të bëjmë dua edhe për të tjerët. Le të mos tregohemi egoistë, sepse shpeshherë mendojmë, se duaja është vendi ku ne jemi afër me Zotin, dhe njeriu ndjen një kënaqësi të madhe, kur ia hap zemrën Zotit dhe i lutet për problemet e veta. Megjithatë mos i harroni njerëzit e tjerë, sepse për atë njeri, i cili lutet për vëllain e tij, engjëjt i thonë: “Zoti të dhashtë edhe ty si ajo që po lutesh për

mendime të njëjta, sepse pa dyshim që çdonjëri do të ketë mendim të ndryshëm nga tjetri, prandaj mos u mërzi për këtë gjë. Kjo fe është e madhe dhe ka lënë hapësira për mendime ndryshe. Shokët e profetit (a.s.) kanë pasur mendime të ndryshme, kanë pasur edhe konflikte, por profeti (a.s.) i mësoi, që të mos urrehen, të mos përçahen për mendimet që i kanë të ndryshme, i mësoi që edhe kjo është e drejtë edhe kjo është e drejtë. Është hak i një muslimani ndaj një muslimani tjetër, që ta falë atë, kur ka mendime ndryshe nga ai. Sot shohim se ka njerëz, të cilët duan të shkosh drejt Zotit ashtu sikur do ai, pra sipas rrugës së tij. Këta njerëz harrojnë, se rruga për tek Zoti është e madhe dhe e gjerë. Është e vërtetë që është vetëm një rrugë, por ama ajo është

shumë e gjerë. Mund të ketë mendime dhe ide të ndryshme. Kjo rrugë ka mbajtur shumë njerëz para nesh, dijetarë të mëdhenj, të cilët kanë pasur debate me njëri-tjetrin, por asnjëherë nuk e kanë prishur zemrën. Pra fale vëllain tënd që ka mendim të ndryshëm nga mendimi yt.

Ekziston një rregull i artë: **“Ejani të bashkëpunojmë për ato gjëra që biem dakord dhe ta falim njëri-tjetrin për ato gjëra, që nuk biem dakord. Të paktën të ketë bashkëpunim për atë pika ku biem dakord”**. Shpesh njeriu shikon pika, ku nuk bie dakord me tjetrin dhe nuk bashkëpunon me të, por po të shikojmë mirë, do të vërejmë se kemi shumë mendime të përbashkëta. Por për një arsye apo për një tjetër, sot muslimanët nuk bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, sepse shikojnë vetëm dallimet mes tyre. Shembulli më i mirë për bashkëpunim me tjetrin janë imamët e medh’hebeve Ebu Hanife, Maliku, Shafiu dhe Ahmed. Kur shikon pasuesit e këtyre imamëve, të krijohet ideja se imamët kanë qenë armiq të njëri-tjetrit. Por po të lexosh historitë e tyre, do të gesh se kur ata takoheshin mes tyre, puthnin dorën e njëri-tjetrit dhe toleronin mendimet e njëri-tjetrit. Kur imam Shafiu shkoi në Irak, aty ku gjendej varri i Ebu Hanifes dhe kur fali namazin e sabahut (shafiiitë kur falin sabahun bëjnë dua dhe i ngrenë duart), ai nuk i ngriti duart. Nxënësit e tij i thanë: “O Imam. Një dijetar nuk ka të drejtë ta lerë mendimin e tij. Pse e bërë këtë”? Imam Shafiu u përgjigj: “E lashë në shenjë respekti ndaj këtij njeriu, që është në varr (ndaj Ebu Hanifes)”. Pra ata kishin mirëkuptim me njëri-tjetrin dhe asnjëherë nuk e akuzonin tjetrin në nijet, pasi atë e di vetëm Zoti.

- Detyrim tjetër i muslimanit është, **t’ia mbulojë të metat tjetrit**. Nuk ka njeri pa të meta, prandaj ai që kërkon një shok pa të meta, nuk ka për të gjetur asnjë shok. Mund të shohësh dikë, që bën një gabim të madh, prandaj ruaje atë dhe mbuloja gabimin, përveç rastit kur bëhet fjalë për një padrejtësi që ai i bën dikujt tjetër. Por kur ai po bën një gjynah për veten e tij, atëherë ti këshilloje atë dhe mos ia zbulo të metat përpara njerëzve të tjerë. Sikur Zoti t’i zbulonte gjynahet tona para njerëzve të tjerë, s’do të gjeje më dy vetë bashkë. Thonë se çifutëve iu shkruhej në derë gjynahu, që kishin bërë një natë më parë. Por Zoti e ka mëshiruar shumë umetin e profetit (a.s.) dhe ua ka mbuluar gjynahet. Zoti është Mbulues prandaj edhe besimtari duhet të jetë mbulues i gabimit të tjetrit. Profeti (a.s.) thotë:

“Kush e mbulon të metën e një muslimani në dynja, Zoti do ta mbulojë atë person në dynja dhe ahiret”.⁹ Kjo nuk bie ndesh me këshillën, pasi mbulimi është diçka tjetër. Ka njerëz që janë të sëmurë me këtë sëmurdje, pra me nxjerrjen në shesh të gabimeve të të tjerëve, a thua se filani është dërguar nga Zoti që të zbulojë gabimet e të tjerëve, duke harruar kështu veten e tij. Këta njerëz janë të ligj dhe fatkeq. Ata përfundojnë viktimitë e vetes së tyre. Profeti (a.s.) thotë: **“Kush i ndjek gjynahet dhe të metat e vëllait musliman, Zoti do ta turpërojë atë person qoftë edhe në dhomën e gjumit”**.¹⁰ Zoti nuk bën padrejtësi. Të gjithë kemi të meta, por ne duhet t’ia mbulojmë të metat njëri-tjetrit, nëse nuk i bëhet padrejtësi kujt dhe kjo nuk bie ndesh me dhënien e këshillës.

- Detyrim tjetër është që **t’ia pranosh betimin muslimanit**. Në radhë të parë mos e detyro që të betohet, mos i thuaj: “Betohu për Zotin”, sepse muslimani nuk gënjen kur flet, por nëse ai betohet dhe thotë: “Vallahi nuk e kam bërë këtë gjë”, atëherë duhet ta besosh atë. Këto ishin disa nga të drejtat që ka një musliman ndaj një vëllai tjetër musliman. Profeti (a.s.) na i ka mësuar të gjitha këto të drejta dhe detyrime.

Kjo lidhje nuk i pëlqen fare shejtanit, i cili nuk është aspak i lumtur, kur i shikon muslimanët që kanë lidhje të mira me njëri-tjetrin, janë të bashkuar dhe marrin pjesë në gëzime e në hidhërim. Pasuesit të shejtanit sado që mundohen për të pasur marrëdhënie të tilla, përsëri nuk ia arrijnë këtij qëllimi. Ata e kanë zili këtë lloj lidhjeje dhe do të mundohen me çdo formë ta prishin atë, por duhet të kemi parasysh disa gjëra, që vetë ne i prishim. Ato janë:

1- Gjëja e parë që e prish këtë vëllazëri, është **padrejtësia**. Nëse ka padrejtësi mes vëllezërve, nëse vetë ti ke bërë padrejtësi, dije se këtu nuk mban puna, dije se këtu fillon e shkatërrohet vëllazëria. Prandaj ji i drejtë me çdo njeri, madje tregohu i drejtë edhe me armiq të tu, sepse kjo është më afër devotshmërisë. Zoti na urdhëron të jemi të drejtë me miqtë dhe me armiq të tanë. Atëherë, nëse urdhërohesh të jesh i drejtë me armiq të, ç’mund të thuash për qëndrimin vëllezërve të tu!? Atëherë kij frikë Zotin. Profeti (a.s.) ka thënë: **“Muslimani është vëllai i mus-**

9. **Hadith i vërtetë**. Muslimi (2999).

10. **Hadithi i vërtetë për shkak të dëshmime përforcuese**. Ebu Daudi (4880). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë për shkak të dëshmime përforcuese.

limanit dhe nuk i bën padrejtësi atij".¹¹ Cilësia e parë e një muslimani është, se nuk i bën padrejtësi vëllait musliman. Padrejtësia e prish vëllazërinë, sidomos kur e ndjen që vëllai yt, njeriu yt i afërt të bën padrejtësi. Prandaj mos na bëftë Zoti njerëz të padrejtë as ndaj besimtarëve e as ndaj jobesimtarëve, aq më tepër ndaj vëllezërve tanë.

2- E dyta që prish vëllazërinë është **tallja dhe përbuzja qoftë edhe me shaka**. Pra nuk duhet të tallesh me tjetrin, ta vësh në lojë atë. Na ndodh që ta bëjmë këtë gjë, ndonjëherë me qejf, ndonjëherë me shaka. Por kjo është nga ato gjëra, që e prishin vëllazërinë, sepse tjetri mund ta durojë një herë dhe dy herë dhe nuk e duron më. Ose ke për ta ulur vëllain tënd musliman dhe ai do ta durojë këtë për hir të vëllazërisë, ose ai nuk ka forcë të reagojë, ose ti ke për ta thyer këtë vëllazëri. Shpesh e prishim në këtë pikë, duke bërë shaka dhe harrojmë që e vemë vëllain tonë në pozitë të vështirë, saqë ai nuk di se çfarë të bëjë, a të ta ktheje me forcë apo të durojë. Prandaj profeti (a.s.) na mëson, që t'i drejtohem tjetrit me fjalë sa më qetësuese. Profeti (a.s.) thotë: **"I mjafton muslimanit si gjynah, që ta përbuzë vëllain e tij"**.¹²

3- Ajo që e prish vëllazërinë është **paragjykimi**. Të mendosh keq për tjetrin e të jetosh me dyshime, do të thotë ta prishësh vëllazërinë. Profeti (a.s.) thotë: **"Kini kujdes nga paragjykimi, se është gënjeshtër më e madhe"**.¹³ Pra të ndërtosh një ide thjesht duke dyshuar. Nëse ke dëgjuar diçka për të, është më mirë ta marrësh anash dhe ta pyesësh nëse ajo që ke dëgjuar është e vërtetë apo jo. Profeti (a.s.) u thoshte shokëve të tij: **"Mos më flisni për të tjerët, por më lini që t'i njoh vetë njerëzit"**. Kur dikush të thotë një fjalë për dikë, dashje pa dashje krijon një mendim për atë njeri dhe kur e shikon tjetrin e mat mbi bazën e asaj që ke dëgjuar. Paragjykimi e prish

vëllazërinë dhe burrëria më e madhe është ta pyesësh tjetrin për atë që ke dëgjuar, të sqarohesh e të mos mbash gjë në zemër, sepse zemrat largohen vetvetiu nga njëra-tjetra.

4- Gjë tjetër që e prish vëllazërinë është **përgojimi**. Ky është kanceri i lidhjeve tona, sidomos kur përgojimi bëhet i ëmbël. Për këtë kemi ndalesa nga Kurani dhe nga hadithet e profetit (a.s.). Ajo që e prish vëllazërinë është smira, zemërimi, inati dhe debati i fortë. Në përgjithësi shikojmë, se kur bëhet debat, njerëzit bëhen nervozë për diçka që është shumë e thjeshtë. Pastaj muhabeti kalon në inat personal, në armiçësi, e cila nisi për diçka shumë qesharake. Në vëllazëri duhet pasur kujdes se si e thua fjalën, çfarë fjalësh thua dhe sido që të jetë puna, nuk duhet që debati të kalojë në inat personal. Prandaj replikat nuk janë shumë të pëlqyeshme. Profeti (a.s.) ndërhynte gjithmonë, kur nuhaste se debati po kthehej në inat personal, sepse shejtani luan me zemrat e njerëzve.

5- Vëllazërinë e prish **nervozizmi**, e prishin fjalët e pamatura dhe debati që bëhet thjesht për të kundërshtuar mendimin e tjetrit.

6- Vëllazërinë e prish **mendjemadhësia**. Njeriu nuk e duron mendjemadhësinë, aq më tepër kur ta bën ai që është vëllai yt. Ajo mund të jetë për shkak posti, për shkak pasurie apo familjeje. Prandaj profeti (a.s.) ulej bashkë me sahabët e tjerë dhe çdokush e ndjente veten të barabartë me të (a.s.). Nuk mbahet mend asnjë rast, kur ai ka dalë sipër tyre dhe po të mos ishte drita e fytyrës dhe sjelljet e tij, ai (a.s.) nuk do të njihej mes shokëve të tij.

E lus Zotin t'i afrojë zemrat tona, të na bëjë vëllezër që meritojnë ndihmën e Zotit në dynja dhe mëshirën e Zotit në ahiret, ta largojë shejtanin nga zemrat tona dhe të gjitha këto sëmundje që përmendëm. E lus Allahun që t'i japim hakun vëllazërisë, ta meritojmë emrin vëllezër dhe u bëftë kjo vëllazëri shkak për të mira në këtë botë dhe për faljen e Zotit në botën tjetër.

Amin!

11. **Hadith i vërtetë**. Müslimi (2580).

12. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (6076) dhe Müslimi (2559).

13. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (6066) dhe Müslimi (2563).



Panorama JONË

Nurten Çevikollu

Një pjesë e madhe e njerëzve tanë kanë një boshllëk shpirtëror... Zemrat u ngajnë me një lëmsh të ngatërruar ndjenjash... Në fakt, edhe pse ata nuk e vënë re këtë, ajo u shkakton një vuajtje të madhe. Ngaqë në tokën e zemrave të tyre nuk ka rënë mëshira e besimit, aty nuk mbijnë dhe nuk rriten filiza qetësie. Kur zemra nuk i kthehet lumturisë, për fat të keq as trupi nuk i kthehet asaj.

“Jeta bashkëkohore”, e cila kërkon t’i tërheqë njerëzit drejt vetes, nuk u falë atyre aspak lumturi të vërtetë. Njerëzit mundohen pa reshtur të jenë dhe të tregohen më bukur dhe më lart njëri-tjetrit. Çdo gjë për pamjen e jashtme... Kur duken shik dhe elegantë si manekinët e vitrinave të dyqaneve, sikur të gjitha shqetësimet u largohen. Epidemia e quajtur “modë” po i rrokullis njerëzit në rrëkenë e një shpenzimi të paepur.

Mes njerëzve nuk ka mbetur as një miqësi e sinqertë. Vazhdimisht ka egoizëm, konkurrencë dhe shoqëri që mbështetet në interesa... Kjo turmë ka pothuajse ndjenja të ngurosur... E kalojnë jetën “si të vdekur”, pa pasur dijeni nga jeta reale dhe e vërteta.

Cili është qëllimi i tyre në jetë? Të studiuarit në shkollat dhe universitetet më të mirë, pastaj punësimi në punët më prestigjioze? Të jetuarit një jetë të qetë, komode, pa shqetësime, pa menduar askënd, në egoizëm? Nuk do t’ia dijë, nuk mund të mendojë, sepse shijet e momentit i mjaftojnë njeriut të kohës sonë. Por ato shije të çastit e ndyjnë jetën, madje e shkatërrojnë të ardhmen. Pas kësaj vijnë lotët, pikëllimi, pesimizmi, duhani, pija, droga, ndoshta edhe vetëvrasja...

Këta njerëz që e shohin botën me syze dielli, në asnjë mënyrë nuk mund ta arrijnë ndriçimin. Ngaqë nuk drejtohen nga qëllimi i vërtetë për të cilin janë krijuar, brendësinë e kanë gjithmonë bosh dhe rrokullisen drejt botës së errësirës.

Në të vërtetë, ne i përkasim një feje që premtion “të vërtetën e të vërtetave” dhe një qytetërimi sublim. Çfarë është e vërteta e të vërtetave?

Përgjigja: “Të jesh i lumtur në këtë botë dhe në përjetësi.”

Cili është çelësi i kësaj lumturie të pafundme? “Dorëzimi dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit dhe Zotëruesit të gjithçkaje...”



Jo vetëm të rinjtë, por mbarë njerëzimi nga të gjitha moshat, të dyja gjinitë dhe nga të gjithë popujt vetëm në këtë dorëzim mund ta gjejnë lumturinë.

Shkalla e parë e këtij dorëzimi është besimi... Besimi në Allahun (xh.xh.), ekzistencën e Tij, njësimin dhe fuqinë e Tij... Besimi në librat dhe pejgamberët që Ai ka dërguar... Besimi se jeta që jetojmë e ka një fund, se pas atij "fundi" ka një jetë tjetër dhe se ka një llogari për të gjitha punët që kemi vepruar gjatë jetës së kësaj bote...

Vetëm se ky besim nuk është veç me një thënie të thatë: "besoj"!.. Përkundrazi, është një ngjarje që në vetvete e ndryshon dhe e transformon të gjithë jetën... Ka ndikim rrënjësor te të gjitha ndjenjat, mendimet dhe veprimet...

Allahu kurrë nuk e lë vetëm një rob i cili i beson dhe lidhet në këtë mënyrë. Ai (xh.xh.), pothuajse e mbështjell robin me mëshirën e Tij. Tashmë, për një njeri të tillë jeta nuk është më një barrë e rëndë. Madje edhe gjërat të cilat duken të thjeshta, e çojnë atë drejt lumturisë dhe meditimit për universin.

Drita udhëzuese e Allahut Teala që lëshon mëshirë si shi dhe që plas farën, mbush zemrën me filiza dhe që çel lule, kur lind në botën e brendshme të njeriut, ndjenjat e ngrira në shpirt fillojnë të shkrijnë. Njeriu arrin ndjenjën e të qenit bashkë me Allahun edhe nëse gjendet në mes të kallaballëkut. Madje edhe kur është në vetmi, nuk ndihet vetëm. Kjo rrëke ndjenjash të papërshkrueshme e ngazëllen pa reshtur shpirtin. Ja, kjo quhet lumturi dhe kënaqësi e vërtetë. Kjo nuk shpjegohet, por përjetohet.

Ecja në rrugën që ka urdhëruar Allahu dhe mos largimi nga rruga e Tij, i jep njeriut një besim të madh në vetvete. Madje edhe vdekja që për shumë njerëz është e frikshme, atij i duket e bukur.

Nëse jeta zbukurohet, zbukurohet edhe vdekja dhe nëse zbukurohet vdekja, zbukurohet edhe jeta. Çfarë mbeti tjetër? Jeta dhe vdekja... Qëllimi

kryesor për të jetuar dhe pikat kyçe të kufirit të jetës...

Ngaqë besimi është e vetmja gjë që mund t'ia sigurojë njeriut një lumturi të tillë në të dy botët, ka shumë hajdutë të cilët duan ta vjedhin këtë thesar. Këta të cilët ia kanë ngulur sytë këtij xhevahiri të çmuar, duke filluar me shejtanin dhe nefsin e njeriut, janë familja, shkolla dhe shokët përreth, me kalimin e kohës bëhen edhe shokët e punës, bashkëshortët dhe fëmijët... Lojërat, argëtimet dhe kanalet televizive... Të gjithë këta, duke marrë forma të ndryshme dhe duke vënë lloj-lloj maskash, mundohen që ta kthejnë njeriun nga rruga e vërtetë ose të paktën t'ia grabisin për disa orë thesarin e jetës.

Njeriu i cili e ka kuptuar qëllimin e krijimit të tij dhe ka ndjerë në zemër dritën e besimit, është armiku i çdo ligësie dhe miku i çdo mirësie. Një njeri i tillë është ylli që shkëlqen në jetën e kësaj bote dhe dielli i pashuar i Ahiretit. Ai e përdor mendjen dhe nuk qëndron me të shkujdesurit të cilët kanë rënë pre e djallit. Ai e di mirë se ata që nuk e përdorin mendjen, janë zëdhënës të shejtanit dhe janë në gjendje të mjerueshme.

Përsëri një njeri i cili ka arritur të vërtetat e besimit, e di mirë se zbatimi i urdhrave të nefsit, e shuan dritën e besimit në zemër. Ai i frenon dëshirat e nefsit me rrugët e dijes së vërtetë. Allahu zemërohet me ata të cilët përqafojnë këtë botë. Prandaj ai i frikësohet përfundimit të këtyre mjeranëve dhe strehohet gjithmonë te Allahu Teala.

Nga oqeani i haditheve

Selime Akburç

XHEMATET E ADHURIMIT

Sipas transmetimit të Ebu Hurejres (r.a.), Resulullahu (s.a.v.), ka thënë:

“Ekzistojnë melekë që shëtisin në rrugë dhe kërkojnë për njerëzit që janë duke adhuruar Allahun. Kur vërejnë një shoqëri që është duke adhuruar Allahun, i thonë njeri-tjetrit:

‘Hajdeni!.. Ja ku janë ata që po kërkonim!’
Ndërkohë qëndrojnë rreth tyre duke tundur flatrat. Në këtë moment, edhe pse Allahu di çdo gjë, i pyet melekët:

‘Çfarë janë duke thënë robërit e mi?’

Melekët i përgjigjen: ‘Thonë: Subhanallah dhe të mbajnë larg çdo gjëje që nuk të shkon Ty, marrin tekbir me fjalët: Allahu Ekber, të falënderojnë dhe flasin për Lartësinë Tënde.’ Biseda vazhdon në këtë mënyrë:

‘A më kanë parë ata Mua?’

‘Jo, nuk të kanë parë.’

‘Çfarë do të bënin ata, sikur të më shikonin?’

‘Sikur të të shikonin do të të adhuronin më shumë, do të të lartësonin më shumë, do të të mbanin edhe më larg gjërave që nuk të kanë hije.’

‘Çfarë duan robërit e Mi nga Unë?’

‘Ata kërkojnë Xhenetin?’

‘A e kanë parë Xhenetin?’

‘Jo, o Allah! Vallahi ata nuk e kanë parë Xhenetin.’

‘Çfarë do të kishin bërë në qoftë se do ta kishin parë Xhenetin?’

‘Sikur ta kishin parë Xhenetin, do ta kërkonin atë me një mall shumë të madh, do të bënin shumë përpjekje për ta merituar atë.’

‘Për çfarë kërkojnë ndihmë prej Meje?’

‘Për t’u ruajtur nga Xhehenemi.’

‘A e kanë parë Xhehenemin?’

‘Jo, vallahi nuk e kanë parë Xhehenemin.’

‘Çfarë do të kishin bërë në qoftë se do ta shihnin atë?’

‘Sikur ta kishin parë Xhehenemin do të kishin më shumë frikë nga ai dhe do të bënin edhe më shumë përpjekje për t’u larguar prej tij.’

Pas këtyre fjalëve Allahu Teala u thotë melekëve:

‘Ju jeni dëshmitarë, që Unë i fal këta njerëz për shkak të këtij adhurimi që janë duke bërë.’ Një nga melekët thotë:

‘Filani, që ndodhet në mesin e tyre me të vërtetë nuk është prej tyre. Ai ka ardhur për një punë dhe është ulur rastësisht aty.’ Allahu Teala përgjigjet:

‘Ata njerëz që janë të ulur aty janë aq njerëz të mirë, sa nuk ka asnjë njeri të keq mes tyre!..’” (Buhari, Deavat, 66; Ahmed ibn Hanbel, Musned, II, 251- 252.)

MËSHIRA NDAJ FËMIJËVE


Hazreti Aishe (r.a.), ka thënë:

Një ditë erdhi pranë nesh një grua e vetmuar që po mbante në shpinë dy fëmijë. I dhashë tri hurma asaj. Ajo u dha nga një hurmë fëmijëve. Ishte duke e afruar në gojë hurmën që kishte mbetur, kur fëmijët ia kërkuan edhe atë. Gruaja e shkretë u ndau fëmijëve të vet hurmën e saj. Unë u mahnita nga ky gjest dhe ia tregova Resulullahut këtë ngjarje. Ai tha:

“Sigurisht që Allahu ia ka dhuruar Xhenetin asaj gruaje për hir të atij gjesti, Ai e ka ruajtur nga Xhehenemi.” (Muslim, Birr, 148.)

Hazreti Aishe (r.a.), ka thënë:

Një grua me dy vajza erdhi për të kërkuar diçka. Në shtëpi më gjendej vetëm një hurmë.



E mora hurmën dhe ia dhashë gruas. Në atë çast erdhi Resulullahu. Kur i tregova se si ishte puna Ai më tha:

“Kur dikush që kujdeset për vajzat e veta është në vështirësi dhe për kujdeset për to; këta fëmijë do ta mbrojnë nga zjarri i Xhehenemit atë.” (Buhari, Zekat, 10; Muslim, Birr, 147; Tirmidhiu, Birr, 13.)

Ebu Hurejre (r.a.), transmeton se Resulullahu, sallallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Allahu e ka ndarë mëshirën e Vet në njëqind pjesë, nëntëdhjetë e nëntë prej tyre i vendosi në katin e vet; një të njërin prej tyre e ka ulur në tokë. Për shkak të kësaj pjese mëshire, krijesat kanë dhimbje për njëra-tjetrën. Edhe kafshët (për hir të kësaj mëshire të zbritur në tokë) ngrenë këmbën nga frika se mos e shkelin të voglin e tyre.” (Buhari, Edeb, 19; Muslim, Teube, 19.)

Tek një ngjarje tjetër është ky vazhdim:

“Për hir të kësaj pjesë mëshire, krijesat janë të mëshirshme me njëra-tjetrën.

Nëntëdhjetë e nëntë pjesët e tjera janë ruajtur për Ditën e Gjykimit.” (Muslim, Teube, 20.)

KRIJESAT E XHENETIT DHE TË XHEHENEMIT

Sipas transmetimit të Ebu Said el-Hudri

(r.a.), Pejgamberi (s.a.v.), ka thënë:

“Xheneti dhe Xhehenemi filluan të debatonin. Xhehenemi tha:

- Unë kam tiranët dhe arrogantët.

Xheneti tha:

- Unë kam të dobëtit dhe të varfrit.

Pas kësaj bisede Allahu Teala e zgjidhi kështu këtë grindje:

- O Xhenet! Ti je rahmeti Im, Unë i mëshiroj njerëzit që dua me ty. O Xhehenem! Ti je ndëshkimi Im. Unë i ndëshkoj disa nga njerëzit me ty. Unë do t’ju mbush të dyve.” (Muslim, Xhemaat, 34; Buhari, Tevhid, 25; Tirmidhiu, Xhennet, 22.)

Harise ibn Vehb (r.a.), tha që e kam dëgjuar Resulullahun (s.a.v.), duke thënë:

“A t’ju tregoj për njerëzit e Xhenetit? Ata janë njerëz të dobët që nuk i ka përfillur askush, duke qenë se janë dukur të tillë, por Allahu është betuar që do të ndodhë kështu, në qoftë se do t’u binden kërkesave të Tij.”

“A doni t’ju tregoj se kush janë njerëzit e Xhehenemit? Njerëzit me zemër të ngurtë, koprracë dhe që ecin me arrogancë.” (Buhari, Ejman, 9; Muslim, Xhenet, 47)

DITURIA QË SOLLI RESULLALLAHU

Sipas transmetimit të Ebu Musa el- Esari (r.a.), Resulullahu ka thënë:

“Feja dhe dija që Allahu ka dërguar në botë me mua, i ngjan një shiu të bollshëm. Vendi ku bie shiu është i begatshëm. Toka e thith ujin e shiut, lulëzon dhe çel bimë. Ekziston një pjesë toke e cila e mban ujin sipër dhe nuk e thith krejtësisht atë. Allahu bën që njerëzit të përfitojnë nga ky ujë; ata pinë për vete, u japin kafshëve dhe e përdorin për nevojat bujqësore. Ka një vend tjetër ku bie shiu; ajo është një tokë shterpë; as nuk mban ujë as nuk ka bimë. Kjo ngjason me kuptimin e fesë së zbritur nga Allahu dhe njerëzit që shpëtojnë dhe zënë dije për vete, njerëzit që mësojnë dhe ua shpjegojnë të tjerëve, njerëzit që nuk duan të dëgjojnë, njerëzit që nuk e pranojnë fenë që ka zbritur së bashku me mua.” (Buhari, Ilim, 20; Muslim, Fezail, 15)

KURA ME 12 THELPINJ HUDHRA

për largimin e peshës së tepërt



Pesha e tepër tek çdo organizëm shoqërohet me shtimin e sasisë së yndyrës apo dhjavit, sidomos në pjesën e barkut apo zonën abdominale.

Një problem ky, nga i cili miliona njerëz në botë, përfshirë pa dyshim dhe Shqipërinë përballin sfida dhe vështirësi të ndryshme shëndetësore.

Padyshim dhjamosja e tepërt në zonën e barkut krijon një siklet në paraqitjen e jashtme por prania e saj në organizëm më shumë se sa e sikletshme është shpesh burim i shumë komplikacioneve shëndetësore.

Më poshtë do të japim një kurë natyrale me përbërës të thjeshtë që luftojnë praninë dhe rritjen e nivelit të yndyrave apo masës së dhjavit në zonën abdominale të trupit.

Mjafton të ndiqni hapat siç duhet dhe kjo kurë natyrale do t'i dhurojë organizmit shëndet të plotë ndërsa në vetëm një javë do të ndihmojë në shkrirjen e masës së tepërt dhjamore në zonën e barkut.

Kjo kurë ndihmon gjithashtu në mirëfunksionimin e sistemit të tretjes ndërsa mban nën kontroll të plotë nivelin e kolesterolit.



PËRGATITJA E KURËS ME HUDHRA

Përbërësit

12 thelpinj të mëdhenj hudhre

Dy kokrra limoni

1 ½ l ujë

SI TA PËRGATISNI

Qëroni thelpinjtë e hudhrës me kujdes.

Shtypni secilin prej thelpinjve përmes një çekiçi kuzhine.

Pastroni limonat me ujë të rrjedhshëm dhe prijini në copëza të vogla me gjithë lëkurë.

Vendosni ujin në një tenxhere.

Shtoni hudhurat e shtypura bashkë me copat e limonit dhe vendosini në zjarr të ziejnë për 15 minuta.

Më pas, kullojeni lëngun dhe pijeni.

SI TA KONSUMONI KËTË KURË

Lëngun e përftuar mund ta ndani në tre doza për çdo ditë.

Rekomandohet që të pini nga një filxhan çaji me këtë lëng para secilit nga tre vaktet e ngrënies. Kura përdoret për tre ditë rresht. Ajo ndihmon organizmin për një pastrim rrënjësor të tij duke ndikuar në shkrirjen e yndyrës së tepërt në zonën e barkut.

Efektet e kurës ndihen pas një jave ku ju do të ndiheni më të lehtë.

Për shumë persona shija e këtij lëngu mund të jetë e sikletshme dhe e vështirë. Por gjatë konsumimit të tij mund të shtoni pak mjaltë për ta ëmbëlsuar dhe për t'i dhënë shije gjithashtu.

VLERAT E RRALLA TË MAJDANOZIT

për shëndetin e veshkave



Majdanozi është një nga bimët mjekësore më të mira për shëndetin e veshkave.

Majdanozi i bën ato më të forta dhe parandalon formimin e gurëve.

Kjo bimë e shëndetshme i pastron ato në mënyrë natyrale nga toksinat dhe të gjitha substancat e dëmshme që kërcënojnë shëndetin e veshkave.

Në këtë artikull do të mësoni më shumë për tre kura natyrale që ndihmojnë në pastrimin e veshkave nga toksinat dhe substancat e dëmshme.

LËNGU I SHËNDETSHËM I MAJDANOZIT PËR VESHKA TË SHËNDETSHME

Përbërësit:

Një tufë e vogël majdanoz

3 gota me ujë

Përgatitja:

Ngroheni ujin në një çajnik dhe përpara se të marrë valë hiqeni nga zjarri.

Shtoni tufën e majdanozit dhe lëreni të rrijë në ujë për 15 minuta dhe më pas kullojeni.

Këshillohet të pini dy-tre gota me çaj majdanozi çdo ditë sidomos pas çdo vakti.

Mund ta pini për 30 ditë e ta përsërisni nëse është e nevojshme.

LËNG KASTRAVECI DHE MAJDANOZI

Veshkat punojnë fort që të pastrojnë gjakun, të eliminojnë kripën dhe elementë të tjerë të dëmshëm.

Puna e tyre është shumë e vështirë, ndaj duhet t'u japim të gjithë ndihmën e mundshme.



Sipas të dhënave duke konsumuar majdanoz çdo ditë, ne ndihmojmë veshkat të pastrojnë organizmin nga toksinat.

Përbërësit:

1 kastravec

1 tufë me majdanoz

2 gota me ujë

Përgatitja:

Përziejini të gjithë përbërësit në një mikser deri sa lëngu të jetë kompakt dhe hollojeni sipas dëshirës.

Më pas pini dy gota nga ky lëng, një në mëngjes esëll dhe një përpara se të bini për të fjetur.

Pijeni për 20 deri 30 ditë.

LËNG ANANASI DHE MAJDANOZI PËR PASTRIMIN E VESHKAVE

Përbërësit:

3 feta ananasi

2 tufa me majdanoz

1 litër ujë

Përgatitja:

Përziejini përbërësit në një mikser për 4 minuta.

Lëngun mos e kulloni dhe pijeni të gjithin përgjatë gjithë ditës.

Pijeni për 20-30 ditë.

Vlerat e tjera të Majdanozit për shëndetin e organizmit

Majdanozi përmban minerale si kalçiumi, hekuri dhe sulfuri.

Ai është një burim i shkëlqyer i vitaminës C dhe shumë vitaminave të tjera të dobishme.

Konsumi i majdanozit ndihmon në forcimin e sistemit imunitar.

NJË KOMPJUTER QË PARASHIKON 16 TË ARDHME

Një superkompjuter kuantik në gjendje të simulojë njëkohësisht të gjitha mundësitë e evoluimit të një procesi fizik dhe të ballafaqojë rezultatet, i zhvilluar nga studiuesit e Universitetit Griffith dhe Universiteti Nanjang i Teknologjisë në Singapor dhe i përshkruar në revistën shkencore “Nature Communications”.

Një sistem që mund të ndihmojë inteligjencën artificiale të mësojë shumë më shpejt nga sa arrin të bëjë deri më sot, duke mundësuar gjithashtu edhe realizimin e kompjuterëve kuantikë më të fuqishëm.

Funksionimi i kësaj pajisje frymëzohet nga puna e fituesit të çmimit Nobel, Richard Feynman, që kishte kuptuar se kur një grimcë kuantike udhëton nga një pikë A në një pikë B, nuk ndjek domosdoshmërisht

vetëm një rrugë, por njëkohësisht mund të kalojë të gjitha rrugët e mundshme që lidhin dy pikat.

Në këtë rast studiuesit e drejtuar nga Geoff Pryde, kanë simuluar njëkohësisht dhe në mënyrë efçente 16 të ardhme.

Risia që sjell ky model është përdorimi i më pak hapësire memorieje në raport me një kompjuter klasik dhe mundësinë për tu shtrirë në sisteme më të gjera.

Ky është një rezultat që i paraprinë fillimit të një epike të re për kompjuterët kuantikë, sipas Ghafarit, autori kryesor i këtij studimi.

“Në vitet 60 njeriu mund të imagjinonte shumëllojshmërinë e përdorimit të kompjuterëve modernë. Ndërsa sot ende nuk dimë asgjë mbi potencialin e vërtetë të kompjuterave kuantikë”, thekson ai.

NË GJENE ZBULOHEN SINJALE TË SË KALUARËS

Njësoj si në një gërmim arkeologjik, gjenetistët janë përpjekur të kërkojnë sinjale nga e kaluara në ADN-në e njeriut modern, duke zbuluar tregimin e migrameve antike dhe kryqëzimeve.

Kjo analiza e Universitetit të Tartusë, në Estoni, u zhvillua mbi 565 individë që vinin nga Azia jugore duke mundësuar që të krijohet gjenomi arkaik, sipas studimit të botuar në revistën shkencore “Molecular Biology and Evolution” dhe i koordinuar nga italiani, Luca Pagani studiues në Tartu dhe në Universitetin e Padovas.

Studiuesit zbuluan se disa copëza ADN-je nuk

përzihen sikurse ndodh normalisht gjatë bashkimit të dy popullsive, në këtë rast bëhet fjalë për indianët autoktonë dhe aziatikët perëndimorë.

“Kur dy popullsi përzihen, zakonisht e bëjnë me të njëjtat proporcione në të gjithë gjenomin”, shpjegon studiuesi italian.

“Në këtë rast, disa rajone kanë mbetur më autoktone ndërsa disa të tjera shumë më pak”, vazhdon ai.

“Kjo ka ndodhur sepse kanë luajtur një rol thelbësor në përshtatjen me mjedisin dhe janë seleksionuar gjatë evoluimit”, thekson Pagani.

INTELIGJENCA ARTIFICIALE MBJELL BORZILOKUN MË TË MIRË NË BOTË

Në eksperiencën e saj prej fermeri, Inteligjenca Artificiale (IA) shfaqet fermerja më e mirë duke mbjellë borzilokun më të pasur në aromë pa asnjë modifikim ADN-je, por falë një algoritmi të të mësuarit automatik që ka përlogaritur miliona të dhëna për të gjetur kushtet optimale për të marrë aromën më të mirë.

Ky studim i bërë nga Instituti i Teknologjisë në Masaçusets (MIT), i publikuar në revistën shkencore "Plos One", është hapi i parë i të ashtuquajturit kultivim kibernetik dhe tani studiuesit synojnë të rrisin aftësitë mjekësore të disa bimëve dhe të ndihmojnë mbjelljet që të përshtaten në ndryshimet klimatike.

Të drejtuar nga Arielle Johnson dhe Elliot Meyer-son, studiuesit po përpiqen tani të krijojnë bimë borziloku më të pasura me substanca që ndihmojnë në luftën kundër sëmundjeve, si diabeti, si dhe të rrisin rendimentin e bimëve mjekësore si previnka e Madagaskarit, burimi i vetëm i disa molekulave kundër kancerit.

Një aplikim tjetër shumë i rëndësishëm i kultivimit kibernetik është përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. Në këtë drejtim, grupi i shkencëtarëve po zhvillon eksperimente me pemët e lajthive për kompaninë shumëkombëshe "Ferrero", që konsumon 25% të lajthive të mbjella në gjithë botën.

NË ADN E NJERIUT SHIHEN EDHE SHENJAT E VARFËRISË

Varfëria lë një gjurmë edhe tek ADN duke modifikuar mbi 1 500 gjene, sipas zbulimit të udhëhequr nga Universiteti Northwestern dhe i botuar në revistën "American Journal of Physical Anthropology".

Studimet e mëparshme treguan se si niveli social-ekonomik ndikon ndjeshëm në shëndetin dhe fillimin e shumë sëmundjeve.

Studimet gjithashtu treguan se gjenet e përfshira rregullojnë, ndër të tjera, përgjigjen immune dhe zhvillimin e sistemit nervor. Kërkuesit shkencorë, të udhëhequr nga Thomas McDade, ishin shumë të habitur që gjetën kaq shumë rajone të ADN-së, rregullimi i të cilave është i lidhur me nivelin social-ekonomik.

"Zbulimi ka zbuluar një mekanizëm, përmes të cilit varfëria ka një ndikim të qëndrueshëm në një gamë të gjerë të sistemeve dhe proceseve fiziologjike, në veçanti, varfëria ndikon në shtimin e molekulave specifike në gjenome, të cilat kanë funksionin e rregullimit të shprehjes së gjeneve në një proces të quajtur methylation DNA", shpjegon McDade.

Studime të mëtejshme do të nevojiten për të kuptuar të gjitha pasojat që ka gjendja social-ekonomike për shëndetin, por shumë nga gjenet e zbuluara janë përfshirë në reagimin imun ndaj infeksioneve, zhvillimit skeletor dhe zhvillimit të sistemit nervor.

"Ne do të përqendrohemi në këto aspekte për të kuptuar sa thellë mund të jetë ngulmimi i varfërisë në ADN", shtoi McDade

“O ju
që keni besuar!
Besoni Allahun,
të Dërguarin e Tij,
Librin që ia ka zbritur
të Dërguarit të Tij
dhe Librin
që e ka zbritur
më parë...”

(Nisa, 136)

ISSN 2227-3611



9 772227 361004

06